

MENAXHIMI I HUASË DHE ROLI I TIJ NË CILËSINË E PORTOFOLIT GJATË DHE PAS PROÇESIT TË KREDIDHËNIES

Sofika (TROKA) NAZAJ

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Fakultetin Ekonomik me profil Financë, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqësshkencor: Profesor i Asociuar Dr. Elvin MEKA

Numri i fjalëve: 53.488

Tiranë , Janar 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklarojë se ky punim përfaqëson punën time origjinale, dhe se gjithë materiali i shkruar ka origjinalitetin e tij dhe nuk është kopje e ndonjë punimi apo botimi tjetër, përveç citimeve të përdorura për reference dhe të shprehura si të tilla

Të dhënat statistikore të përdorura në këtë punim janë referuar në punim në mënyrë të plotë se nga cilat burime janë marrë, ndërsa kam kryer përpunimin e tyre në grafikë dhe tabela për qëllime të analizës së këtij punimi.

Pjesë të rëndësishme të këtij punimi janë publikuar në konferenca dhe botime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Jam në dijeni të pasojave që sjellë një deklaratë jo e vërtetë, dhe konfirmoj origjinalitetin e këtij punimi.

Deklarues

Sofika (Troka) Nazaj

ABSTRAKTI

Thellimi i krizës ekonomike në vënd ka krijuar një situatë të tillë ku huatë me probleme në sektorin bankar në Shqipëri po bëhen gjithnjë e më shumë një çështje kryesore me të cilat përballen bankat, veçanërisht pas fillimit të krizës financiare e globale të 2008-ës. Efektet e krizës, të ndërthurura me faktorë të tjerë specifikë të strukturës ekonomike të Shqipërisë, si dhe me mangësitë në drejtim të procesit të huadhënies nga vetë bankat tregtare mund të konsiderohen si shkaqet kryesore të rritjes së huave me probleme. Në këtë punim janë trajtuar problemet në drejtim të menaxhimit të procesit të huadhënies nga vetë bankat, gjatë dekadës së fundit, dhe që ju referohen praktikave dhe procedurave të kreditimit, strukturës organizative dhe ndarjes së punës në sektorin e kredisë, rolit të riskut në procesin e vendimarrjes dhe të monitorimit të portofolit të huave në sistemin bankar shqiptar etj. Trajtimi i problemeve që lidhen me mangësitë në procesin e kreditimit nuk janë marë të shkëputur dhe nga ndikimi që kanë patur në prirjen rritëse të huave me probleme, kushtet dhe faktorët ekonomike specifikë të tregut vendas dhe atij financiar në veçanti.

Punimi synoj dhe konfirmoj hipotezën kryesore se Niveli i lartë i huave me probleme në sistemin bankar Shqiptar e ka bazën e vetë në një administrim jo të përshtatshëm të portofolit të huave nga vetë bankat, ndërsa faktorët e tjerë që lidhen me strukturën e industrisë financiare në vend apo dhe me përkeqsimin e treguesve makroekonomik edhe pse të rëndësishëm në ndikimin e tyre në rritjen e huave me probleme, janë të pashmangshëm dhe jashtë kompetencave të bankave për t'u menaxhuar e trajtuar.

Metoda bazë shkencore e përdorur në këtë studim është analiza vrojtuese, e cila është realizuar me punonjës e menaxherë të niveleve të ndryshme në 16 bankat tregtare në vend. Si metodë dytësore e përdorur në këtë punim është ajo e analizës statistikore, e cila konsiston në analizat e portofolit të kredisë në bankën ku punoj si dhe të dhënat statistikore mbi portofolet e huave të bankave tregtare të mara nga faqet zyrtare online. Në këtë studim janë shfrytëzuar burime të shumta literature nga autorë vendas e të huaj që trajtojnë problemet dhe shkaqet që çojnë në nivelet e larta të huave me probleme.

Analiza dhe studimi i elementëve të rëndësishëm që lidhen me administrimin e procesit të huadhënies në sistemin bankar shqiptar konkludoj në favor të hipotezës kryesore të këtij punimi, që konfirmon se: Mirëmenaxhimi i portofolit të kredisë ka një rol kyç në uljen e rrezikut të huasë dhe kredive me probleme. Një menaxhim i mirë i portofolit të kredisë nënkupton gjithë elementët që garantojnë një cilësi të lartë me rrezik të ulët të portofolit të kredisë dhe konkretisht, një strukturë organizative të përshtatshme, e cila duhet të synojë një ndarje të qartë të punës midis dy strukturave të rëndësishme Risk – Shitje në aktivitetin kreditues të bankave; trainimin e vazhdueshëm të punonjësve të sektorit të kredisë; rolin e njësisë së Riskut në vendimarrjen e kredive si parësor; përmirësimi i procedurave dhe rregulloreve moderne dhe me një qasje më pozitive dhe të përshtatshme me nevojat e biznesit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm; negocijime fleksibël kur është fjala për zgjidhjen e kredive me probleme etj. Shumica e këtyre elementëve të rëndësishëm kanë marrë kohë të gjatë e kanë hasur shumë vështirësi derisa janë bërë praktika normale operimi në disa prej bankave tregtare Shqiptare.

Gjetja e re dhe mjaft e rëndësishme e këtij punimi shkencor është impakti ose ndikimi që ka vendosja e një strukture organizative të qartë dhe efektive, e cila përcakton dhe ndan qartë përkrahjet specifike të punës për dy njësitë kryesore Risk dhe Shitje gjatë aktivitetit kreditues në banka.

Në këtë punim jepen rekomandime mbi ndarjen e qartë dhe efektive të punës midis njësive Risk dhe Shitje në procesin e kreditimit si dhe përmirësimin e praktikave dhe procedurave të brendshme, krahas me parimet moderne të menaxhimit të riskut dhe futjen e shpejtë të zbatimit të plotë të standarteve të Basel II nga Banka e Shqipërisë si mbikqyrëse e aktivitetit tregtar të bankave në vend.

ABSTRACT

The deepening of economic crisis has caused a particular situation, where non-performing loans in the Albanian banking system is becoming one of key concerns for banks, particularly after the breakout of the last global financial & economic crises of 2008. The crises effects, twinned with other specific factors of Albania's economic structure, and of the insufficiency related to the process of lending activity by the commercial banks it selves could be identified as the main causes of increasing NPL's. This research paper identifies the most specific causes, in lending activity by the commercial banks it selves, which refers to the loan-making approach & practices of Albania's banking system, during the last decade, the lack of proper organizational chart and the separation of tasks in the lending sector, the weak role of the risk in the decision making process and on portfolio monitoring. The analyses of the problems and causes referring to high level of Nonperforming loans in the lending activity are not taken separately from the other variables as those of coming from global and local financial crises.

These research intends to confirm the main main hypothesis which consist in the fact that high level of Non performing loans in the banking system, has been caused by a non adequate adminstration of loan protofolio by the banks it selves, and that the other global or local market indicators even important in affecting the high level of non performing loans are unpredictable and out of the bank's capacity to be managed and treated in this context.

The base scientific method used in this research is the investigation method, which consist in interviewing the different level managers of 16 comercial banks, which operate in the Albanian market.

As a secondary method used in this research is that of the statistical analyses, which consist in the credit portfolio analyses of the bank where I work, and also other data base referring the loan portfolio of the commercial banks taken from their online portal. This research is based in a wide range source of scientific papers and books by national and

international authors, in which the Non performing loan finds considerable analyses of the causes that bring this phenomenon.

The analyses and the study of all the elements refering the administering process of the lending activity in the Albanian banking system concluded and confirmed in favour of main hypothesis which is: The loan management of the credit portfolio is crucial in preventing and lowering the credit risk, and the level of non performing loans. A good loan portfolio management means / recommend, emploving all tools that ensure a high quality portfolio within tolerable and manageable credit risk, such as: Applying a well tailored organisational chart and clear division between two main function Risk and Sales in the lending activity; a continues and frequent progam training for the loan officers; putting the role of the risk unit as a prior in a decision making process; continues improve the loan practice and procedures, which are aproprate for the business needs; flexible negotiations when dealing with non performing loans, close monitoring with borrowers who have problems on repaying back loans. Most of this practices took time until become normal operating practices in some of the comercial banks in Albania.

The new and very important finding in this research work is the impact of establishing the eficient and clear organisation chart, which clearly define and separate the specific job description for the Main unit Risk and Sales in the lending activity.

Finally, the paper provides some recommendations on clear organization chart between Risk and Sales Unit in the lending activity, along with improving internal lending practices and procedures, with modern risk management principles and to apply as soon as possible the full implementation of Basel II standards by Bank of Albania.

FALENDERIME

Ka qënë një rrugëtim i bukur punimi i këtij kërkimi, i cili do të ishte i pa mundur pa mbështetjen dhe nxitjen e familjarëve të mi, duke u shndërruar më shumë si një detyrim ndaj tyre për gjithë suportin, mirëkuptimin dhe motivimin që më kanë dhënë. Falenderoj prinderit e mi, në mënyrë të veçantë babain tim Pelivan Troka, i cili nuk ka rreshtur së motivuari mua dhe gjithë pjesëtarët e familjes së tij të madhe, bashkëshortin tim Profesor Dr Shkencash Shaqir Nazaj, djemtë e mi Endri dhe Edonald Nazaj, që kanë qënë një burim i pashtershëm energjie pozitive për mua.

Një falenderim i veçantë padyshim i shkon Udhëheqsit tim të shquar të këtij punimi, Profesor i Asociuar z. Elvin Meka, i cili më ka qëndruar pranë dhe mbështetur në këtë punim, por edhe si bashkëautorë në disa prezantime e botime të kryera së bashku. Profesor Elvini ka qënë një shembull i shkëlqyer i një akademiku bashkëkohor dhe shume cilësor nga i cili kam përfituar shumë.

Nuk mund të lë pa përmendur mbështetjen që kam marrë nga kolegë dhe drejtues të lartë të Insitucionit ku punoj prej 13 vjetësh në Bankën Credins, pa mbështetjen e të cilëve do të ishte shumë i vështirë realizimi i këtij punimi me sukses. Mirënjohje kujtimit të të ndjerit z. Artan Santo për mbështetjen morale dhe inspirimin që kam marrë, si iniciatori dhe një nga themeluesit e bankës së parë private Shqiptare Credins. Mirënjohje e falenderim menaxherëve të lartë aktualë të Credins Bank, Drejtorit të Përgjithshëm Doktor i Shkencave z. Maltin Korkuti, zv. Drejtore e Përgjithshme znj. Monika Milo, si dhe kolegë të tjerë si Msc znj. Adja Angjeli, Msc znj. Soni Thano, Msc z. Artan Koci, Doktor i shkencave z. Selman Lamaj, etj.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I: HYRJE

fq.18

- 1.1 Rritja e shpejtë e huave me probleme, çështja që shtrohet për zgjidhje fq.21
- 1.2 Qëllimi i studimit të fenomenit të huave me probleme fq.25
- 1.3 Burimet e referimit të temës fq.27
- 1.4 Rëndësia e këtij studimi fq.28
- 1.5 Hipoteza dhe pyetjet kërkimore fq.29
- 1.6 Metodatat dhe metodologjia e kërkimit fq.30
- 1.7 Mundësitë dhe kufizimet fq.34

KAPITULLI 2- SHQYRTIMI I LITERATURËS

- 2.1 Hyrje fq.37
- 2.2 Strategjitë dhe politikat e kreditimit për çdo institucion huadhënës mbi menaxhimin e riskut të kredisë sipas praktikave më të mira botërore fq.38
- 2.3 Parimet bazë të menaxhimit të riskut të kredisë dhe roli i strukturave të larta të bankës në hartimin dhe zbatimin e tyre në praktikë fq.43
- 2.4 Praktikatat e kreditimit dhe rregullimi i tyre nëpërmjet procedurave të qarta e të plota të kreditimit fq.50
- 2.5 Kredidhënia institucionet kredidhënëse dhe rëndësia e menaxhimit të riskut në këtë proces fq.55
- 2.6 Funksionet e Riskut të Kredisë dhe rëndësia e zbatimit të tyre në çdo institucion financiar fq.59
- 2.7 Ndikimi i faktorëve makroekonomik në nivelin e huave me probleme sipas literaturës botërore fq.72
- 2.8 Debatet ndërkombëtare dhe kritikatat referuar Rregulloreve dhe procedurave të kreditimit fq.78

KAPITULLI I TRETË – KUSHTET DHE RRETHANAT EKONOMIKE DHE HISTORIKO - SOCIALE, TË CILAT MBËSHTESIN RITJEN E SHPEJTË TË HUAVE ME PROBLEME

3.1 Hyrje	fq.84
3.2 Qasja e bankave Shqiptare në kreditimin e biznesit gjatë krizës globale	fq.88
3.3 Roli i njësisë së riskut dhe mangesitë e vërejtura në menaxhimin e aktivitetit kreditues në sistemin bankar shqiptar gjatë periudhës së bumit të kredive	fq.93
3.4 Monitorimi i Portofolit të kredive dhe klasifikimi i kredive nga njësitet e riskut në sistemin bankar Shqiptar	fq.99

KAPITULLI IV – NDIKIMI TREGUESVE MAKROEKONIMIKË NË NIVELIN E LARTË TË HUAVE ME PROBLEME NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

4.1 Hyrje	fq.104
4.2 Analiza e Faktorëve makroekonomike si ndërthurje e faktorëve globale me ato specifike shqiptare dhe ndikimi i tyre në rritjen e huave me probleme	fq.108
4.2.1 Ndikimi i krizës botërore në uljen e remitançave dhe nivelin e lartë të huave me probleme	fq.110
4.2.2 Analiza e faktorit të prirjes rënëse të PBB dhe ndikimi i tij në nivelin e huave me probleme	fq.113
4.2.3 Rreziku Politik në Ekonomi dhe ndikimi i tij në ecurinë financiare të biznesit	fq.116
4.2.4 Niveli i ulet i IHD dhe ndikimi i tërthortë në cilësinë e portofolit të huave	fq.118
4.3 Rrethi vicioz i ekonomisë ndikuar nga ndërthurja e variablave makroekonomik dhe Qasja e bankave shqiptare në huadhënien ndaj biznesit	fq.120

KAPITULLI V - ANALIZA E STRUKTURËS SË TREGUT TË INDUSTRIËS FINANCIARE DHE SISTEMIT BANKAR NË VENÇANTI

5.1 Sistemi bankar Shqiptar në fazën e tranzicionit ekonomik dhe efektet që kapatur në cilësinë e portofolit të huave	fq.130
5.1.1 Struktura e sistemit të industrisë financiar në Shqipëri	fq.133
5.1.2 Struktura bankare dhe efektet e kundërta të Konkurrencës së saj në cilësinë e portofolit të huave.	fq.132
5.1.3 Regjistri i kredisë dhe roli i tij si një mjet i rëndësishëm në identifikimin e cilësisë së kredikërkuesve	fq.140
5.2 Faktorët që lidhen me menaxhimin e portofolit të huave nga vetë bankat si ndikues në nivelin e lartë të huave me probleme	fq.144
5.2.1 Roli i procedurave dhe rregulloreve në nivelin e huave me probleme	fq.145
5.2.2 Roli i Riskut gjatë procesit të huadhënies në sistemin bankar Shqiptar	fq.148
5.2.3 Monitorimi i portofolit të huave në sistemin bankar si dhe menaxhimi i huave me probleme	fq.152

KAPITULLI VI. FAKTORËT NDIKUES NË NIVELIN E HUAVE ME PROBLEME NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

6.1 Hyrje	fq.157
6.2 Analiza deskriptive e variablit të PBB	fq.164
6.3 Analiza deskriptive e variablit të prirjes kredituese të bankave ndaj nivelit të huave me probleme.	fq.166
6.4 Analiza deskriptive e variablit të llojit të procedurave ndaj nivelit të huave me probleme.	fq.168
6.5 Analiza deskriptive e variablit të Autoritetit të njësisë së Riskut ndaj nivelit të huave me probleme	fq.170
6.6 Analiza deskriptive e variablave të tjerë të cilët nuk rezultuan me	

varësi të dallueshme apo më pak të dallueshme ndaj ndaj nivelit të Huave me Probleme	fq.174
6.6.1 Analiza deskriptive e variablit qe lidhet me trainimin e stafit te kredise ne banka	fq.174
6.6.2 Analiza deskriptive e variablit qe lidhet me kalimin e kredive ne njesine e rekuperimit sipas dite vonesave.	fq.176
6.7 Interpretimi i Koeficientëve të rezultuar për çdo variabel në korelacion me nivelin e Huave me probleme, dhe formula që përcakton masen e ndikimit të tyre ne nivelin e huave me probleme.	fq.179
KAPITULLI VII: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	fq.187
REFERENCAT/ BIBLIOGRAFIA	fq.195
ANEKSE	fq.202

LISTA E TABELAVE

Tabela nr 1. Stoku i Portofolit dhe Huatë me Probleme, Dhjetor 2014 ¹ për çdo bankë tregtare në Shqipëri	fq.90
Tabela nr 2. Qasja huadhënë se e bankave gjatë dy periudhave, bumit të huave kundrejt asaj të krizës financiare	fq.91
Tabela nr 3 Rezultatet finale të Portfolit dhe nivelit të Huave me Probleme për sistemin bankar 2009 vs 2014	fq.96
Tabela nr 4. Prirja e portofolit të cdo banke në periudhën e krizës globale dhe reflektimi i kësaj prirje të nivelit të Huave me Probleme 2009 kundrejt 2014	fq.97
Tabela nr 5. Fluksi hyrës i dërgesave të emigrantëve dhe prirjet e huave me probleme nga viti 2003 deri në 2014 (në milionë lek)	fq.111
Tabela nr 6. Prirja historike e nivelit të PBB dhe huave me probleme në Shqipëri gjatë 2003-2013	fq.113
Tabela nr 7. Huatë me Probleme në vlerë dhe përqindje për sistemin bankar, gjatë bumit të kreditimit dhe krizës globale	fq.115
Tabela nr 8. Vlerësimi i tre Agjensive të Vlerësimit për Shqipërinë dhe vëndet fqinj me të afërt	fq.117
Tabela nr 9. Të dhënat statistikore të borxhit të huaj të qeverisë Shqiptare 2003-2013	fq.120
Tabela nr 10. IHD kumulative për Shqipërinë gjatë periudhës 2008 deri 2014	fq.122

¹ Banka e Bashkuar përbënë një përjashtim nga gjithë sistemi bankar, për nivelin e lartë të huave me probleme, duke qënë se portofoli i saj është i papërfillshëm nuk e kemi marrë në konsideratë si një fenomen tipik.

Tabela nr 11. Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB në vite /në përqindje	fq.124
Tabela nr 12. Bankat tregtare në Shqipëri, sipas vitit të krijimit, aksionet e tyre në treg ndaj totalit të aktiveve, dhe portofolit të huave sipas Shtator 2012	fq.127
Tabela nr 13. Tendenca rritëse e kreditimit dhe Stoku i portofolit të huave në vite	fq.129
Tabela nr 14. Ecuria e bankave dhe prirja e huadhënies bankare në tre periudha kohore	fq.133
Tabela nr 15. Remitancat, PBB-ja dhe prirja e huave me probleme nga 2003 deri në 2014	fq.139
Tabela nr 16. Prirja e huadhënies dhe e huave me probleme dhe gjëndja e stokut të huasë	fq.142
Tabela nr 17. Prirja historike e nivelit të PBB dhe huave me probleme në Shqipëri gjatë 2003-2014	fq.143
Tabela nr 18. Stoku i portofolit dhe huatë me probleme, të çdo banke tregtare shqiptare midis 2009 dhe 2014	fq.145
Tabela nr 19. Prirja e huadhënies kundrejt huave me probleme, dhe pesha historike e tyre kundrejt totalit të portofolit gjatë 2003 -2008.	fq.151
Tabela nr 19/1. Prirja e huadhënies kundrejt huave me probleme, dhe pesha historike e tyre kundrejt totalit të portofolit gjatë 2009 -2014.	fq.152
Tabela nr 20. Koeficientët e korelacionit të çdo variabli të marë në analizë me nivelin e huave me probleme	fq.175
Tabela nr 21. Të dhënat tabelare të koeficientëve statistikore për PBB dhe korelacionin e tij me nivelin e huave me probleme	fq.182

LISTA E FIGURAVE

Grafiku nr 1. Prirja e Huave me Probleme në raport me stokun e Portofolit të huave gjatë 2003-2014	fq.89
Grafiku nr 2. Huatë me Probleme në përqindje ndaj Stokut të Portfolit të huave në Dhjetor 2014 për çdo bankë tregtare në Shqipëri	fq.90
Grafiku nr 3. Prirja e huadhënies dhe huave me probleme gjatë bumit të huave kundrejt periudhës së krizës	fq.92
Grafiku nr 4. Ndryshimet e Stokut të Portofolit dhe nivelit të Huave me Probleme 2009 kundrejt 2014	fq.98
Grafiku nr 5. Fluksi hyrës i dërgesave të emigrantëve dhe prirjet e huave me probleme nga viti 2003 deri në 2014 (në miliard lek)	fq.111
Grafiku nr 6. PBB-ja dhe prirja e huave me probleme nga viti 2003 deri në 2014 (në %)	fq.113
Grafiku nr 7. Borxhi i huaj për Shqipërinë gjatë periudhës 2003 deri 2013	fq.120
Grafiku nr 8. Prirja e IHD për Shqipërinë gjatë 2003 deri 2014	fq.122
Grafiku nr 9. Pesha që zë sektori bankar në sistemin financiar në Shqipëri në fund 2013	fq.125
Grafiku nr 10. Aktivitetet e çdo banke tregtare në përqindje ndaj totalit të aktivave të Sistemit Bankar Shqiptar, Shtator, 2013	fq.128
Grafiku nr 11. Portofoli i huave të çdo banke tregtare ndaj total portofolit të huave të Sistemit Bankar Shqiptar, Shtator 2013.	fq.129
Grafiku nr 12. Prirja rritëse e huadhënies në sistemin bankar shqiptar gjatë 2003-2014	fq.130

Grafiku nr 13. Prirjet e dërgesave të emigrantëve dhe PBB-së kundrejt prirjes së huave me probleme gjatë 2003 deri 2014	fq.140
Grafiku nr 14. Prirjet e huadhënies dhe huatë me probleme gjatë periudhës 2003 deri 2014	fq.143
Grafiku nr 15. Analiza deskriptive/përshkruese e faktorit të PBB në raport me nivelin e huave me probleme	fq.163
Grafiku nr 16. Ndryshimi i nivelit të portofolit në raport me nivelin e huave me probleme	fq.166
Grafiku nr 17. Proçedurat e huadhënies janë të forta apo normale në korelacion me nivelin e huave me probleme	fq.167
Grafiku nr 18. Cilësia e Autoritetit të njësisë së Riskut në Aprovues apo Rekomandues mbi cilësinë e Portofolit të Huave	Fq.169
Grafiku nr 19. Cilësia e Autoritetit të njësisë së Riskut VETO ose JO, në korelacion me cilësinë e Portofolit të Huave	Fq.171
Grafiku nr 20. Niveli i huave me probleme në varësi të ditëve në vonesë para kalimit në njësinë e Rekuperimit	Fq.175

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
IHD	Investimet e Huaja Direkte
BSH	Banka e Shqipërisë
INSTAT	Instituti i Statistikave
BIS	Bank for International Settlements
EPU	(Economic Policy Uncertainty) Index- Indeksi i pasigurisë së Politikave ekonomike
SPSS	Statistical Package for Social Science, i referohet modelit statistikor të përdorur në analizë
EQJ	Europa Qëndrore dhe Jugore
EMCI	Euro Money Country Index
EIU	Economist Intelligence Unit
EPU Index	Economic Policy Uncertainty Index-
IFRS	International Financial Reporting Standards
BOA	Bank of Albania
PAR	(Portfolio at Risk) – portofoli ne risk

KAPITULLI I: HYRJE

Rreziku i kredisë është një çështje e cila ka tërhequr vëmendjen e shumë studiusve të institucioneve financiare dhe ekonomike në vend dhe në botë, dhe në këtë pikpamje, ky punim ka patur një bazë teorike të gjërë, si në botime jashtë por edhe brënda vëndit.

Eksperienca e derisotme ka treguar që bizneset shqiptare në të shumtën e rasteve kanë mangësi të njohurive të plota në fushën e ekonomisë, në shumë aspekte të menaxhimit të biznesit, analizës, njohjes dhe marjes së konsulencës financiare dhe ekonomike dhe në mënyrë të veçantë në menaxhimin e marrëdhënieve me bankat. Të panjohur me institucionet bankare, shërbimet dhe produktet që ato ofrojnë, në kushtet e një vlerësimi të cekët të risqeve që ndërmarin për çdo transaksion, shpesh bizneset, kanë qënë të pa aftë të vlerësojnë kërkesat e tyre afatmesme dhe afatgjata për kreditim, duke rezultuar me kërkesa për kreditim shpesh të pastudiuara mirë, e me rrezik të lartë të moskthimit të tyre në kushtet kur shumë banka operuese kreditonin duke anashkaluar disa kritere bazë të kredisë në kërkim të më shumë aksioneve në një treg të kufizuar.

Tranzicioni i gjatë i ekonomisë shqiptare drejt ekonomisë së tregut, ka diktuar një qasje jo të përshtatshme të marrëdhënieve bank-biznes.

Rreziku i kredisë është i lidhur ngushtë me shumë faktorë, dhe përveç rrezikut individual, rreziku i vëndit dhe tregut ku operojnë kanë dhe zënë një rol të rëndësishëm.

Në më shumë se katër pesë vitet e fundit huatë me probleme dhe provigjonet që ato sjellin në rritjen e shpenzimeve të bankave është bërë një problem mjaft delikat. Për më tepër që prirja e tyre rritëse është ende aktuale duke reflektuar në mënyrë të drejtë për drejtë rënien ekonomike të bizneseve dhe mungesën e likuiditetit në treg.

Në nivelin makro, Shqipëria është konsideruar si një vënd me rrezik të lartë, e për pasojë rreziku i huasë si një tregues që ndikohet direkt nga ky faktor është në nivele të larta.

Minimizimi i rrezikut të huasë është çështja që shtrohet në këtë temë, jo vetëm duke ristrukturuar huatë me probleme, në vonese/default por edhe për të rritur cilësinë e

huadhënies. Rritja e cilësisë së huadhënies apo huadhënia me rrezik të minimizuar, konsideron marrjen në konsideratë jo vetëm faktorët ekonomik në një stad të caktuar të vëndit por gjatë huadhënies të kemi në konsideratë dhe tendencat dhe parashikimet në avancë të situatave e faktorëve që ndikojnë në një rrezik më të lartë të huadhënies sot. Një tjetër element i rëndësishëm në menaxhimin e riskut të kredisë, ka qënë mungesa e strategjive, dhe politikave të zhvillimit nga vet bankat. Strategjitë dhe politikat e zhvillimit kanë qënë trajtuar si elementë thjesht formal, se sa si mjete të rëndësishme mbi të cilat do të fokusohet zhvillimi i qëndrueshem i bankës dhe mbi të cilat do të ndërtoheshin politikat dhe procedurat e kreditimit si praktika në shërbim dhe funksion të strategjive të zhvillimit të tyre.

Njësia e Riskut të Kredisë, si një funksion mjaft i rëndësishëm në një institucion huadhënës në shumicën e bankave tregtare në vend nuk ka luajtur rolin parësor në vlerësimin dhe parashikimin e faktorëve që ndikojnë cilësinë e huadhënies, ndërsa në të shumtën e bankave në vend, ky rol i riskut erdhi vonë dhe mori kohë të gjatë deri në kristalizimin e rolit të tij, duke bërë që ndikimi i tij në periudhën e krijimit të portofoleve të kredive në banka të ishte në nivele modeste. Matja, vlerësimi i Rrezikut të huasë në momentin e huadhënies, parashikimi i faktorëve ndikues në të ardhmen mbi pamundësinë e kthimit të huasë, është mjaft e rëndësishme në ruajtjen e një portofoli kredie cilësor. Monitorimi në vazhdimësi i huave është një tjetër faktorë i rëndësishëm në një portofol cilësor kredie, dhe që për rrjedhojë rrit vlerat e aseteve të bankës së saj.

Mos diversifikimi i portofolit të huasë së një institucioni në raporte jo të drejta me prioritetet e zhvillimit kombëtar, çon në një portofol me rrezik të lartë ripagimi. Sektorë të ndryshëm të ekonomisë kanë dhe mbartin rreziqe të ndryshme të moskthimit të huasë në kohë, ndaj mangësia në diversifikimin më të gjërë e më të thellë të portofolit të huave në vend ka sjellë përqëndrim të portofolit të huave në dy tre sektorë kryesorë, të cilët ishin baza ku kriza ekonomike dha efektet më të rënda, të tilla si ndërtimi dhe pasuritë e patundshme. Diversifikimi i portofolit të huasë në vend, shënoi mangësi edhe në disa aspekte të tjera të tilla si: diversifikimin sipas monedhave të ndryshme, duke bërë që portofoli i huave në monedhë të huaj të vihej në rrezik më të madh për shkak të rritjes së

kursit të këmbimit me monedhn vendase, apo mos diversifikimin e tij sipas afateve të kthimit.

Produktet që financohen kanë ndjeshmëri të ndryshme në kushtet e ndryshimit të kërkesë ofertës në tregun vëndas apo në atë ndërkombëtar, apo të ndryshimit të çmimit kur kuotohen në bursë, ndaj dhe diversifikimi i portofolit të huave sipas produkteve që financohen ka rëndësi në uljen e riskut të kredisë, gjë e cila nuk është marë parasysh gjatë procesit të kreditimit dhe krijimit të portofolit të huave nga bankat.

Sistemi bankar Shqiptar gjen ende vështirësi në diversifikimin e portofolit të kredive për shkak të mungesës së strategjive dhe prioritetëve që do të orientojnë ekonominë e vëndit dhe bankat drejt sektorëve të tjerë përveç atyre që tashmë janë të ezauruar dhe kan krijuar problematikën e nivelit të lartë të huave me probleme (të tillë si sektori ndertimit dhe tregtise). Në këto kushte struktura e portofolit të kredive edhe pas 5-6 viteve që nga fillimi i krizës globale, megjithë përpjekjen e bankave në këtë drejtim, mbetet i vështirë për tu menaxhuar.

1.1 Rritja e shpejtë e huave me probleme, çështja që shtrohet për zgjidhje

Huatë me probleme në vëndin tonë kanë një tendencë në rritje në raport me madhësinë e portofolit të huasë. Prirja në rritje e huave me probleme do të vazhdojë të rritet për aq kohë sa cilësia e huadhënies vazhdon të ruajë të njëjtat standarde, e ndërkohë faktorët ekonomik dhe socialë të vëndit do të vijojne të ndikojnë negativisht në zhvillimin ekonomik të vëndit e për rrjedhoje ne ecurine financiare të huamarrësve.

Rekuperimi i huave me probleme në vend ende duket i vështirë për një rrugëzgjidhje të shpejtë, dhe kjo bazuar në disa vështirime empirike që po i parashtrojmë në vijim:

Ristrukturimi i huave dhe bashkëpunimi me huamarrësit në mënyrë që të cojnë në ripagimin e huasë bazuar në aftësitë reale të kompanisë nuk ka dhënë rezultatet e duhura. Në disa raste, të cilat nuk janë të pakta, bankat dhe biznesi bien dakort për të rifinancuar apo ristrukturuar huatë, duke synuar që ti krijojnë më shumë kohë palëve të përfshira deri në përmirësimin e situatës së likuiditetit, pa patur një vlersim të thellë të situatës financiare

dhe parashikimit të saktë të kostove dhe të ardhurave të biznesit, apo një cash flow të mirë studiuar.

Pasi bankat kanë ezauruar gjithë opsionet e mundshme për një rekuperim paqësor të huave të dhëna, kanë kaluar në fazën e fundit e të detyrueshme dhe që është ekzekutimi i kolateraleve të huamarrësve, i cili në shumicën e rasteve ka rezultuar një mënyrë joefektive në ripagimin e huave. Shpesh vlera e kolateraleve që mbështesin huatë me probleme kanë një zhvlerësim të madh dhe kjo për disa arsye. Kryesisht huatë e biznesit ofrojnë për kolateral ambjente biznesi, vlera e të cilave në periudhat e rënieve ekonomike bie nën koston e blerjes apo prodhimit të tyre.

Më konkretisht, kolateralet vlerësohen bazuar në metoda të përfitueshmërisë së tyre, dhe që në periudhën e performancës financiare të vështirë, kur këto kolaterale ekzekutohen, vlera e tyre bie ndjeshëm duke bërë të mundur që huatë të mos ripaguhet nga humarresit.

Zhvlerësimet e kolateraleve lidhen ngushtë edhe me psikologjinë dhe kulturën që ekziston në vënde të vogla ku njërëzit njihen me njëri tjetrin, e cila sjellë vështirësi në blerjen e kolateraleve që kalojnë në ekzekutimin përmbarimor.

- **Tranzicioni shqiptar**, si në aspektin ekonomik por edhe në atë politikë ka patur ndikimin e vet në cilësinë e huave në sistemin bankar shqiptar sot, dhe më tepër se kaq, kushtet historike të zhvillimit të biznesit në Shqipëri, mungesa e përvojës në menaxhimin financiar të huamarresve, ka ndikimin e vet në situatën e huave me probleme sot.

- **Kriza aktuale botërore** dhe ndikimet e saj në ekonominë Shqiptare është një faktor mjaft i rëndësishëm që gjithë bankat tregtare po konsiderojnë gjithnjë e më shumë në vlersimin dhe matjen e riskut të huasë në momentin e huadhënies por edhe gjatë monitorimit të tyre. Edhe pse të vonuar, këto vlersime kanë rëndësinë e madhe në huadhëniet e reja dhe në ristrukturimet e huave me probleme.

Duke i njohur këto faktorë / rrethana / kushte, institucionet financiare do të jenë më të afta të kreditojnë biznese apo korporata me një rrezik të minimizuar, ndaj faktorëve ndikues.

Sistemi bankar shqiptar i kreditimit aktiv të ekonomisë ka një eksperiencë jo më shumë se 15 vjet. Edhe pse me një eksperiencë kaq të shkurtër në ekonomine e tregut, sistemi bankar është një nga sektorët më formal dhe më të institucionalizuar në vënd, që ka mbështetur jo

vetëm financiarisht biznesin po edhe duke e konsultuar dhe ndihmuar në formalizimin e mëtejshëm të aktivitetit të tij tregtar. Megjithatë kreditimi që këto banka i kanë bërë ekonomisë edhe pse nën rregulla të forta që favorizojnë hua me rrezik minimal, kanë sjellë një rritje të vazhdueshme të huave me probleme në mënyrë konsistente.

- **Konkurenca në treg**, midis vetë bankave ka ndikuar në dy efekte negative në përkeqsimin e huave me probleme, e para lidhet me kreditimin e biznesit korporatë duke mos marrë në konsideratë gjithë faktorët e rrezikut të huasë, dhe së dyti në nxitjen e bizneseve për të investuar edhe në sektorë e fushta me rrezik të lartë.

Kriza botërore në fund të vitit 2008 e në vazhdim gjithnjë e më shumë po ndikon në uljen e aftësive paguese të bizneseve e për rrjedhojë në përkeqsimin e huave me probleme.

Financimet e biznesit para fillimit të krizës botërore në madhësinë në vlerë të tyre dhe afate kthimi të huave ishin bazuar në ecuritë financiare të mëparshme dhe korente të bizneseve, madje duke konsideruar në vazhdimësi kohore një ritëm rritje bazuar në ecurine historike të tyre. Ndërkohë në 4 – 5 vitet e fundit biznesi përballet me rënie të nivelit të shitjeve dhe më tepër se kaq përkeqsim të likuiditetit të kompanive, si pasojë edhe e ndryshimit të normave të fitimit në vetvete të cilat janë ulur ndjeshëm.

Ajo që po ndodh sot, me ashpërsimin e mëtejshëm të krizës ekonomike, ka të bëjë me faktin se në shumicën e rasteve bankat financojnë kryesisht për shlyerje borxhesh të vjetra dhe jo në financime që sjellin rritje të të ardhurave apo përmirësim të performancës financiare. Kërkesa për financim e biznesit nga ana tjetër është mjaft e ulët, kur bëhet fjalë për investime që synojnë rritje të të ardhurave apo efektivitetit të biznesit apo për mjete xhiroje, pasi biznesi është i ngarkuar me borxhe në limitet e kapaciteteve të tij paguese dhe në shumë raste dhe përtej këtyre limiteve.

Për shkak të nivelit të lartë të huave me probleme dhe ndikimet që ato kanë në bilancet e bankave, këto të fundit janë frenuar në kreditimin e bizneseve gjithashtu.

Rreziku politik në ekonomi luan një rol të rëndësishëm në peshën që huatë me probleme zënë në totalin e portofolit të një banke. Shqipëria në vlerësimet e kryera nga IMF/FMN, si dhe agjensitë ndërkombëtare të vlersimit të riskut sovran, konsiderohet si një vënd me rrezik të lartë, dhe përmirësimet e ndodhura në periudha të shkurtëra në një farë mënyre sjellin dhe një përmirësim të huave me probleme. Bëhet fjalë për njërin faktorë shumë të

rëndësishëm që ndikon në nivelin e riskut të vëndit, dhe që lidhet me ambjentin në të cilin zhvillohet biznesi dhe konkretisht me RISKUN POLITIK.

RISKU POLITIK në ekonomi është një faktor i rëndësishëm në performancën e një korporate ka një varësi apo lidhje lineare të kundërt me faktorë të ndryshëm të një ambjenti të caktuar që merret për referim. Konkretisht Risku Politik është i varur nga stadi i zhvillimit ekonomik të një vëndi, nga faktorë politikë dhe konkretisht nga zbatimi i ligjeve dhe rregullave të Demokracisë, nga ku, ky i fundit është i varur nga niveli ekonomik - social dhe kulturorë i një vendi.

Ndërrimi periodik i partive në qeverisjen e vëndit, bënë që qeveritë e reja të sjellin ndryshime ligjore të shpeshta dhe reforma ekonomike, të cilat krijojnë një stepje të biznesit për investime afatgjata në ekonomi. Niveli i lartë ekonomik dhe stabiliteti ekonomik i një vendi nënkupton një risk politik më të vogël, gjë e cila nuk mund të thuhet për vëndin tonë.

Demokracia ende e brishtë e shoqëruar me një kulturë ku lidhjet familjare janë relativisht të forta janë elemente që frenojnë zbatimin e ligjeve duke dhënë impaktin e tyre në ecurinë e zhvillimit ekonomik të vëndit. Sa më e fortë të jetë Demokracia dhe zbatimi i ligjeve dhe rregullave të saj në një vënd aq më i vogël është risku politik, çështje për të cilat Shqipëria ka ende shumë për të bërë. Kultura demokratike e një populli të arsimuar është një bazë e mirë që eliminon apo zvogelon riskun politik në zhvillimin e klimës së shëndetshme të biznesit të një vendi. Të gjitha sa më lartë janë teori të pranuar nga studiues të shumtë, të cilët janë referuar në këtë material studimor. Rritja e shpejtë e huave me probleme në gjithë sistemin bankar shqiptar, po në mënyrë të veçantë në bankën ku punoj prej më shumë se 12 vjetësh, si një fenomen i ri që për më shumë se pesë vjetë rrjesht pëson rritje sistematike pa dhënë shënja të frenimit të tyre ishte shtysa kryesore për ndërmarjen e këtij punimi.

Ndërsa është bërë përpjekje për të vlerësuar peshën që secili prej këtyre faktorëve të studiuar kanë ndikuar në ecurinë e huave me probleme, dhe kjo nëpërmjet metodave të ndryshme shkencore të përdorura në këtë studim, bazuar në informacionin e marrë në bankën ku punoj dhe më gjërë në sistemin bankar në Shqipëri, nëpërmjet krahasimit të të dhënave me rajonin dhe më gjerë.

1.2 Qëllimi i Studimit të fenomenit të huave me probleme

Qëllimi i këtij studimi është të provojë se: Rreziku i huasë, dhe huatë me probleme në një vënd të caktuar janë mjaft të lidhura me mënyrën e menaxhimit dhe administrimit të portofolit të huasë nga vetë bankat, ndërsa nuk le pa vlerësuar gjithashtu ndikimin e rëndësishëm që kanë edhe faktorë të tjerë që lidhen me kushtet ekonomike dhe specifikat e vëndit, rajonit dhe ato globale. Studimi ka për qëllim të vërë theksin në masat që duhen marrë në rritjen e cilësisë së huadhënies duke vënë theksin në njohjen e faktorëve që ndikojnë në rrezikun e huasë, si dhe në qasjen e përshtatshme të bankave në zgjidhjen e huave me probleme si një mënyrë për daljen nga situata e mungesës së likuiditeti dhe rekuperimin e ekonomisë në tërësi.

Në 15 vitet e historisë së financimit me hua të sektorit privat dhe atij shtetëror në Shqipëri, statistikatat që tregojnë kreditimin e ekonomisë nga institucionet financiare apo niveli i huave me probleme ka nevojë të interpretohet mirë duke marrë në konsideratë jo vetëm qasjen huadhënëse të bankave , e cila përbënë qëllimin kryesor të këtij studimi, por duke e parë këtë qasje të lidhur ngushtë me gjithë kushtet dhe faktorët ekonomik të vëndit.

Ekonomia e një vëndi është gjithmonë e më shumë e lidhur dhe në marrëdhënie të ndërsjellta me ekonominë e vendeve rreth saj apo ato botërore, dhe kjo bënë që kur kreditojmë duhet të konsiderojmë edhe faktorët që influencojnë nga këmbimet tregtare midis vendeve dhe ekonomive, niveli i huave me probleme apo default në një vënd ndikon në një mënyrë apo tjetrën në vëndet fqinjë apo vendet me të cilat ka këmbime tregtare dhe ekonomike.

Kështu del e nevojshme që studimi të përfshijë të dhëna statistikore jo vetëm për Shqipërinë, por edhe në vende të rajonit që ka ngjashmëri e specifika të njëjta. Dhe për të verifikuar këtë hipotezë, mendohet të krahasohen të dhënat statistikore edhe me vende e rajone që kanë kushte politike, ekonomike dhe social kulturore të ngjashme nga ku është përqëndruar studimi.

1.3 Burimet e referimit të punimit

Idea e kryerjes së kësaj teme studimi vjen natyrshëm nga eksperiencia e punës së përditshme, në mënyrë të veçantë në sektorin e kredisë në një nga bankat tregtare në vend.

Si burim parësor për arritjen e një analize të plotë shkencore, në këtë punim kanë shërbyer përgjigjet e marra nga 50 pyetsorët e realizuar me menaxherë të nivelit të lartë e të mesëm të bankave tregtare në Shqipëri.

Ndërsa si burime dytësore në mbështetje të këtij studimi kanë shërbyer të dhënat statistikore të marra nga faqet zyrtare online të institucioneve të rëndësishme në vend, si Ministria e Financave, Banka e Shqipërise, INSTAT, Shoqata e Bankave, bankave tregtare shqiptare, etj.

Për realizimin e këtij studimi, janë marrë si bazë teorike studime të shumta të deritanishme të këtij fenomeni dhe konkretisht studimeve të kryera me tema dhe autorë botërorë të tillë si Shelagh Hefferman, Stiven I Davis, Anthony Saunders & Corent Millon Marcia, Stuart I Greenbaum & Anjan V Thakor.

Një burim mjaft i pasur nga ku jam mbështetur në referimet e këtij studimi kanë qënë paper-at e autorëve të dryshëm botërorë të gjetur në librarinë online në faqen WWW.SSRN.COM

Të tjera burime të referuara për këtë studim janë edhe botime të ndryshme periodike nga vendi dhe bota mbi rrezikun e vendit, rreziqet e tregut dhe rrezikun e kredive, punime të marra nga faqa zyrtare online, i BSH, BB, raportet vjetore të bankave tregtare në vend etj

1.4 Rëndësia e këtij studimi

Rëndësia e këtij studimi vlen shumë në aspektin mikroekonomik dhe qartëson pikëpyetjen e ngritur mbi këtë çështje, se si një institucion financiar duhet t'i shmanget apo minimizojë Rrezikun e huasë. Çfarë duhet marrë në konsideratë kur financon një biznes në një mjedis të njohur të faktorëve që ndikojnë drejtë për së drejti në zhvillimin e suksesshëm të tij.

Një tjetër rëndësi e këtij studimi mendoj se vlen edhe në aspektin Makroekonomik, pasi për rrjedhojë të minimizimit të Rrezikut të huasë nga çdo institucion financiar në vetevete do të sjellë një mjedis biznesi më të suksesshëm dhe efektivitet më të mirë të menaxhimit të burimeve financiare që çojnë drejt një tregu modern e të zhvilluar.

Gjithashtu ky studim ka vlerën e vet, pasi përveç se rikonfirmon përgjigjet e dhëna nga literatura botërore për gjithë pyetjet e shtruara rreth shkaqeve që kanë ndikuar në nivelin e lartë të huave si dhe shkallen e ndikimit të secilit faktor në nivelin e lartë të huave me probleme në mjedisin shqiptar të 10-15 viteve të fundit të tranzicionit ekonomik dhe politik të tij del me gjetje të re shkencore, e cila do tju shërbejë bankave tregtare në praktikimin e qasjeve shkencore në procesin e kreditimit.

Ky punim i cili është bazuar në eksperiencën 15 vjecare të kreditimit të ekonomisë nga sistemi bankar Shqiptar, rikonfirmon rregullin bazë të huadhënies se një kredi e pastudiuar që në nisje është shkak kryesor në moskthimin e saj në kohë, ndërsa rritja e cilësisë së portofolit të huave në banka kërkon edhe një monitorim të ngushtë të kredive të dhëna deri në shlyerjen e plotë të tyre.

Studimi i fenomenit të rritjes së shpejtë të huave me probleme, sugjeron masat që duhet të marrin bankat dhe institucionet financiare për të hartuar politika të përshtatshme me zhvillimet e tregut të tilla që kufizojnë rrezikun e moskthimit të huave në kohë dhe një qasje më të përshtatshme ndaj biznesit huamarrës; vënien e rolit të riskut si primare në vendimarrje; krijimin dhe vënien në funksion të një strukture organizative sa më efektive që krijon një ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi midis dy funksioneve kryesore në bank që janë ato të njësisë së riskut dhe shitjes. Këto masa të jenë të hartuara e të zbatohen në mënyrë të tillë që të sjellin një vlerë të shtuar për institucionin;

1.5 Hipoteza dhe pyetjet kërkimore

Hipoteza që shtrohet në këtë punim është: **“Mirëmeanxhimi i portofolit të huasë ka një rol kyç në uljen e rrezikut të huasë dhe huave me probleme”.**

Ky studim shkencor, pwrpos konfirmimit tw kwsaj hipoteze, synon tw sjellw njw gjetje tw re, e cila del nwpwrmjet identifikimit tw peshws qw zw secili variabel nw nivelin e huave me probleme. Variablat ndikues trajtohen dhe analizohen duke marw pwrvgjigje nga pyetjet kwrkimore tw cilat janw pjesw e analizes vrojtuese nw terren.

Pyetjet kërkimore mbi të cilat bazohet trajtimi i këtij punimi për ti dhënë përgjigje konfirmimit ose refuzimit të hipotezës kryesore, janë si në vijim.

1. A është roli i njësisë së menaxhimit të riskut parësor në vendimarrjen e aplikimeve për kredi?
2. A janë strategjitë, politikat dhe procedurat e huadhënies bankare të përshtatshme për të garantuar një protofol cilësor me nivel të ulët të huave me probleme?
3. A ka një ndarje të qartë të strukturës organizative në banka të shitjes dhe riskut të sektorit të kredisë?
4. A ndikon trainimi i vazhdueshëm dhe matja e performancës individuale të stafit të kredisë në rritjen e cilësisë së portofolit të huasë?
5. Sa fleksibël janë negociatat për zgjidhjen e kredive me probleme?

Në këtë punim një vend të veçantë zë edhe analiza e kushteve ekonomike, duke marrë në konsideratë faktorët makroekonomik të cilët, përveç se kanë ndikuar në rritjen e shpejtë të huave me probleme, kanë qënë shkak për të bërë të dukshëm fenomenin e cilësisë së dobët të huadhënies nga bankat, duke shtuar debatet shkencore mbi shkaqet e rritjes së shpejtë të huave me probleme. Për këtë arsye janë marrë në analizë aspekte të veçanta të rëndësishme që përfaqësojnë situatën dhe kushtet ekonomike të tillë si: Rreziku Sovran i Shqipërisë dhe shkalla e ndikimit të tij në rrezikun e huasë; Kriza botërore, e në mënyrë të veçantë kriza rajonale, dhe ndikimi i saj në rritjen e huave me probleme; Konkurrenca midis bankave në vend dhe efektet negative në përkeqësimin e huave me probleme, kryesisht në drejtim të: a. nxitjes së bizneseve për të investuar edhe në sektorë e fusha me rrezik të lartë, b. krijimin e një portofoli me rrezik, dhe rritjen e huave me probleme; regjistri i kredisë dhe roli i tij në cilësinë huadhënëse në Shqipëri, ecuria e ekonomisë së

vendit në 15 vitet e fundit duke marrë për baze disa nga treguesit më të rëndësishëm makroekonomik.

1.6 Metoda dhe metodologjia e kërkimit

Metoda bazë për identifikimin dhe matjen e saktë të ndikimit të faktorëve të ndryshëm që lidhen me cilësinë e menaxhimit të portofolit nga vetë bankat, është metoda e analizës statistikore dhe analizës vrojtuese, nëpërmjet realizimit të intervistimit të punonjësve të kredisë dhe Riskut në 16 bankat tregtare në vend nëpërmjet pyetsorëve me shkrim. Përgjigjet e marra nga pyetsorët e përdorur në intervistat me punonjës e menaxherë të niveleve të ndryshme në banka janë konsideruar si burimet parësore për të arritur në konkluzione të duhura në këtë punim.

Metodologjia e përdorur janë analizat vrojtuese, pyetsorë për punonjësit e kredisë dhe Riskut në bankën ku punoj, dhe banka të tjera në vend mbi procesin e kreditimit që nga momenti i aplikimit për kredi deri në monitorimin tyre pas kreditimit dhe shlyerjen e plotë të tyre apo zgjidhjen e huave me probleme.

Një bazë e rëndësishme mbi të cilat mbështetet ky hulumtim është Literatura bazë si dhe Botime të ndryshme periodike në vënd dhe në botë mbi analizat e rrezikut të kredisë.

Për të parë qartë diferencimet që kanë në banka te ndryshme në vend dhe impaktet që japin rregulloret dhe procedurat e kreditimit, në cilësinë e portofolit të huave, janë kryer analiza të këtyre praktikave në bankën ku punoj, dhe në banka të tjera në vënd, duke i krahasuar me praktikat moderne botërore të kreditimit.

Në arritjen e konkluzioneve sa më të sakta është shfrytëzuar baza e të dhënave statistikore të publikuara nga institucione të rëndësishme në vend si INSAT, BSH, Ministria e Financave, si dhe ato ndërkombëtare mbi vlerësimin e shkallës së rrezikut politik ne ekonomi.

Si burime dytësore janë konsideruar, analiza e portofolit të kredisë në bankën ku punoj, për të verifikuar nëse variablat e supozuar kanë një impakt real në cilësinë e portofolit të huave, si dhe të dhënat statistikore të mara nga faqet zyrtare online të institucioneve të rëndësishme në vend.

Programi statistikor SPSS (Statistical Package for Social Science) i përdorur në këtë studim ka bërë të mundur analizimin e kombinuar të të dhënave statistikore me përgjigjet e pyetsorëve, duke na dhënë rezultate të cilat kanë një rrjedhë llogjike e shkencore.

Në arritjen e konkluzioneve të drejta mbi fenomenin e rritjes së kredive me probleme në sistemin bankar shqiptar si një fenomen i shfaqur gjatë 4- 5 viteve të fundit, shërbejnë të dhënat statistikore të publikuara nga BSH (Banka e Shqipërisë). Kombinimi i të dhënave të mara nga burime dytësore, me përgjigjet e marra nga burime parësore, duke i përpunuar në modelet statistikore arritën të nxjerrin varësinë që kanë variablat e ndryshëm në cilësinë e portofolit të huave.

Analiza e procesit të kreditimit në vend është bërë bazuar në vërtetime si dhe pyetsorë të zhvilluar me menaxherë të nivelit të mesëm e të lartë në 16 bankat tregtare në vend, duke u fokusuar me shumë në bankat të cilat kanë qënë më aktive në kreditimin e ekonomisë së vendit. Janë veçuar pesë bankat më aktive në kredidhënie, të cilat kanë qënë fokusi kryesor në këto pyetsor, duke kryer intervistime në disa drejtorë të niveleve të ndryshme në sektorin e kreditimit, me synim arritjen e një konkluzioni sa më të drejtë mbi administrimin e huave në këto banka.

Pyetsorët janë hartuar me 22 –pika, të cilat kanë mbuluar gjithë procesin e kreditimit në bankë duke filluar nga moment i aplikimit për një kredi deri në monitorimin dhe ripagimin e plotë të saj, duke përshkruar gjithë fazat dhe proceset vlerësuese në të cilat kalon një aplikim kredie e suksesshme dhe jo e suksesshme. Numri i shumtë i pyetjeve të ngritura në pyetsore, synoj garantimin e gjetjes të sa me shumë variablave të mundshme ndikues në nivelin e huave me probleme, ndërsa vetëm 10 prej tyre gjeten përdorim efektiv në modelin statistikor SPSS. Çdo çështje ka vlerime të ndryshme në varësi të pyetjes që shtrohet, dhe të intervistuarit janë njohur me qëllimin e hulumtimit duke garantuar që përgjigjet të jenë sa

më të sinqerta e korrekte. Numri i të intervistuarëve në 16 bankat tregtare të vendit arriti në 50 persona, të cilët ishin të pozicionuar në nivele të ndryshme të menaxhimit në sektorët e aktivitetit kreditues.

Të dhëna statistikore janë marrë nga publikimet e Bankës së Shqipërisë si dhe vetë bankave tregtare, gjatë viteve 2003-2014, kohë gjatë të cilës sistemi bankar shqiptar është integruar me sistemin financiar të ekonomisë së tregut. Është marrë në konsideratë portofoli i huave dhe cilësia e tij, e parë kjo ngushtë nga ndikime të faktorëve të ndryshëm bazuar në ambjentin aktual në të cilin operojnë bizneset, dhe më konkretisht në të dhëna statistikore mbi PBB (Prodhimin e Brendshëm Bruto), Vlersimin e shkallës së Rrezikut të Vendit nga Agjensitë Ndërkombëtare Standard&Poors, Moody's etj, prirja e remitancave, niveli i papunësisë etj.

Në arritjen e konkluzioneve të drejta mbi fenomenin e rritjes së kredive me probleme në sistemin bankar shqiptar si një fenomen i shfaqur gjatë 5 viteve të fundit studimi bazohet në kombinimin e të dhënave statistikore të publikuara nga BSH (Banka e Shqipërisë), dhe kërkimet në terren nëpërmjet pyetsorëve të realizuar me menaxherët e kredisë në banka, duke i përpunuar në modelet statistikore për të nxjerrë varësinë që kanë variablat e ndryshëm në cilësinë e protofolit të huave.

Periudha e referimit është 2003-2014, e ndarë kjo sipas tipologjisë që lidhet me shfaqjen e fenomenit të huave me probleme në vend, dhe kryesisht është ajo midis dy periudhave, 2003-2008, që njihet si periudha e rritjes ekonomike dhe paralelisht bumit të kredive dhe 2009 deri në 2014, si periudha e rënies ekonomike nën ndikimin e krizës ekonomike globale aktuale e shoqëruar me një rritje të shpejtë të kredive me probleme.

- Periudha e parë 2003-2008, është shoqëruar nga fenomene të euforisë që vinte si pasojë e të dhënave që bizneset regjistronin në bilancet e tyre financiare, me një rritje historike të ecurive financiare të shpejtë nga viti në vit, dhe ndërkohë që kërkesë oferta për mallra në treg ka qënë më e balancuar.

- Periudha 2009 deri 2014 dhe fenomeni i rritjes së shpejtë të huave me probleme gjatë saj, si pasojë e ndikimit që ka kriza ekonomike botërore në performancën financiare të bizneseve në Shqipëri, nxori dukshëm fenomenin e një niveli jo të mirë cilësie të portofolit të huave në banka.

1.8 Mundësitë dhe kufizimet

Hulumtimi i kësaj teme, mundëson investigimin e prirjes rritëse të huave me probleme, duke përfshirë në analizë të dhënat sasiore me ato cilësore, të dhënat e marra nga burime parësore e dytësore, duke u zgjeruar në një spektër më të gjërë të të dhënave statistikore të publikuara nga institucione të rëndësishme të vendit dhe ato botërore.

Studimi ka kufizimet e veta, pasi kemi të bëjmë me vetëm një fenomen, atë të prirjes rritëse të huave me probleme në 16 bankat tregtare në vend, ndërsa në ecurinë e këtyre huave me probleme, faktorët ndikues janë të shumtë, me varësi të ndryshme nga njëri tjetri, duke e bërë relativisht të vështirë matjen e saktë të ndikimit të tyre në to. Lehtësia për të dalë në konkluzione të gabuara, në se bazohemi vetëm në të dhëna statistikore, pa i lidhur ato me fenomenet në vend (maturimi i tregut, dhe ciklet e zhvillimit të disa degëve të industrisë në vend dhe pa konsideruar historikun dhe momentin / fazën e maturimit të portofolit të çdo banke).

Mund të mbartin pasaktësi, përgjigjet e marra nga vrojtimit dhe pyetsorët, pasi subjektiviteti shpesh është i pranishëm në këto lloj vrojtimesh e intervistash.

Për më shumë se kaq vendimarrja mbi financimin e çdo aplikimi kredie mbart në vetvete edhe subjektivitet në gjykim, dhe ky subjektivitet nuk mund të matet e vlerësohet, por njihet dhe pranohet si i tillë me një marzh gabimi të ulët pa ndikuar në thelbin real të çështjes në studim.

Ekonomia e tregut dhe eksperiencia e ekonomisë shqiptare është e kufizuar në kohë, dhe pse e tillë ciklet e biznesit kanë qënë të shkurtëra duke krijuar më shumë konfuzion mbi

shkaqet reale të ndikimit në nivelin e huave me probleme, në se janë faktorë realë sikundër dhe ato që njihen nga literatura botërore apo lidhen me faktorë specifikë të vendit dhe që janë ndikuar më shumë nga tranzicioni i gjatë që i është dashur vendit për të kaluar në një ekonomi tregu modern e të sofistikuar.

Bankat tregtare kanë në themel të operimit të tyre ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit, dhe kjo mund të deformojë përgjigjet që japin menaxherët e sektorit të kredisë gjatë procesit të intervistimit të tyre nëpërmjet pyetsorëve, duke na dhënë një vlersim jo të saktë të situatës. Gjithashtu, ka vështirësi në gjetjen e të dhënave të ndryshme statistikore pasi në vendet në tranzicion si Shqipëria mungojnë këto të dhëna.

Për të eliminuar këto mangësi janë kryer tre-kater herë intervistimet në nivele të ndryshme menxhimi në të njëjtën bankë tregtare, duke mesatarizuar përgjigjet e secilës bankë, dhe kjo sidmos për pesë bankat më aktive në kreditim. Një tjetër mënyrë për të kufizuar mangësitë që mund të vijnë nga të dhënat e marra për bazë në studim është përpjekja e bërë duke kryqëzuar të dhënat statistikore të publikuara nga institucione të ndryshme për të konfirmuar vlefshmërinë e tyre.

KAPITULLI II- SHQYRTIMI I LITERATURES

2.1 Hyrje

Ky kapitull trajton dhe diskuton literaturën ndërkombëtare rreth menaxhimit modern dhe të përshtatshëm të rrezikut të huasë, si një nga mënyrat kryesore që ruan cilësinë e portofolit duke sjellë uljen e nivelit të huave me probleme. Gjithashtu, përmbledh disa debate që zhvillohen sot rreth riskut të kredise dhe përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë së protofolit në përputhje me zhvillimet e tregut në tërësi.

Nëpërmjet literaturës ndërkombëtare është sjellë në mënyrë të përmbledhur në këtë punim edhe mënyra e zbatimit konkret në praktikat bankare të menaxhimit të riskut të kredisë, e strukturuar kjo sipas niveleve të menaxhimit në bankë, duke përfshirë të gjithë aspektet e menaxhimit të riskut të kredisë. Njohja e këtyre praktikave do të shërbejë si bazë krahasimi e vlerësimi për menaxhimin e riskut në sistemin bankar shqiptar.

Administrimi i mirë i procesit të kreditimit që nga momenti i përzgjedhjes së aplikimeve për hua e deri në mbledhjen e këtyre huave është kyç në suksesin e një Institucioni Financiar. Tejkalimi i rrezikut sjell rritjen e kredive të këqia, të provigjonëve dhe humbjeve nga kredia të cilat dobësojnë vlerën e institucionit hudhënës nëpërmjet efektit negativ në uljen e fitimit.

Institucionet bankare përballen me vështirësi të mëdha likuiditeti e stabiliteti nëse njësitë e rrezikut të kredisë kanë një drejtim apo rol të dobët në këtë proces, nëse gjatë procesit të kreditimit cënohen standartet e kreditimit ndaj huamarrësve apo palëve të lidhura në një transaksion, apo nëse nuk tregohet kujdes ndaj ndryshimeve ekonomike apo rrethanave të tjera që mund të ndikojnë negativisht në aftësinë paguese të huamarrësve.

2.2 Strategjitë dhe politikat e kreditimit për çdo institucion huadhënës mbi menaxhimin e riskut të kredisë sipas praktikave më të mira botërore

Koncepti i riskut është i lidhur me pritshmëritë njerëzore dhe aftësinë e mundësisë së parashikimit apo ndërhyrjes në situata apo rrethana të panjohura ose të pasigurta. Në gjuhën e përditshme termini rrezik përdoret shpesh si sinonim i probabilitetit apo mundësisë së një humbjeje apo kërcënimi të moskthimit të huasë së dhënë.

Së fundmi këtij koncepti i është përshtatur një përkufizim më i gjërë rrezik - oportunitet-mundësi, nëpërmjet të cilit rreziku jo domosdoshmërisht shihet në sensin e një ngjarjeje negative, por edhe në një përfundim të mundshëm pozitiv.

Në financë me rrezik përkufizohet mundësia që investimi i zgjedhur të mos prodhojë rezultatet e parashikuara. Për rrjedhojë mund të realizohen fitime më të ulta se pritshmëritë, por edhe të pësohen humbje të një pjese ose të total fondeve të investuara (për të mos përmendur këtu edhe mundësinë e humbjeve përtej fondeve të investuara).

Në nivel të përgjithshëm rreziqet ndahen në dy lloje: Risk sistematik (i padiversifikueshem) dhe Risk jo sistematik (i diversifikueshem). Rreziku sistematik përfshin të gjithë tregun (ose një segment të plotë tregu) dhe është njëkohësisht sa i paparashikueshëm, aq edhe i pamundur të evitohet plotësisht. Ky risk nuk mund të mitigohet nëpërmjet diversifikimit.

Rreziku jo sistematik (sipas fjalorit financiar) është rreziku specifik që përfshin çdo investim dhe është i diversifikueshem. Në kategorinë e parë bëjnë pjesë rreziku i tregut, rreziku i normës së interesit, etj., ndërsa në kategorinë e dytë mund të përmendim riskun e biznesit dhe riskun e kredisë.²

Risku i kredisë sipas përkufizimit të Komitetit të Basel-it (September 2000) është risku potencial që një humarrës individual mund të mos jetë i aftë të paguajë detyrimet e kredisë (principal dhe/ose interes) sipas termave të rëna dakort. Ky risk është prezent në të gjitha transaksionet e huasë dhe si i tillë influencon zgjedhjet e investimit të Bankve, të Ndërmjetësve të tjerë Financiare dhe investuesve në tituj obligacionare.³

² <http://financial-dictionary.thefreedictionary.com/Nonsystematic+risk>

³ BIS “Principles for the Management of Credit Risk” - final document, September 2000.

Për rrjedhojë risku i kredisë merr një vëmendje mjaft të madhe nga Bankat dhe mbikqyrësit, duke rritur ndërgjegjësimin që në identifikimin e këtij rreziku dhe deri në matjen dhe monitorimin e tij, në mënyrë që të jenë të aftë të përcaktojnë dhe mbajnë një kapital të mjaftueshëm rezervë kundrejt rreziqeve.

Në përgjithësi vërehet se sa më i lartë të jetë rreziku i kredisë, aq më e lartë është norma e aplikuar e interesit si kompensim për ekspozimin më të lartë kundrejt këtij risku.

Rreziku i kredisë sipas Derviz (2005) influencohet si nga cikli i ekonomisë, ashtu edhe nga ngjarje që lidhen me debitorin, në këtë rast kemi të bëjmë me risk specifik. Ky rrezik zvogëlohet në rastet e ekspansionit ekonomik dhe rritet në rastet e recensionit ekonomik⁴. Në rast se verifikohet mundësia që kundërpartia debitore të mos jetë në gjendje të paguajë huanë (rikthim principali) dhe interesat e maturuar, duhen marrë masat për të ulur Rating aktual të klientit (huamarrësit / kredimarrësit). Ky operacion njihet me termin “Downgrade”

Qëllimi i menaxhimit të riskut është të maksimizojë fitimin e Bankës në kushtet e një risku të marrë përsipër duke mbajtur një nivel të caktuar të ekspozimit brenda parametrave të pranueshëm e të menaxhueshëm. Banka ka të nevojshme të menaxhojë jo vetëm riskun që vjen nga çdo kredi individuale ose nga gjithë portofoli i kredisë, por edhe nga risqet e tjera që nuk vijnë nga kreditë. Këtu mund të përmendim rrezikun që rrjedh nga transaksionet e ndryshme bankare të tilla si: transaksionet ndërbankare, këmbimet valutore, instrumentat financiarë derivate (future, swaps, etj.), angazhimet dhe garancitë e ndryshme etj. Gjithë keto janë instrumenta financiarë kompleks, të cilët për përdorimin e gjërë që kanë patur në tregun e kapitaleve – të konsoliduar në fillimin e viteve 2000 – kanë fituar një rol qëndror në mbarë ekonominë botërore.

Çdo bankë e ka të domosdoshme të krijojë kushte dhe ambient të përshtatshëm pune të tillë që menaxhimi i riskut të kredisë të bëhet një praktike e mirëstrukturuar, e qartë dhe të operojë si një proces normal i natyrshëm.

⁴ Derviz, A and Kadl, N. “Business cycle, credit risk and economic capital determination by commercial banks, (April 2005)

Sipas Curiak, D. (2010), sistemi aktual i mbikqyrjes dhe rregullimit financiar është një volum gjigand teorik që përmbledh eksperiencat më të dobishme të fituara me dhimbje nga mësimet e krizave dhe dështimeve. Në ditët e sotme këto çështje ngrenë pyetjen se si një institucion financiar individual duhet të menaxhojë punën e tij për të mbijetuar e patur sukses. Funksionimi Perfekt apo i njohur me shprehjen “state of art” dhe përpjekjet për të përmirësuar atë, përballë pakësimit apo uljes së vleres se kthimit të huasë.⁵

Vendosja e njësisë së riskut në kushte të përshtatshme operimi, duke krijuar një bazë të rëndësishme për një efektivitet të lartë të punës së tij çon në rritjen e cilësisë së portofolit të huave dhe më gjërë në garantimin e suksesit të Bankës në afatin e gjatë. Kjo përparësi e riskut do të bazohet në disa parime të rëndësishme, të cilat përfshijnë detyra dhe përgjegjësi të Bordit të Drejtorëve, Menaxhimit të Lartë, njësisë operuese në menaxhimin e kredive, kontrollit në Bankë etj.

Bankat duhet të operojnë nën rregulla dhe procedura mjaft të qarta e të sakta, në përputhje me fazat e zhvillimit të ekonomisë së vendit, të zhvillimeve të industrive përkatëse (duke ndjekur me dinamizem tendencat e këtyre zhvillimeve). Pavarësisht stadeve të zhvillimit të vendeve ku bankat operojnë, eksperiencat e derisotme kanë treguar se Standartet jo të forta në huadhënie, një menaxhim Risku i dobët i portofolit të huave, apo mungesa e vëmëndjes ndaj ndryshimeve ekonomike apo rrethanave të tjera në tregun vendas ose të jashtëm sjellin përkeqsimin e cilësisë së portofolit të kredive dhe humbjen e kapitalit të Bankave.

Për shumicën e Bankave huatë janë burimi më i madh i riskut, citon Revell, J. (1978), ndaj duhet që praktikat e kreditimit të marrin rëndësi parësore në procesin e kreditimi. Në këtë frymë thuhet se një Bankë është e shëndetshme aq sa janë kreditë e saj⁶. Cilësia e mirë e financimeve të dhëna nga njësitë kredituese, përbën një kusht të rëndësishëm për funksionimin e rregullt të sektorit financiar në sistemin ekonomik.

⁵ Ciuriak, .D.: “Implementing Better Banking Regulation And Standards -lessons from the past”, Mars 2001, (rishikuar në Shkurt 2010).

⁶ Revell, J. “Rischio e solvibilita’ delle Banche, Milano, Ed. Comunita’, 1978, fq. 32

Basel (2000), jep një trajtim të plotë të parimeve bazë për vlerësimin e rrezikut të kredisë nga bankat, duke përcaktuar se ato duhet të jenë sa më të shëndetshme dhe të shmangin sa më shumë risqet potenciale dhe për të garantuar suksesin e një portofoli cilësor e të qëndrueshëm, praktikat e kreditimit duhet të jenë të vendosura nën katër kushte baze: 1. Të përshtatshme për riskun e kredisë 2. Të operojnë brenda një procesi të shëndetshëm kredidhënieje 3. Të masin, administrojnë dhe monitorojnë riskun e kredisë dhe 4. Të garantojnë përditësimin e rrezikut të kredisë.⁷

Banka të ndryshme mund të kenë specifika të ndryshme të praktikave të kreditimit bazuar në natyrën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të tyre kredituese, por gjithsesi këto praktika duhet të kenë në bazë katër kushtet e përmedura më sipër. Praktikrat e kreditimit duhet të aplikojnë standarte të shëndetshme që i referohen vlerësimit të cilësisë së aseteve dhe përditësimit të provigjoneve dhe rezervave.

Në këto kushte, mbikqyrja dhe kontrolli i praktikave të kreditimit do të bazohet në faktorët dhe kushtet specifike në të cilat Banka operon.

2.3 Parimet bazë të menaxhimit të riskut të kredisë dhe roli i strukturave të larta të bankës në hartimin dhe zbatimin e tyre në praktikë

Për një operim sa më efektiv të aktivitetit të saj kreditues, çdo bankë e ka të domosdoshme të vendosë riskun e kredisë nën kushte e parime të mirë përcaktuara paraprakisht, bazuar në praktikrat më të mira botërore dhe eksperiencat e fituara gjatë krizave. Fushat në të cilat duhet të shtrihen këto parime duhet të mbulojnë aspekte të tilla si ajo e krijimit të ambjentit dhe rrethanave për një menaxhim sa më efektiv të riskut; operimit nën një proces të shëndetshëm kreditimi; mbajtjen e një administrimi të përshtatshëm të kredive dhe krijimin e një procesi monitorimi koherent.

Komiteti Baselit (2006) jep një përkufizim të qartë të ndarjes së punës dhe përgjegjësi në banka duke theksuar se, ndarja e menaxhimit të riskut të kredisë sipas niveleve të hierarkisë

⁷ The consultative document released September 2000 (<http://www.bis.org/publ/bcbs75.htm>) fq.1

në bankë garanton një funksionim efektiv të riskut dhe ndarja e qartë e përgjegjësiave për çdo nivel menaxhimi në bankë, duke filluar që nga Bordi i Drejtorëve e deri te specialisti më i thjeshtë, është thelbësore⁸.

Po sipas këtij dokumenti të Komitetit të Baselit (2006), vihet theksi në rolin e rëndësishëm që duhet të ketë Bordi i Drejtorëve në menaxhimin e riskut në bankë dhe këtë rol e siguron nëpërmjet disa funksioneve. Parësore është përgjegjësia që ky organ ka në aprovimin dhe rishikimin periodik të strategjisë së riskut të kredisë dhe politikave të veçanta të riskut të kredisë së bankës.

Strategjia duhet të reflektojë tolerancën për risk të bankës dhe nivelin e përfitueshmërisë që banka pret të arrijë. Ky parim i rëndësishëm nënkupton që banka duhet të jetë e pajisur me metodat dhe metodologjitë e duhura për të kryer dhe riparë strategjitë e saj të riskut. Strategjia e riskut të kredisë si dhe politikat e kreditimit duhet të aprovohen dhe rishikohen nga Bordi Drejtoreve, i cili ka të qartë se strategjia dhe politikat duhet të mbulojnë shumë aktivitete në të cilat ekspozimi i bankës ndaj riskut është i njohur dhe i matshëm.

Strategjia e bankës duhet të përfshijë dhe përcaktojë tipet e huave sipas natyrës së huamarrësit dhe qëllimit të përdorimit të tyre (të tilla mund të përmenden hua tregtare, hua konsmatore, hipotekare) sipas sektorëve të ekonomisë në të cilët operojnë huamarrësit, vendndodhjes gjeografike, monedhës, afateve të ripagimit dhe përfitueshmërisë.

Në strategjinë e bankes (Basel Committee 1999) do të përfshihet edhe përcaktimi i tregut të synuar dhe karakteristikat e përgjithshme që një bankë do të donte të arrinte në portofolin e saj të kredive, duke përfshirë këtu edhe nivelet e diversifikimit dhe tolerancës së përqëndrimit për çdo tip huash. Strategjia e bankës gjithashtu duhet të përcaktojë edhe qëllimin që duhet të arrijë në cilësinë e portofolit të huave, fitimet dhe rritjen. Pavarësisht madhësisë së bankës në treg, për të qënë me fitim dhe konsekuente, është e domosdoshme që Bordi i drejtorëve duhet të aprovojë strategjinë e bankës për zgjedhjen e riskut dhe maksimizimin e fitimit. Gjithashtu, është e rëndësishme të rishikohen rezultatet financiare

⁸ Basel Committee on Banking Supervision "Sound Credit risk assessment and evaluation for loans" June 2006. Pg.5.

në mënyrë periodike dhe bazuar në këto rezultate të përcaktohen në se duhen bërë ndryshime në strategjinë e institucionit. Në strategjinë e menaxhimit të kredisë është i rëndësishëm përcaktimi i nivelit të kapitalit të bankës, nëse rezulton i mjaftueshëm për risqet e prezumuara në tërë organizatën⁹.

Strategjia e riskut të kredisë duhet të përcjellë qasjen e vazhdueshmërisë, ndaj dhe strategjia duhet të marrë në konsideratë edhe aspektet ciklike të çdo ekonomie dhe që mund të kontribuojnë në ndryshime të rëndësishme të përbërjes dhe cilësisë së portofolit në përgjithësi. Strategjia duhet të rivlerësohet dhe amendohet periodikisht, dhe duhet të jetë e vlefshme në një afat të gjatë kohor dhe kjo e shtrirë në gjithë ciklet ekonomike.

Strategjia e riskut të bankës dhe politikat duhet të komunikohen në mënyrë efektive në të gjithë organizatën e bankës dhe gjithë personeli, sipas përkatesive, duhet të kuptojë qartë qasjen e bankës në kredidhënie dhe duhet të jetë e përshtatur me politikat dhe procedurat e kredidhënies.

Banka duhet të sigurojë që niveli i lartë i menaxhimit të bankës të jetë plotësisht i aftë të menaxhojë dhe drejtojë aktivitetin kreditues të bankës dhe se ky aktivitet kreditues të jetë brenda strategjisë së riskut, politikave dhe tolerancës së aprovuar në Bord. Bordi rregullisht (sipas një frekuence të mirëpërcaktuar nga institucioni) duhet të aprovojë kriteret e huadhënies së kredive në përputhje me strategjinë e bankës për riskun e kredisë dhe politikave të kreditimit, duke përfshirë këtu kushtet dhe termat e kredive.

Banka duhet të jetë e kujdesshme që në praktikën e saj të kreditimit të minimizohen deri edhe eliminohen plotësisht rastet e konflikteve të interesit për çdo nivel hierarkie të punonjësve të kredisë.

Komiteti i Baselit (2000) këshillon se Banka, nëpërmjet Bordit të Drejtorëve, duhet të sigurojë me praktika të qarta që nuk ka konflikt interesi midis anëtarëve të Bordit (sidomos për drejtorët e jashtëm) kur ka raste biznesesh të reja potenciale që hyjnë në bankë për kredi. Në këto kushte banka përcakton paraprakisht nivelin e kreditimit dhe termat e

⁹ Basel Committee on Banking Supervision “Principles for the Management of Credit Risk”, consultative paper issued for comment by 30 November 1999, pg 1 to 11

kredive. Me qëllim që të shmangen konfliktet e interesit, është e rëndësishme që anëtarët e Bordit të mos përfshihen në kredidhënie apo në proceset e monitorimit në bankë.

Gjithashtu sipas Basel (2000), këshillohet që banka duhet të bëjë kujdes që në kompetencat e Bordit të Drejtorëve të përfshihen edhe politikat e shpërblimeve, të cilat duhet të reflektojnë strategjinë e riskut. Politikat e shpërblimit duhet të jenë të tilla që të shmangin praktika që shpërblejnë qasje të papranueshme të tilla si gjenerimi i fitimeve të shpejta që devijojnë nga politikat e kredisë, ose tejkalimit të limiteve të vendosura dhe që dobësojnë proceset e kredisë në bankë.

Menaxhimi i lartë ekzekutiv i bankës duhet të jetë përgjegjës për zbatimin e strategjisë së riskut të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve si dhe për zhvillimin e politikave dhe procedurave, për identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin e riskut të kredisë. Këto politika e procedura duhet t'i adresohen riskut të kredisë në gjithë aktivitetin bankar në të dy nivelet atë individual dhe në nivel portofoli.

Menaxhimi i bankës duhet të sigurojë se strategjia e riskut të kredisë, e aprovuar nga Bordi i Drejtorëve, të gjejë zbatim të plotë. Kjo nënkupton dhe përfshin që gjithë aktiviteti huadhënës i bankës të operojë konform strategjisë së vendosur, që procedurat e shkruara janë zhvilluar dhe zbatuar, dhe që aprovimi i huave dhe rishikimin i përgjegjësive janë të qarta dhe të kuptuara siç duhet nga gjithë nivelet e menaxhimit dhe operimit. Gjithashtu, menaxhimi i lartë i bankës duhet të sigurojë që ka një vlerësim periodik e të pavarur të funksioneve kredidhënëse në bankë. Në këtë mënyrë banka arrin të minimizojë risqet potenciale.

Sipas BIS (2006), banka duhet të ketë një sistem mbikqyrjeje efektive në përputhje me kërkesat minimale të BASEL –it për të promovuar stabilitetin në tregjet financiare. Në mënyrë të veçantë, parimet bazë kërkojnë që banka të ketë politikat procedurat dhe praktikat bashkëkohore për vlerësimin e cilësisë së aseteve dhe që provigjonet që vijnë nga

humbjet e huave të jenë sa më aktuale duke aftësuar mbikqyresit që të kenë një pamje të vërtetë dhe të drejtë të kushteve financiare të përfitueshmërisë së biznesit të bankës.¹⁰

Bankat e vogla e kanë të vështirë që të mund të arrijnë të përfshijnë në operativitetin e tyre këtë aspekt të menaxhimit të riskut të kredisë, por ato mund të balancojnë në mënyrë të përshtatshme këto praktika në mënyrë që të garantojnë vendimarrje kredie të shëndetshme.

Banka duhet të sigurojë që ka hartuar e ka vënë në zbatim politika dhe procedura të shkruara të cilat i referohen identifikimit, matjes, monitorimit dhe kontrollit të riskut të kredisë, për të garantuar minimizimin e riskut të kredisë. Sa më të plota dhe në detaje të përshkruhet në këto politika e procedura kreditimi çdo aspekt i menaxhimit të riskut të kredisë (që nga identifikimi e deri te kontrolli i riskut të kredisë) aq më efektiv do të jetë procesi i menaxhimit të riskut në banka.

Politikat e kredisë i adresohen çështjeve të tilla si tregu i synuar, diversifikimi i portofolit, termat dhe kushtet e kredive, struktura e limiteve, autoritetet aprovuese, raportimet e rasteve përjashtimore etj.

Të tilla politika duhet të jenë të përcaktuara qartë, në përputhje me kërkesat rregullatore dhe të përshtatshme për natyrën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të bankës. Politikat e kredisë duhet të jenë hartuar dhe zbatuar brenda kontekstit të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të tilla si pozicioni në treg i bankës, fusha e tregtisë, kapacitetet e stafit dhe teknologjisë. Duke njohur faktorët e brendshëm dhe të jashtëm, banka e ka të lehtë të përcaktojë brenda politikave të saj produktet e kredisë, limitet e kreditimit, sektorët e industrisë që i adresohet, termat që lidhen me çmimet dhe me kushtet e tjera.

Politikat dhe procedurat që janë hartuar e zhvilluar në mënyrë të përshtatshme, aftësojnë bankën për të mbajtur standarte të shëndetshme të kreditimit, për të monitoruar dhe kontrolluar riskun e kredisë, për të vlerësuar në mënyrë të përshtatshme aplikimet e reja potenciale për kredi dhe për të identifikuar e administruar problemet e kredisë.

¹⁰ Basel Committee on Banking Supervision "Sound Credit risk assessment and evaluation for loans" June 2006,

Bankat dhe institucionet huadhënëse janë mjaft të veçanta përse i përket natyrës së risqeve që ato mbartin në aktivitetin e tyre. Si të tilla ato operojnë nën korniza strikte rregulloresh, në mënyrë që të garantojnë shmangien nga risqet eventuale. Sikundër shprehet edhe Arukumar (2005): “Bankat nuk janë si bizneset e tjera. Ato luajnë një rol kritik në ekonomi, ndaj është e nevojshme të diferencohen nga një rregullim më intensiv sesa sektorët e tjerë”.¹¹

Menaxhimi i lartë ekzekutiv i Bankës zhvillon e zbaton politika dhe procedura që të sigurojnë që protofoli i kredisë është i diversifikuar në mënyrë të përshtatshme në raport me tregun e synuar të bankës dhe strategjinë e përgjithshme të kredisë. Në mënyrë të veçantë të tilla politika duhet të vendosin synimet për diversifikimin e portofolit, limitet e ekspozimit për një palë të vetme apo grup palësh të lidhura, industritë e veçanta apo sektorë ekonomik të veçante, rajone gjeografike apo produkte specifike. Banka duhet të sigurojë që limitet e ekspozimeve të tyre të brendshme përputhen me çdo limit të prurës ose ndalimeve të vendosura nga mbikqyrja bankare.

Banka duhet të sigurojë që komunikon në gjithë organizaten politikat e kredisë dhe jo vetëm në stafin e kredisë duke arritur një efektivitet të lartë të tyre. Proçedurat duhet të jenë të hartuara në mënyrë të përshtatshme dhe rishikohen periodikisht në mënyrë që të garantojnë zbatimin sa më plotë të politikave të kredisë. Proçedurat duhet të marrin në konsideratë gjithë ndryshimet që ndodhin në rrethanat e brendshme dhe të jashtme dhe të zbatohen, aty ku është e përshtatshme, mbi baza të konsoliduara dhe në nivel individual.

Gjithashtu politikat duhet të adresohen në mënyrë të barabartë të funksionet e rëndësishme të rishikimit të kredive mbi baza individuale, duke siguruar një diversifikim të përshtatshëm në nivel të protofolit total të kredive të bankës.

Hartimi dhe zbatimi i politikave e proçedurave moderne dhe të përshtatshme të kreditimit si dhe përzgjedhja e një stafi menaxherial sa më të kualifikuar janë thelbësore në suksesin e menaxhimit të riskut të një banke.

¹¹ Arukumar Rekha (Professor), Kotreshwar Phd G. “Risk management in commercial banks” Pg.3 December 2005.

E gjejmë të shprehur këtë rëndësi edhe te Andrew W. Lo, (2009) i cili konsideron:

“krizat financiare që vijnë nga fluskat e tregut dhe plasjes së tyre ashtu si stuhitë dhe forcat e tjera të natyrës, të cilat nuk mund të eliminohen tërësisht, por efektet e tyre shkatërruese mund të mitigohen me një pregatitje të përshtatshme. Në fakt, efektet më të rënda të krizave financiare nuk janë humbja e pasurisë, por humbja që rrjedh nga stafi i papërgatitur për të tilla humbje dhe kësaj situate i përgjigjen me panik. Këto qëndrime nxjerrin nevojën për një tjetër reforme rregullatore, e cila të përqëndrohet në një transparence më të madhe, rregullore më të përshtatshme, duke përfshirë dhe çertifikatat e ekspertizës për menaxherët dhe drejtorët e lartë të institucioneve financiare”¹²

2.4 Praktikrat e kreditimit dhe rregullimi i tyre nëpërmjet procedurave të qarta e të plota të kreditimit

Banka duhet të identifikojë dhe menaxhojë risqet potenciale në gjithë produktet dhe aktivitetet e saj, duke siguruar që risqet e produkteve dhe aktiviteve të reja, të jenë subjekt i procedurave dhe kontrolleve të përshtatshme përpara se të përdoren ose ndërmeren dhe aprovohen më parë nga Bordi i Drejtorëve apo komitetet përkatëse.

Baza për një proces efektiv të menaxhimit të riskut është identifikimi i risqeve potencialë ekzistues, në produktet ose aktivitetet e bankës. Banka duhet të zhvillojë një kuptim të qartë të risqeve të kredisë që përfshihen në shumë aktivitete kredidhënëse komplekse si psh: huatë për sektorë të caktuar të industrisë, derivatet e kredisë etj. Kjo është, në mënyrë të veçantë, e rëndësishme pasi risku i kredisë që përfshihet në to edhe pse nuk është e ri për bankën, mund të jetë më pak i dallueshëm dhe kërkon me shumë analiza se risku në aktivitetet kredidhënëse tradicionale. McKinley shprehet se është një fakt i pamouneshëm, që bankat duhet në mënyrë konstante të monitorojnë profilin e rrezikut për të përcaktuar që

¹² Andrew W.Lo “Regulatory Reform in the Wake of the Financial Crisis of 2007-2008” March 2009, SSRN paper.

praktikat e ardhme të kreditimit janë konsistente me profilin e rrezikut të dëshiruar.¹³(Mckinley 1994). Gjithashtu në aktivitetet komplekse kredidhënëse kërkohen procedura të mirë përshtatura, kontrole dhe ende duhet që të aplikohen parimet bazë të menaxhimit të riskut të kredisë. Aktivitetet e reja kërkojnë planifikime shumë të sakta dhe me një analizë të kujdesshme për të siguruar që risqet janë identifikuar dhe menaxhuar në mënyrë të përshtatshme.

Kur bankat angazhohen në dhënien e kredive ndërkombëtare, ato ndërmarrin një risk të shtuar dhe që ka të bëjë me riskun që shoqëron kushtet e tregut të vendit të klientit të huaj që kreditohet. Risku i vendit apo i Sovranit përmbledh një spektër të tërë të risqeve që ngrihen nga rrethana ekonomike, politike dhe sociale të një vendi të huaj që mund të jenë me pasoja për borxhet e huaja dhe investimet kapitale në atë vend. Në të gjitha rastet e transaksioneve ndërkombëtare, banka e ka të nevojshme të kuptojë tregjet globale financiare dhe efektet potenciale për t'u përhapur nga një vend në tjetrin apo efektet e kalimit në tërë rajonin.

Bankat që angazhohen në kredidhënie ndërkombëtare duhet të hartojnë politika dhe procedura kredie të përshtatshme për identifikimin, matjen, monitorimin, dhe kontrollin e riskut të vendit dhe transferimin e riskut në aktivitetet e tyre ndërkombëtare të kredidhënies dhe investimit. Monitorimi i faktorëve të riskut të vendit duhet të përfshijë risqet potenciale të dështimit të ripagimit që lindin si pasojë e problemeve në sektorët privatë të huaj apo nga faktorët specifik të ekonomisë së vendit.

Sipas Guerrieri L, (2012), i cili shprehet se: në se tregjet financiare ndërkombëtare janë shumë të integruara, goditjet e produktivitetit do të përhapen në gjithë portofolet financiare të investitorëve. Në kthim kjo do të gjenerojë një rezultat të fortë midis vendeve¹⁴

¹³ Mckinley, J.E. & Barrickman, J.R.: "Strategic Credit Risk Management", Robert Morris Association, Philadelphia, 1994.

¹⁴ Guerrieri Luca, Iacoviello Matteo, and Minetti Raoul "Banks, Sovereign Debt and the International Transmission of Business Cycles" (International Finance Discussion Papers) December 2012, pg. 5.

Një tjetër formë huadhënieje, përtej asaj tradicionale, janë edhe huatë sindikatë . Shumë banka marrin pjesë në hua sindikatë , në ose bashkime huaje duke patur kujdes në vlerësimin e riskut të marrëdhënies për çdo kredi ashtu edhe përfitueshmërisë nga kjo marrëdhënie. Gjithë pjesëmarrësit në sindikatë duhet të kryejnë analizat e tyre të riskut të pavaruara dhe rishikojnë termat e kredisë para se të angazhohen në sindikatë . Çdo bankë duhet të analizojë riskun e huasë sindikatë në të njëjtën mënyrë si kreditë e tjera.

Është kritike që menaxhimi i lartë i bankës të përcaktojë që stafi që përfshihet në çdo aktivitet ku ka një risk kredie huamarrësi apo palë e caktuar, të jetë plotësisht në gjëndje për të zhvilluar aktivitetin në standartet më të larta dhe në përputhje me politikat dhe procedurat e bankës. Për këtë janë të domosdoshme të përcakohen kriteret të cilat qartësojnë se Banka duhet të operojë nën një proces të mirëpërcaktuar e të shëndetshëm kriteresh. Këto kriteret duhet të përfshijnë një kuptim të plotë të huamarrësit si edhe qëllimit dhe strukturës së kredisë dhe burimeve të ripagimit të saj. Vendosja e kriterëve të shëndetshme të mirëpërcaktuara në kredidhënie është thelbësore për aprovimin e kredive në një mënyrë të shëndetshme dhe të sigurtë. Banka duhet të marrë informacion të mjaftueshëm për të patur një vlerësim koherent të profilit të vërtetë të riskut të huamarrësit, dhe informacioni bazë duhet të përfshijë: qëllimin e kredisë dhe burimet e ripagimit; informacion mbi integritetin dhe reputacionin e huamarrësit; profilin aktual të riskut (që përfshin natyrën dhe shumën agregate të riskut) të huamarrësit dhe ndjeshmërinë e tij ndaj zhvillimeve ekonomike dhe të tregut; Historikun e ripagimit të huamarrësit dhe kapacitetet aktuale paguese, bazuar në tendencen historike financiare dhe parashikimet e rrjedhjes së parasë (cash flow);

Informacioni dhe dokumenacioni i aplikantit për hua, është e rëndësishme të kalojë në një analizë të avancuar të kapaciteteve për të ripaguar bazuar në skenarë të ndryshëm; kapaciteti ligjor i huamarrësit për borxhin e supozuar; ekspertiza në biznes e huamarrësit dhe statusi i sektorit ekonomik të huamarrësit dhe pozicioni i tij në këtë sektor; termat e

propozuara dhe kushtet e kredisë, duke përfshirë dhe konvenantet e hartuar për të kufizuar ndryshimet në të ardhmen të profilit të riskut të huamarrësit, dhe kolaterali ose garancitë të përshtatshme dhe të përforcohet kur është e mundur me skenare të ndryshme.

Me vendosjen e kriterëve të kredidhënies është thelbësore që bankat të sigurojnë që informacioni i marrë të jetë i mjaftueshëm për të bërë një vendimarrje të përshtatshme të dhënies së kredisë. Ky informacion do të shërbejë si bazë për vlersimin e kredisë (credit rating) nën sistemin e vlerësimit (rating) të brendshëm të bankës.

Banka e ka të nevojshme të dije se kujt po i jep kredi dhe për këtë, përpara se të hyjë në një marrëdhënie kredie, banka duhet të familjarizohet me huamarrësin dhe të ketë besim se ata kanë të bëjnë me një individ apo organizatë me reputacion të lartë dhe me të shëndetshëm financiarisht.

E gjejmë këtë të cituar dhe nga de Greef dhe de Haas (2000):

Kur bankat japin hua ato përballen me informacionin asimetric, pasi shpesh kanë një qasje të kufizuar në parashikimet financiare dhe në integritetin e huamarresve potencial dhe për të ulur këtë asimetri të informacionit bankat duhet të monitorojnë klientin para se ti japin hua, duke synuar që duke bërë kështu ata të shmangin riskun me të keq¹⁵. (De Greef IJM, 2000:2)

Identifikimi i paleve të lidhura është mjaft i rëndësishëm, ndaj banka duhet të ketë procedurë që identifikojnë situata ku në kreditë e konsideruara, është e përshtatshme për të klasifikuar një grup detyrimesh si palë të lidhura duke i marrë si një detyrim të vetëm. Yupana Wiwattanakantang (2002), shprehet se identifikimi i palëve të lidhura ka rëndësi pasi këto ekspozime kreditore kanë më shumë gjasa që të kalojnë në hua me probleme dhe rekuperimi i tyre është më i ulët (Yupana Wiwattanakantang Raja Kali Chutatong Charumilind March 2002:3)¹⁶

Dhënia e kredisë përfshin marrje risku si edhe prodhimin e fitimit, ndaj duhet të vleresojë riskun dhe fitimin. Kreditë duhet të kenë çmime të tilla që të mbulojnë kostot dhe

¹⁵ de Greef, IJM and de Haas, R.T.A “Housing Prices, Bank Lending, and Monetary Policy” September 2000, pg 2.

¹⁶ Yupana Wiwattanakantang Raja Kali Chutatong Charumilind “Crony Lending- Thailand before the Financial Crisis” March 2002, Pg 3.

kompensojnë bankën për risqet që mund të rrjedhin. Në vlerësimin e termave në të cilën do të jepet kredia, banka duhet të vlerësojë risqet kundrejt të ardhurave, duke e faktorizuar atë në limitet më të mëdha të mundshme në çmim dhe në jo çmim (psh kolateral, konvenantet ndalues etj). Në vlerësimin e riskut banka duhet të shoh dhe skenaret më negative dhe impaktet e tyre mbi huamarrësin. Një problem i përbashkët i bankave është tendenca që ka për të mos vënë çmimin e kredisë mbi gjithë marrëdhënien me huamarrësin në mënyrë të përshtatshme dhe prandaj nuk marrin një kompensim të përshtatshëm për riskun që ndodh. Bankat duhet të vlerësojnë dhe vendosin provigjonet për humbje të pritshme dhe mbajnë një kapital të mjaftueshëm për të mbuluar risqet dhe humbjet e papritura. Bankat mund të përdorin kolateralin ose garancitë për të mitiguar riskun në kreditë individuale, por paraprakisht transkasionet duhet të mbulohen fuqimisht nga kapacitetet paguese të huamarrësit. Kolaterali nuk mund të zëvendësojë vlerësimin e huamarrësit dhe as të kompensojë informacionin e pamjaftueshëm. Bankat duhet të kenë politika të pranueshme mbulimi të formave të ndryshme të kolateralit dhe procedura për vlerësimin në vijimësi të kolateralit dhe një proces që siguron se kolaterali është dhe vazhdon të jetë i realizueshëm. Banka duhet të vlerësojë nivelin e mbulimit në lidhje me cilësinë e kredisë dhe kapacitetin ligjor të garantorit. Përveç sa me sipër, banka duhet të kujdeset e mirembajë një proces monitorimi të përshtatshëm të administrimit të kredisë.

2.5 Kredidhënia, institucionet kredidhënëse dhe rëndësia e menaxhimit të riskut në këtë proces

Kredidhënien si një nga produktet më tradicionale që mbart risk për Ndërmjetësit/Institucionet financiare, do ta përkufizonim kështu: Kredidhënia është procesi i ndërmjetësimit financiar midis ofruesve dhe përdoruesve të kapitalit financiar.

Gama e shërbimeve financiare në ekonominë e zhvilluar është mjaft e gjerë dhe në proces ndryshimi e përshtatje me kërkesën në treg (evolon në mënyrë dinamike). Këto shërbime financiare kryhen nga ndërmjetësit financiarë, të cilët në gjuhën e përditshme quhen Institucione financiare.

Huaja është një sasi parash që huadhënësi i jep humarrësit dhe që ky i fundit duhet t'ja rikthejë huadhënësit në një periudhë kohe të caktuar së bashku me interesin. Interesi është kostoja e kësaj huaje. Kohëzgjatja që vendoset për të paguar huanë njihet si afati i huasë. Ndërsa kostoja e huasë është një ponderim i tre faktorëve, të cilët janë: madhësia e huasë, kohëzgjatja e saj dhe norma e interesit për njësi kohe dhe njësi paraje.

Shërbimet e transformimit cilësor të aseteve kryhen nga Institucione financiare. Pra me fjalë të tjera Ndërmjetësit apo Institucionet financiare marrin hua me njërën dorë dhe japin hua me dorën tjetër. Dhe pyetja e ngritur shpesh mbi faktin pse ofruesit e parave nuk shesin vetë paratë e tyre po përdorin bankat si ndërmjetës, kjo është një çështje e cila ka gjetur këtë mënyrë operimi dhe konkretisht pasi është shumë e vështirë që palët e interesuara për të shitur dhe ato për të blerë të njihen me njëra tjetrën. Informacioni, në të shumtën e rasteve, ose mungon ose është i pabesueshëm dhe/ose i pasaktë. Në këto kushte depozituesit e parave besojnë kapitalet e tyre financiare një institucioni të njohur dhe që kanë besim, në këtë rast bankat, apo institucionet financiare. Kështu kërkuesit e kapitaleve financiare apo humarrësit drejtohen të institucionet apo ndërmjetësit financiarë për të marrë para.

Greenbaurn & Thakor (2007) përkufizojnë termin e industrisë financiare në:

Industria e shërbimeve financiare është një përfshirje e Institucioneve shume të ndryshme siç janë bankat tregtare, Institucionet e kursimit, unionet e kreditit, gjithë ato të cilat financojnë asetet e tyre me depozita, agjensitë qeveritare, fondet e pensionit, pension funds, loan sharks, brokerat, llotaritë, kompanitë e sigurimit, fondet e përbashkëta, këmbime të organizuara për aksione të tregtueshme, privatë-equity pools. Në këtë listë mund të shtohen edhe kombinime të organizuara për aksione të tregtueshme, futures, options, bonds dhe commodities, pari-mutuel betting institutions, credit rating agencies, etj.¹⁷

¹⁷ Greenbaum Stuart I. & Thakor Anjan V. "Contemporary Financial Intermediation, second edition"; Introduction chapter 2, pg 42, April 2007.

Ndërsa kemi një sistem financiar huadhënës, normalisht kemi në anën tjetër ata që quhen huamarrësit, të cilët mund të jenë subjekte privatë dhe më konkretisht individë të ndryshëm dhe biznese, si dhe subjekte publike/shtetërore si njësi lokale apo qendrore, apo kompani publike të ndryshme¹⁸. (Greenbaum Stuart I. & Thakor Anjan V. 2007:42)

Kështu huadhënësit, ose ndryshe ofruesit e huave, janë Bankat ose ndërmjetësit e parave, që marrin përsipër dhe furnizojnë tregjet financiare me para, para të cilat i mbledhin nga depozituesit e parave dhe jua ofrojnë më pas kërkuarve të huave.

Dallimin mes ndërmjetësve financiarë dhe bizneseve të tjera Greenbaum & Thakor (2007) do t'a përkufizonte si të tillë:

“Ndërmjetësit financiarë janë entitete që ndërmjetësojnë midis ofruesve dhe përdoruesve të kapitalit financiar. Ndërmjetësit financiarë, në kontrast me firmat jofinanciare, mbajnë sasi relativisht të mëdha të të drejtave financiare si asete. Kompanitë e prodhimit mbajnë inventarë, makineri, dhe patenta si aktive, Ndërmjetësit financiarë mbajnë kontrata të vlerësuar të klientëve të tyre si aktive”¹⁹

Huatë bankare janë mjaft të rëndësishme për bizneset pasi ato rritin vlerën e kompanisë në një kohë më të shkurtër se sa do të ishte në mungesë të këtyre huave. Billett, Matthew T (2003) shprehet se kombinimi i terok i huadhënies private, përfitimet dhe faktet empirike që huatë bankare sjellin efekte pozitive, ka çuar në etiketimin e huave private si “të veçanta” ose “Unikë” midis alternativave të financimit të biznesit²⁰

¹⁸Kërkuarve të huave/parave, janë individë apo subjekte privatë ose publik, të cilët marrin hua nga ndërmjetësit e parave/ bankat, për të realizuar planet e tyre.

¹⁹ Greenbaum Stuart I. & Thakor Anjan V. “Contemporary Financial Intermediation, second edition”; Introduction chapter 2, pg 43;2007.

²⁰ Billett Matthew T. & Garfinkel Jon A. from Henry B. Tippie College of Business, University of Iowa, Mark J. Flannery from Warrington College of Business, University of Florida “Are bank loan special? Evidence on the post Announcement Performers of bank borrowers”2003

Gjithë këto Institucione financiare kanë të përbashkët vlerësimin e rrezikut dhe të harmonizimit të tij në mënyrë të zgjuar. Ndërmjetësit financiarë, ose ndryshe bankat tregtare, dhe fondet e ndryshme të kreditimit prodhojnë informacion për dy qëllime të rëndësishme dhe që janë:

- e para për të bërë lidhjen midis dy palëve, huakërkuesit dhe huadhënësit,
- e dyta të menaxhojë rrezikun dhe transformojë natyrën e stresit që lidhet me moskthimin e huasë nga humarrësi.

Roli i Riskut ka marrë një rëndësi të madhe në menaxhimin e portofolit të huave në institucionet financiare hüdhenëse në kohë, për më tepër me shpërthimin e krizës financiare Globale pas vitit 2008.

Midis shumë përgjigjeve të pyetjes pse bankat ekspozojnë vetëveten në të tilla rreziqe, një përgjigje mjaft e famshme është ajo e dhënë nga ELLUL & Yerramilli:

“Dështimi i menaxhimit të Riskut në banka vjen pasojë: ose ekzekutivët e bankës dhe tregtarët me skema të fuqishme kompensimi, të njohura si marrës të riskut të tepruar dhe që nuk mund të shtrëngohen nga menaxherët e riskut, ose menaxherët e bankave nuk kanë qënë në dijeni të ekspozimit të tyre në risk sepse ata vlerësonin riskun historikisht dhe kishin neglizhuar çfarë mund të dukej si propabilitet i ulët për të ndodhur.”²¹ (ELLUL & Yerramilli, 2010:1)

Një vëmendje të veçantë, përveç sa më sipër, ka fakti se Risku dhe roli i tij në menaxhimin e portofolit të bankës duhet të jetë parësor dhe konsistent pavarësisht fazave të ndryshme të cikleve ekonomike. Rendom vihet re se pothuaj gjithë bankat, gjatë periudhës së reçensionit ekonomik i japin riskut një rol prioritar në vendimarrjen e huave, ndryshe nga periudha e bume-ve ekonomike ku prioritet marrin njësitet e tjera të bankës.

Në Paper-in e BIS, argumentohet kombinimi i qasjeve të vlersuesve të riskut në raport me ciklet ekonomike, në të cilin citohet se:

²¹ Ellul Andrew & Yerramilli Vijay “Stronger Risk Controls, Lower Risk: Evidence from U.S. Bank Holding Companies” Journal of Finance, Forthcoming; pg 1, SSRN WEB

“Vlerësimi i keq i riskut rritet pjesërisht nga vizioni i ngushtë që kanë shumica e metodologjive të vlerësimeve të Risku dhe pjesërisht nga vëmëndja e pamjaftueshme që ju kushtohet lidhjeve midis huamarrësve dhe institucioneve. Të kombinuara këto dy deficienca nënkuptojnë që ndryshimet në risk të shoqëruara me cikle ekonomike synojnë të jenë të keqvlërësuar. Në mënyrë të veçantë, risku shpesh nënvlerësohet në momentet e bumit ekonomik dhe mbivlerësohet në kohën e recesioneve. Vizioni i gjërë dhe një vlerësim më i madh i marrëdhënies duhet të kontribuojë në një vlerësim më të mirë të riskut, në të dy nivelet si atë të institucioneve individuale dhe për sistemin si një i tërë.”²² (BIS no1:2011:49)

2.6 Funksionet e Riskut të Kredisë dhe rëndësia e zbatimit të tyre në çdo institucion financiar

Bankat duhet të kenë një sistem për menaxhimin e rrezikut të kredisë të përshtatshëm për natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e aktiviteteve të tyre. Sistemi i menaxhimit të rrezikut të kredisë në banka duhet të përfshijë politikën, procedurat rregullat dhe strukturën në të cilat përdoren nga banka për të menaxhuar rrezikun kreditor. Sistemi i menaxhimit të rrezikut të kredisë duhet që në mënyrë të vazhdueshme dhe me kohe të beje vlerësimin e cilesisë së kredive dhe mjeteve të tjera duke përfshirë edhe përcaktimin e përshtatshmerisë së rezervave për humbjet që lidhen me këtë rrezik.

Proçesi i menaxhimit të riskut duhet të bazohet në modele dhe sisteme vlerësimi të mirepërcaktuar në mënyrë sa më shkencore, që garantojnë një vlerësim të saktë të situatës së një aplikimi individual apo për gjithë portofolin e kredisë së bankës.

Bazuar në standardet e kreditimit sipas BIS, funksionet e Riskut të Kredisë, të zbatueshme në çdo institucion financiar, janë:

²² BIS Papers no1, Marrying the macro and microprudential dimensions of financial stability, March 2011, Monetary and Economic Department, fq 49

- Identifikimin e riskut aktual ose të ardhshëm të kredisë ndaj të cilit Institucioni huadhënë s'është i ekspozuar dhe zhvillimin e aplikimin e politikave efikente të kredisë në mënyrë që të menaxhojë e kontrollojë riskun.
- Zhvillimin dhe aplikimin e një teknologjie efikase kreditimi duke patur në konsideratë dokumentimin dhe procesin e analizës financiare të humarrësit.
- Zhvillimin dhe aplikimin e procedurave rezultative për kontrollin dhe monitorimin e portofolit të kredisë.

Modelet dhe sistemet e vleresimit të Riskut të Kredisë

Identifikimi i rrezikut aktual e të ardhshëm prezent në produktet e kredisë dhe aktivitetin e kreditimit në bankë është baza e një drejtimi efikas të riskut të kredisë. Zhvillimi dhe aplikimi i politikave të qarta e të shkruara ku përcaktohet filozofia e riskut të kredisë të bankës, si dhe parametrat nëpërmjet të cilëve do të kontrollohet risku i kredisë.

Bankat kanë të nevojshme të marrin risk shprehet, Van Gestel (2009) për të mbajtur marzhet e tyre të fitimit dhe realizuar rolin e tyre në ekonomi. Menaxhimi i riskut është një term i gjërë për të kontrolluar riskun deri në një farë limiti të mundshëm. Basel II Capital accord identifikon tre burimet kryesore të riskut dhe që janë risku i kredisë, risku i tregut dhe risku operacional. Bankat përballen me elementë të ndryshëm të riskut që duhen identifikuar, matur dhe menaxhuar.²³ (Van Gestel 2009:23)

Në mënyrë që të kryejë një drejtim sa më efektiv të portofolit të huave, Risku i kredisë duhet të bëjë grupimin e kredive sipas disa karakteristikave si përshembull: sipas përkatësisë së adresimit, individë apo biznes, llojit të produktit sipas afateve, qëllimit të kredisë në investime apo mjete xhiroje, sipas monedhave, sipas degëve të industrisë, etj.

Çdo institucion duhet të ketë një sistem vlerësimi të kredisë që të përcaktojë kriteret risk – vlerësim dhe raportet e kredisë sipas këtyre kriterëve.

²³ Van Gestel Tony & Bart Baesens “Credit Risk Management “ chapter “source of risk” pg 23. botim I Oxford; 2009.

Modelet e vlerësimit të kredive gjenerohen nga bashkëpunimet midis departamenteve të kredisë së bankave dhe departamentet e risqeve të institucioneve financiare bazuar në agjensi të jashtëme dhe disa modele të brëndshme që përdrojnë kombinimin e analizës së pasqyrave financiare dhe gjykimit sipas pikëzimit. Arritja e një sistemi vlerësimi me cilësi të lartë kërkon që të përdoret informacioni i duhur rreth klientëve dhe përdorimi në formatin e duhur të të dhënave në përfshirjen brënda modelit që transformon informacionin në vlerësim ose klasifikim të riskut. Modelet përfitohen duke përdorur programe kompjuterike dhe metoda të ndryshme statistikore. Për të patur një sistem vlerësimi sa më efektiv duhet të bëhet e mundur të përfshihen në model shumë dimensione si:

- demografinë e klientit
- pasqyrat dhe raportet financiare
- raporti i byrosë së kredisë dhe historiku i klientit në sistemin bankar (Regjistri i Kredive, i cili në vendin tonë menaxhohet nga Banka e Shqipërisë)
- informacioni mbi segmentet e caktuara të industrisë
- pikëzimi sipas gjykimit të menaxherit të marrëdhënieve me klientin dhe analistit të kredisë, zakonisht në mënyrë respektive, menaxheri vlerëson anën cilësore të klientit ndërsa analisti vlerëson anën sasiore bazuar në pasqyrat financiare.
- Normalisht sa më shumë parametra të përfshihen në model aq më i saktë është modeli. Megjithatë së paku duke filluar të procedohet me grumbullimin e të dhënave hyrëse institucioni mundëson që do të ketë sasinë e duhur të të dhënave historike për të ndërtuar lidhjen risk–kthim.
- Minimalisht një sistem vlerësimi duhet të lejojë klasifikimin e kredive si: me risk të pranueshëm ose i kënaqshëm, risk poshtë standarteve (apo nënstandard), risk i pakënaqshëm ose i dyshimtë – këtu hyjnë gjithë kreditë për të cilat është aplikuar provigjoni pjesor apo edhe total ose kredi të pambuluara mjaftueshëm me kolateral.

Kriteret e vlersimit individual

Njësia e Riskut të kredisë në bankë, duhet të hartojë dhe zbatojë politika e procedura mjaft të qarta në gjithë fazat e kreditimit dhe gjithë aktivitetin e saj kreditues, duke marrë për bazë gjithë faktorët paralel, pa mbivlerësuar apo nënvlerësuar asnjërin prej tyre.

Kështu 5 faktorët e kredisë; Kapaciteti pagues, Kapitali, Kolaterali, Kushtet, Karakteri, që analizojnë dhe vlerësojnë riskun individual të çdo aplikimi për kredi duhet të shtrihen në të gjithë këta faktorë në mënyrë të njëjtë pa mbivlersuar ose nënvlerësuar asnjërin prej tyre, por edhe më shumë se kaq. Shpesh metodologjitë e përdorura në vlerësimet individuale nuk paraqesin situatën dhe vlerësimin real të klientit për shkak se nuk përfshihen gjithë faktorët e duhur. Në modelet e vlerësimit individual të riskut shpesh vlera e kolateralit ndikon në një vlerësim jo të saktë të tërësisë së aplikantit për hua. Gjithashtu njësia që merret me menaxhimin e riskut përdor modele vlerësimi për riskun individual bazuar në praktika të cilat jo gjithmonë arrijnë të japin një vlerësim të saktë të riskut individual. Kjo ndodh sidomos kur bëhet fjalë për aplikime kredie nga biznesi.

Funksioni i Riskut në identifikimin e riskut aktual ose të ardhshëm të kredisë

Matja e rrezikut në çdo aktivitet kredie, lejon të përcaktohet ekspozimi i kredisë ndaj klientëve që banka merr përsipër, duke konsideruar raportin risk-fitim. Për të minimizuar ekspozimin ndaj humbjes nëpërmjet dështimit çdo bankë duhet t'i kushtojë një rëndësi të veçantë vlerësimit të çdo kredie dhe rreziqeve që shoqërohen me çdo lloj produkti kredie përpara aprovimit apo disbursimit të fondeve dhe të siguroje se kreditë janë të mirëdokumentuara.

Vlerësimi i çdo kërkesë për kredi duke u siguruar që analizohen 5 faktorët e domosdoshëm për çdo klient, që shpesh referohen si 5 K-të e kredisë: Kapaciteti pagues, Kapitali, Kolaterali, Kushtet ekonomike, dhe Karakteri. Në të njëjtën kohë merret për bazë gjithë situata e plotë e klientit duke vlerësuar saktë çështjet që lidhen me: Destinacionin e kredisë dhe burimet e ripagimit të saj, karakteri, besueshmeria, reputacioni dhe gatishmëria për të

paguar në mënyrë korrekte në kohë detyrimet kontraktore, kapaciteti i humarrësit për të paguar bazuar në ecurinë historike financiare dhe parashikimet e flukseve të parasë, mjaftueshmëria e kolateralit, etj.

Për kreditë tregtare apo të biznesit duhet të konsiderohen gjithashtu dhe aspektet e tjera të huamarrësit, kapacitetet menaxhuese, industria në të cilën operon (informacion tregu i dokumentuar në burimet zyrtare ose informale të informacionit) si dhe pozicioni i tij në industri. Mbivlerësimi i këtyre faktorëve mund të çojë bankën në rreziqe të tepërta rezultuar nga: një shtendosje në cilësinë e standardeve të kreditimit, duke përfshirë supozimet e riskut të humarrësit, mbi financimin ose aprovim kredie me terma lehtësuese për klientin në terma të shumës, afateve, interesave dhe garancive. Një rivlerësim i kriterëve për targetin në treg ose hyrja në tregje ose produkte të patestuara.

Kështu 5 faktorët që analizojnë dhe vlerësojnë riskun individual të çdo aplikimi për kredi duhet të shtrihet në të gjithë këta faktorë në mënyrë të njëjtë pa mbivlersuar ose nënvlerësuar asnjërin prej tyre, por edhe më shumë se kaq. Shpesh metodologjitë e përdorura në vlerësimet individuale nuk paqeqesin situatën dhe vlerësimin real të klientit për shkak se nuk përfshihen gjithë faktorët e duhur. Në modelet e vlerësimit individual të riskut shpesh vlera e kolateralit ndikon në një vlerësim jo të saktë të tërësisë së aplikantit për hua.

Në Paper-in e BIS (2011), argumentohet mundësia e ndodhjes së cikleve të kredisë si kombinim i keqvlersimeve potenciale të zerave të bilancit me politikat dhe strategjitë e bankës huadhënëse për vlerësimin e kolateralit:

“Ndërsa kapitali dhe provigjonët janë rrugët kyç, nëpërmjet të cilëve këqvlërësimet potenciale mund të dobësojnë bilancit e bankës dhe rrisin ciklin financiar, nuk janë të vetmet. Dy të tjera që mund të luajnë rol të njëjtë mund të jenë politikat e adresimit të problemit, është veprimi i strategjisë së bankës huadhënëse me praktikën e vlerësimit të kolateralit dhe kufizimet rregullatore dhe procesi i auditimit të mbiqyrjes. Nëse banka huadhënëse është e varur shumë nga vlera e kolateralit dhe nëse risku që shoqërohet me vlerën e kolateralit janë të

këqvlërësuar, mundësia për cikle të mëdha kredie rritet. Ngjashëm, mundësia për cikël të kredisë që rritet është më e madhe në se intesiteti i kontroleve nga mbikqyresit gjithashtu ndryshon me fazat e ciklit²⁴ (BIS paper nr 1, 2011:35)

Gjithashtu risku përdor modele vlerësimi për riskun individual bazuar në praktika të cilat jo gjithmonë arrijnë të japin një vlerësim të saktë të riskut individual. Elementet subjektive në vlerësim ndikojnë, gjithashtu, në vlerësimin e qëndrimin përfundimtar të një kërkesë, ndaj është e rëndësishme që të evitohet kontakti me klientin nga vlerësuesit e riskut, duke ndare e mirepërcaktuar përgjegjësitë përkatëse.

Administrimi i kredisë dhe Proçesi i Matjes dhe Monitorimit

Një tjetër rol tepër i rëndësishëm i riskut në menaxhimin e portofolit të kredisë është ai i zhvillimit dhe aplikimit të një teknologjie efikase kreditimi duke patur në konsideratë dokumentimin dhe proçesin e analizës financiare të humarrësit. Drejtimi i riskut është i lidhur me çdo transaksion kredidhënie apo ekspozimi të bankës individual dhe përfshin proçesin që nga momenti i aplikimit për kredi nga një klient deri në proçesin e vendimarrjes. Ky proçes vazhdon më tej, nëse vendimi është aprovim i kredisë, duke kryer disbursimin e kredisë dhe monitoruar huamarrësin deri në kthimin e plotë të kredisë.

Administrimi i kredisë është një element kritik në ruajtjen e sigurisë dhe shëndetit të bankes. Kjo realizohet në përmjet mbajtjes së dosjeve të kredisë me informacion të përditësuar, me informacione financiare korente si dhe njoftimet e rinovimit, apo dokumenta të ndryshme si ato të marreveshjeve të huasë. Rishikimi i dosjeve e kredive është një proçes që duhet të garantojë që dosjet janë të plota dhe që gjithë dokumentat e aprovimit dhe dokumentat e tjera të domosdoshëm janë të administruara.

Në këtë kontekst **Dokumentimi i kredisë** është një element i rëndësishëm në mirëadministrimin e portofolit të kredisë. Për të eliminuar gjithë risqet potenciale të

²⁴BIS Papers no1, Marrying the macro and microprudential dimensions of financial stability, Monetary and Economic Department, March 2011, fq 35

moskthimit të huasë dhe mos ekspozimin e bankës ndaj dështimit të mbledhjes së huasë së dhënë çdo dosje duhet të përmbajë një listë bazë të dokumentave, të cilat rast pas rasti shtohen në varësi të natyrës së biznesit dhe stadi të zhvillimit të tij. Çdo dosje kredie duhet të përmbajë minimalisht këtë informacion:

- Njohjen shumë të mirë të klientit, natyrën e biznesit, mënyrën e menaxhimit, identifikimin e dorëzanësve financiarë dhe personat e lidhur me të në se është rasti;
- Të sigurojë fakte që sigurojnë aftësinë paguese të klientit, situatën financiare aftësinë për të ripaguar detyrimet në kohë.
- Të mirëpërcaktojë termat e kreditimit duke përfshirë destinacionin e kredisë
- Vlerësimin e kolateralit me vlerë të drejtë dhe sigurimi i saktësisë së dokumentave të pronësisë
- Të sigurojë një historik të shlyerjeve të kredive për çdo klient si dhe marëdhënien e klientit me bankën dhe në shërbime e produkte të tjera të bankës, transkacione të ndryshme që kryen me bankën volumin e tyre në raport me totalin e volumit të transkacioneve që kryen klienti bazuar në pasqyrat financiare dhe
- Qartësimi i marëdhënieve të pronarëve dhe bizneseve të lidhura me kompaninë që kreditohet dhe drejtimit të bizneseve

Greenbaum & Thakor (2007) shprehen se:

aftësitë bazë të bankierit në kredi shtrihen në mbledhjen dhe përpunimin e informacionit më të vlefshëm dhe relevant, me një kosto sa më të ulët, pa thyer kërkesat legale ose normat shoqërore. Kjo do të thotë identifikimin e burimit të informacionit dhe përdorimin e burimeve standarde në mënyrë sa më të zgjuar. Përdorimi i zgjuar i informacionit të kredisë është një art që kultivohet dhe që diferencon huadhënësit e suksesshëm nga pjesa tjetër e tregut. Burimet standarde të kredisë mund të klasifikohen të brëndshme dhe të jashtme. Të brëndshme nënkuptojmë ato brënda bankës dhe burime të jashtme nënkuptojmë gjithë të tjerat.²⁵ (Greenbaum 2007:206)

Për një proces efektiv të administritimit të kredive, dosjet e kredive duhet të siguroje se ka:

²⁵ Greenbaum Stuart & Thakor Anjan V. “Contemporary Financial Intermediation, second edition, Part III Major “On Balance Sheet” Risks in Banking, Chapter 5. pg 206; 2007

- Efëçence dhe efektivitet të operacioneve të adminstrimit të kredive duke përfshire dokumentat e monitorimit, kerkesat kontraktuale, kolateralin, etj
- Koherencen dhe vijushmerinë në kohe të informacioneve të dhëna për sistemin e menaxhimit të informacionit (SIM).
- Aktualitetin e kontrolleve mbi gjithë proçedurat e backoffice
- Përputhshmerinë me politikat e menaxhimit dhe proçedurat si dhe rregulloreve dhe ligjeve në fuqi.

Monitorimi i Portofolit të huave

Banka ka të nevojshme të zhvillojë e zbatojë proçedura të plota dhe sisteme informacioni për të monitoruar kushtet e kredive individuale. Keto proçedura duhet të përcaktojnë kritere për të identifikuar problemet e potenciale të kredive për të siguruar një monitorim të shpeshtë në menyre që të merren veprime korrektuese, apo të klasifikojnë apo provigjojnë. Një sistem moniorimi efektiv në nkupton të gjithë masat që duhen marre për të siguruar që banka njeh dhe kupton situatën aktuale financiare të klientëve, që gjithë kreditë e dhëna janë brenda temrave të konvenances, të ndjeke përdorimin e kredisë nga huamarrsi, të sigurojë që cash flow i parashikuar i klientit mbulon kerkesat për mbulimin e borxhit, të sigurojë që kolaterali i dhënë mbulon mire ekspozimet aktuale të klientit, identifikon dhe klasifikon problemet potenciale të kredive në baza sa me të shpeshta, si dhe të sigurojë që informacionet që kanë vlere domethënë se për cilesinë e kredisë përcillen pranë personave përgjegjes për vlersimin e kredive.

Banka e ka të rëndësishme që të ketë në funksion sistemin për monitorimin e plotësimit të kushteve të kredive individuale, duke përfshire përcaktimin e provigjoneve dhe rezervave.

Banka, sipas Baselit (2000) duhet të zhvillojë dhe zbatojë sisteme të brendshme vlersimi në kontrollin dhe monitorimin e portofolit të kredisë. Sistemet e vlerësimit të brendshëm duhet të jenë të mirë strukturuara në atë mënyrë që të mundësojnë diferencimin e shkallëve të rrezikut të kredisë në ekspozime kreditore të ndryshme të bankës. Diferencimi më i mirë i

shkallëve të riskut të kredive përcakton gradën e riskut të çdo kredie dhe mbështet bankën në krijimin e provigjoneve më të sakta në bilancet e tyre.

Sistemet më të thjeshta të vlerësimit të kredive bazohen në kategori të ndryshme që fillojnë nga i kënaqshëm deri në i pakënaqshëm, ndërsa sistemet më moderne të vlerësimit do të kenë grada të shumta për kreditë që konsiderohen të kënaqshme me qëllim që të diferencojnë nivelet e riskut që ato paraqesin.

Bankat më të mëdha përdorin sisteme vlersimi më të sofistikuar dhe shumë të detajuara, por edhe bankat e vogla mund të mbështeten në këto sisteme për të përcaktuar alokimin e kapitaleve, çmimin e kredisë, përfitueshmerinë e transaksioneve dhe marrëdhënies në tëresi me një klient të caktuar, etj.

Kreditë me shkallë vleresimi në rënie duhet të jenë subjekt i monitorimit të shpeshtë nga specialistët e kredisë dhe përfshirjen e menaxhimit të lartë në listën e përditësuar të kredive në përkeqesim.

Efektiviteti i monitorimit, sipas Komitetit të Baselit (2002) mund të jetë më i ulët në sektorët konkurrues dhe të rinj. Kështu diversifikimi mund të rezultojë në një cilësi të varfër të huave, që do të thotë një rritje në riskun e portofolit të huave të bankës. Ka tre arsye pse kjo mund të ndodhë: së pari bankat mund të kenë mungesë ekspertize në huadhënie në sektorët e rinj, kur ka kosto për t'i mësuar këta sektorë. Së dyti kur sektori i huasë për të cilin bankat migrojnë mund të jetë i ngopur nga bankat e tjera dhe hyrja e bankave të reja mund të jetë subjekt e një zgjedhje me efekt të kundërt në "kursin e fitimit". Kjo sugjeron që diversifikimi mund të zvogëlojë fitimin nga huatë e vetë bankës dhe rrisë riskun e dështimit në një shkallë më të madhe kur sektorët në të cilët banka zgjerohet janë subjekt i një konkurrence më të lartë. Së treti, diversifikimi mund të shkaktojë rritjen në madhësi të një banke duke u bërë subjekt i një baze të inefiçencës²⁶

Vlerësimi i brendshëm i kredive, risk –rating, mund të përdoret nga menaxherët e departamentëve të ndryshme për të tërhequr karakteristika të portofolit të kredive dhe

²⁶ Basel Committee on Banking Supervision "Should Banks be diversified? Evidence from individual bank loan portfolio, Paper no 118, Sept 2002, pg 4

ndihmojë në përcaktimin e ndryshimeve në strategjinë e bankës. Për këtë është e rëndësishme që Bordi Drejtoreve dhe menxhimi i lartë i bankës të marrë raporte periodike mbi kushtet e portofolit të kredive bazuar në të tilla vlerësime / ratings.

Një rol mjaft i rëndësishëm i riskut të kredisë është edhe ai i Limitimit/kufizimit të përqëndrimit të portofolit , duke ruajtur një nivel diversifikimi sa më të gjërë të tij.

Përqëndrimi shfaqet kur një portofol kredie në një bankë përmban një vlerë të lartë kredie ndaj: një palë të vetme, një grup të përbërë nga palë të lidhura, një industrie, një lloj produkti kredie, një grupi instrumentash. Përqëndrimi ekstrem vë bankën në pozicione të vështira në rastin e ndryshimeve të mëdha me pasoja negative në zonën në të cilën kreditë janë të përqëndruara. Drejtimi efektiv i portofolit dhe kontrolli çojnë në minimizimin e përqëndrimit të rrezikut dhe në diversifikimin e portofolit të huasë, gjë e cila arrihet duke zhvilluar dhe vënë në zbatim procedurat dhe praktikatat e duhura. Minimalisht një politikë kredie që mundëson diversifikimin duhet të jetë e shprehur qartë, të përfshijë objektiva për një portofol të miksuar dhe të përcaktojë limite për përqëndrimet e :

- një zone të vetme gjeografike
- në një klient të vetëm, ose palë të lidhur,
- industri kyçe ose sektorë ekonomie dhe produkte të reja.
- Palët e lidhura mund të jenë një grup personash apo kompanish të lidhur financiarisht ose kanë një pronësi të përbashkët, menaxhim, kërkim, - zhvillim marketingu apo çdo kombinim midis tyre të lidhur me njëri tjetrin.

Identifikimi i palëve të lidhura kërkon një analizë të ndikimit të këtyre faktorëve në situatën financiare të palëve të lidhura. Për të siguruar që banka nuk është i ekspozuar ndaj një pale të vetme, limitet e kredisë duhet të aprovohen duke marrë në konsideratë ekspozimet aktuale të gjithë palëve në grup. Palët e lidhura ose të pavarura duhet të rishikohen e monitorohen në se kanë ndryshime që sjellin ndarje apo bashkime me individ, apo kompani të tjera.

Ciuriak (2010) argumenton se:

roli i informacionit dhe menaxhimi i rrezikut për të mbajtur zhvillimin e rrezikut të zgjeruar brënda sistemit financiar duke parandaluar krijimin e situatave të “supereksponuara” është mjaft i rëndësishëm. Psikologjia e zgjerimit është e tillë që kredia është e vlefshme në një çmim, në se jo nga bankat dhe ekonomitë e industrializuara, atëherë nga fondet e kapitalit në treg ose të tjerët. Duke mbajtur rolin e tregjeve të rregulluara në mbulimin e rrezikut, rregulloret shtyjnë lëvizjen e veprimeve në tregjet e parregulluara. Kjo ndryshon kanalet nëpërmjet të cilave korrupsioni rrjedh por nuk eliminon atë.²⁷ (Ciuriak, D 2010:7)

2.7 Ndikimi i faktorëve makroekonomik në nivelin e huave me probleme sipas literaturës botërore

Literatura botërore shpesh nëpërmjet analizave empirike dhe shkencore ka arritur të identifikojë një spektër të gjërë shkaqesh që ndikojnë në nivelin e huave me probleme, natyra e të cilave është e lidhur jo vetëm me faktorë makroekonomik por edhe me faktorë që lidhen me vetë bankat, strukturën menaxheriale të tyre, shkaqet e konkurrencës mes tyre, shkaqe që lidhen me proceset rregullative dhe të mbikqyrjes etj. Në këtë çështje po risjellim disa prej këtyre gjetjeve nga autorë të ndryshëm me emër në fushën e studimeve të riskut të kredisë.

Shkaqet kryesore që ndikojnë në nivelin e huave me probleme sipas literaturës ndërkombëtare, faktorët që ndikojnë më tepër e që përcaktojnë nivelin e huave me probleme në sistemin bankar, janë ato të natyrës makroekonomike dhe bankare.

Louzis, Vouldis dhe Metaxas (2010), shprehen se;

Faza e zgjerimit të një ekonomie karakterizohet nga një numër relativisht i ulët i huave me probleme, pasi të dy palët, si konsumatorët dhe shoqëritë përballen me një fluks të mjaftueshëm të ardhurash dhe shitjesh, të cilat i shërbejnë shlyerjes së

²⁷ Ciuriak, D.: Implementing Better Banking Regulation And Standards -lessons from the past”, March 2001, (revised Feb 2010), pg 7.

*detyrimeve të tyre. Sidoqoftë me vazhdimin e periudhës së rritjes ekonomike, huadhënia zgjerohet drejt huamarrësve me cilësi të dobët dhe në mënyrë të vazhdueshme, kur fillon faza e rënies ekonomike, fillojnë dhe rriten huatë me probleme*²⁸. (Louzis, D.P., 2010:10)

Louzis, Vouldis dhe Metaxas (2010:23), gjithashtu theksojnë se rritja reale e PBB-së ka efektet më të forta në terma afatgjatë në shkallën e huave me probleme nga ana e biznesit, ashtu sikundër dhe papunësia.

Zhvillimi makroekonomik i një vendi, e matur nëpërmjet treguesve të tillë si PBB, niveli i punësimit etj ndikohen në vetvete shumë nga shkalla e Rrezikut të vendit dhe niveli i informalitetit të ekonomisë, të cilët të kombinuar me njëri tjetrin këto tregues japin një efekt të rëndësishëm në nivelin e huave me probleme.

Rreziku Sovran gjithashtu është një faktor që ka peshë në ndikimin e nivelit të huave me probleme të studiuar e analizuar nga literatura botërore, në të cilën spjegohet se Rreziku i Sovran mund të ndodhë gjatë periudhave të destabilitetit ekonomik ose politik, ose në rastet e vetëbesimit që vjen nga keqpërdorimi i pavarësisë së tij.

Në periudhat e krizës dhe destabilitetit ekonomik rritja e borxhit të sovranit nuk çon në një situatë ku borxhi investohet në projekte që sjellin efektivitet pozitiv të përdorimit të tyre, se sa në përkeqsim të gjithë treguesve, pasi gjatë kësaj periudhe borxhet investohen për të mbuluar shpenzime që nuk sjellin efektivitet ekonomik në vënd.

Aunion Nerin (2002), argumenton se vlerësimi e matja e rrezikut të kredisë, janë masat më të observuara gjërësisht të cilësisë së huasë të një borxhi specifik të lëshuar nga ndonjë entitet në përgjithësi dhe mbetet një nga informacionet më të përdorura për të matur shkallën e moskthimit të borxhit si proces.²⁹

²⁸ Louzis, D.P., Vouldis, A.T., Metaxas, V.L.: “Macroeconomic and bank-specific determinants of non-performing loans in Greece: a comparative study of mortgage, business and consumer loan portfolios”, Working Paper no.118, Bank of Greece, September 2010, p.10.

²⁹ AUNON NERIN, Daniel; Diddier Cossin, Hricko Tomas, Zhijiang huang “Exploring for the determinants of credit risk, in credit default swap transaction data: is fixed – income market’s information sufficient to evaluate credit Risk?” pg 22, Dec.2002

Faktorët përcaktues në rritjen e huave me probleme sipas Louzis&Vouldis&Metaxas (2010) nuk duhet të shihen vetëm në faktorët makroekonomike, të cilët shihen si forca ekzogjene, që ndikojnë në industrinë bankare. Përkundrazi, tiparët e veçanta të sektorit bankar dhe politikat që çdo bankë zgjedh lidhur me përpjekjet për të maksimizuar efikasitetin dhe përmirësuar menaxhimin e rrezikut të tyre, pritet të ushtrojnë ndikimin e tyre vendimtar në ecurinë e huave me probleme, e cila ka një vend të veçantë në literaturë ku pasqyrohen gjetje përkatëse, që ka të bëjë me lidhjen midis faktorëve specifike bankar dhe huave me probleme.³⁰

Ndaj vetë bankat në varesi të nivelit të riskut që ndërmarin ndërsa kreditojnë bizneset, kanë një ndikim të rëndësishëm në nivelin e huave me probleme, të cilat në vetevetë kur arrijnë nivele të larta frenojnë huadhënien e vetë bankave duke krijuar përplasje në ciklet e biznesit.

Rregulloret dhe procedurat të cilat nuk rishikohen në përputhje me tendencat dhe zhvillimet e tregut në tërësi dhe ato të vendit në veçanti behen pengese dhe shkak i fenomenit të uljes së cilësisë së portofolit të huave dhe paralel fenomenin e rritjes së huave me probleme.

Greenspan, A., vë theksin në domosdoshmërinë e rishikimit të rregulloreve duke thënë se:

Rregulloret kanë afatin e tyre të skadimit dhe duhen rishikuar periodikisht, këtë mësim e mësova shpehet Greenspan duke ndjekur Virgil Mattingly-n shefin e vjetër të stafit juridik të bordit të Fed-it, i cili e merrte shumë seriozisht kërkesën statusore për rishikimin e çdo rregullore që gjykohej e vjetëruar, nxirrej jashtë përdorimi pa ceremoni³¹ Greenspan, A. (2007:434)

Kur niveli i huave me probleme arrin të bëhet një shqetësim thelbësor për bankën, atëherë banka frenon kreditimin e biznesit deri në nivelin e mjaftueshmërisë, gjë e cila kthehet në të kundërt të ecurisë financiare të vete bankes, për shkak të fenomenit rritës të huave me probleme.

³⁰ Louzis, D.P., Vouldis, A.T., Metaxas, V.L.: “Macroeconomic and bank-specific determinants of non-performing loans in Greece: a comparative study of mortgage, business and consumer loan portfolios”, Working Paper no.118, Bank of Greece, September 2010, pg.11.

³¹ Greenspan Alan “the Age of Turbulence/Epoka e trazirave” kapitulli Globalizimi dhe rregullimi, Fq 434, 2007, përkthyer në shqip nga Prof Aristotel Pano në 2011

Ndërsa, (Impavido 2012; 23), argumenton se dinamika e dobët e huave natyrisht pasqyron një kërkesë të ulët për hua në një ekonomi përgjithësisht të qetë, dhënia e huave dobësohet nga niveli i lartë i huave me probleme të cilat gjithashtu luajnë një rol të veçantë. Për më tepër, kërkesa e dobët për hua dhe oferta e dobët e huadhënies janë ngushtësisht të ndërthurura: kriza e huave është e lidhur me ecurinë e dobët financiare makroekonomike dhe kjo në kthim dobëson kërkesën për hua³².

Sikundër përmend Impavido (2012:11) në të njëjtin punim të tij, huatë me probleme të pazgjidhura priren të frenojnë aktivitetin e huamarrësve të mbingarkuar me borxhe dhe vonojnë rishpërndarjen e aktivëve të tyre në përdorime më produktive.

Impavido vijon citimin e tij referuar rrezikut që paraqesin huatë me probleme:

Por niveli i lartë i huave me probleme lehtësisht mund të përbëjë një rrezik të vërtetë për stabilitetin financiar, pasi bankat regjistrojnë humbje të mëdha, duke dobësuar bazën e kapitalit të tyre, si dhe duke rritur probabilitetin për një paaftësi paguese dhe mungesë të madhe likuiditeti. Stabiliteti i përgjithshëm financiar mund të jetë në rrezik, nëse fillojnë dhe shfaqen të tilla probleme në një pjesë të rëndësishme të sistemit bankar.³³ (Impavido 2012:16),

Një aspekt tjetër i ndikimit negativ në ekonomi të nivelit të lartë të huave me probleme është vonesa që shkakton dhe pengesa në ringritjen dhe rigjallërimin e ekonomisë. Sikundër thekson dhe Abiad (2011:17), procesi i ringritjes pas krizës financiare është veçanërisht i zgjatur, sepse priret të jetë “i pafinancuar me hua” për shkak të dobësisë së ndërmjetësve financiarë³⁴.

Niveli i dobët i huadhënies rëndon dukshëm mbi kërkesën agregate, por ajo gjithashtu lidhet ngushtë dhe ndikon shumë dhe mbi ofertën agregate dhe ndryshimet sektoriale, pasi bie niveli i investimeve.

³² Impavido, G. Kligen, C.A., Sun, Y.: “Non-Performing Loans and the Macroeconomy”, IMF, March 2012, Pg.23.

³⁴ Abiad, A., Dell’Ariccia, G., & Bin L., 2011, “Creditless Recoveries,” IMF Working Paper 11/58, Washington, March 2011, p.17.

Krizat financiare, si cikël normal biznesi dhe ringritja e shpejtë apo një rekuperim të ngadalë të ekonomisë së vendit është e ndikuar shumë nga kultura e vendit në të cilën ndodh. Kultura të ndryshme kanë reagime të ndryshme ndaj bizneseve në krizë. Në Amerikë ringritja nga kriza vjen më shpejtë, ndërsa në vendet ku vlerat shoqërore janë parësore në marrëdhëniet e biznesit, ringritja vjen më ngadalë, këto janë tipike në vendet e Azisë, ku për të ruajtur reputacionin e pronarit, shoqëria ka pritur që produktet të marrin kohë më të gjatë për t'u thithur nga tregu, duke zgjatur kohën e ringritjes së ekonomisë. Rreziku i besueshmërisë zë rreth 70 për qind dhe 30 për qind që mbetet ndahet midis dy rreziqeve të tjerë kryesorë, që janë rreziku i tregut (ndryshimet në çmimet e tregut dhe rreziku operacional, që do të thotë dështimi në kontrollet e brendshme, etj).

Struktura dhe Konkurenca bankare si shkak në rritjen huave me probleme

Denizer (1997:17) thekson se rishikimi i zhvillimeve në sistemin bankar sugjeron që struktura e tregut vazhdon të ketë një impakt të rëndësishëm në performancën e bankave dhe implikimin e konkurrencës. Sidoqoftë, observimet në vetvete nuk janë të mjaftueshme për të vendosur një lidhje kauzale midis këtyre parametrave, të cilët kërkojnë një studim empirik.³⁵ Përqëndrimi i tregut nga pak banka ndikon në dështimin e konkurrencës bankare dhe rolit të saj për të parandaluar këtë lloj fenomeni. Kjo krijon mospërballimin e sistemit duke ndikuar negativisht operimin normal të bankave. Literatura teorike analizon atë nëpërmjet marrëdhënies midis konkurrencës dhe performancës dhe stabilitetit të sistemit bankar.

Në përpjekje për të gjetur një korelacion midis studimeve teorike dhe kërkimeve të fundit empirike, bëhet më e lehtë për të kuptuar që ka kontradiksione midis tyre. Autorë të ndryshëm nuk kanë një qëndrim të njëjtë referuar konkurrencës dhe përqëndrimit bankar.

³⁵ Denizer, C.: "The effects of Financial Liberalization and New bank Entry on Market Structure and Competition in Turkey", Macroeconomics and Growth Development Research Group, Sept. 1997. Pg17.

Claessens (2003:8) konfirmon se “masat konkuruese ndikojnë negativisht në përqëndrimin e sistemit bankar”³⁶.

Sipas Carletti dhe Hartman (2002), bankat dhe sistemi bankar kanë një status të veçantë, kryesisht sepse ato konsiderohen si shumë të pa mbrojtura ndaj destabilitetit në krahasim me sektorë dhe firma të tjera.”³⁷

Schnitzer (1998) thekson që, efektet e konkurrencës bankare, efënca e alokimit të kredive dhe se si struktura e tregut të sektorit bankar që vetë ndikohet në se hyrjet në këtë treg nuk janë të rregulluara. Hyrjet e lehta në treg, bëjnë që të rezultojë fenomeni i shumë bankave që hyjnë në treg, të cilat japin efektin e rritjes së huave me probleme.³⁸

Në këtë kontekst, mund të supozohet që konkurrenca bankare, përveç këtij statusi të veçantë të bankave, të konsideruara si shumë të pambrojtura ndaj destabilitetit (e lidhur kjo edhe me fazën e gjatë të tranzicionit nga stili i vjetër bankar i operimit të ekonomisë së centralizuar në një ekonomi të lirë tregu) ka relativisht më shumë mundësi të mos jetë e suksesshme krahasuar me vënde të tjera.

Heffernan (2005) thekson të njëtin problem të manaxhimit të lartë të bankave, të cilët janë të gatshëm të imitojnë apo kopjojnë inovacionet e patestuara financiare nga bankat e tjera në përpjekjen e tyre për të rritur e garantuar fitimin. Përsëri burimi i problemit është asimetria e informacionit në këtë sektor. Një nga pasojat e të cilit është që në se në sektorë të tjerë, menaxherët/drejtuesit e kompanive luftojnë për të diferencuar produktet e tyre, bankierët duken sikur nxitojnë të kopjojnë veprimet e bankierëve të tjerë, suksesi i të cilëve është kontribut i inovacioneve financiare.³⁹

Përsa i përket problemit të agjensisë, Matthews dhe Thompson (2005), theksojnë se:

³⁶ Claessens, S., and Leaven, L.: “What drives Bank Competition, some international evidence” World bank Policy, working paper 3113, August 2003, p.8.

² Carletti, E., and Hartmann, F.: “What special about Banking” European Central Bank”, working paper no 146, p. 8, May 2002.

³⁸ Schnitzer, M.: University of Munich and CEPR: “Bank Competition and enterprise restructuring in transition economies” Oct 1998, p.1.

³⁹ Heffernan, Sh.: “Modern Banking” Ch.7.4.2 Managerial Problems, 2005.

“...ndarja e pronarëve nga menaxhimi në korporatat moderne ka krijuar problemin e agjensisë dhe që është se menaxherët – dmth, agjentët - do të operojnë për tju shërbyer interesave të vet tyre, të cilat mund të mos jenë në interesin më të mirë të mundshëm të pronarëve⁴⁰”.

2.8 Debatet ndërkombëtare dhe kritikrat referuar rregulloreve dhe procedurave të kreditimit

Sikundër dhe përmëndur më lart Bankat dhe institucionet huadhënëse janë mjaft të veçanta, përse i përket natyrës së risqeve që ato mbartin në aktivitetin e tyre dhe si të tilla ato operojnë nën korniza strikte rregulloresh që të garantojnë shmangien nga risqet eventuale. Arukumar dhe Kotreshwar (2006), shprehet se bankat nuk janë si bizneset e tjera, ato luajnë një rol kritik në ekonomi, dhe ndaj është e nevojshme të diferencohen nga një rregullim më intensivë sesa sektorët e tjerë.⁴¹

Teksa kemi një aprovim të tillë, një shqetësim referuar rregulloreve dhe mbikqyrjes ngrihet nga studiues se këto të fundit nuk kanë arritur të jenë në koherence me zhvillimin e tregut dhe në konflikt me aplikimet individuale për kredi, ndaj e nevojshme që rregulloret të mos mjaftohen me garantimin që i duhet bërë aktivitetit kreditues bazuar në kushtet reale të tregut, por duke marrë në konsideratë dhe zhvillimet e ardhme të tregut për të shmangur rreziqet potenciale të kredisë.

Ciuriak (2010), në librin e tij thekson se:

“Kornizat moderne dhe të kujdesshme për institucionet financiare së bashku me standartet e publikuara/njohura për huamarrësit dhe investitorët, është kështu një sistem i zhvilluar që përfshin dhe përmbledh një eksperiencë të pasur. Për më tepër ai thekson se: “Më në përgjithësi, ka shqetësime që kornizat rregullatore dhe mbikqyrja nuk ka arritur të kapë evolucionin e shpejtë të tregut në vetvete, duke ngritur pyetjet shqetësuese të rolit në kriza të lojtarëve të sektorit privatë. Ciuriak. D (201:43)

⁴⁰ Matthews K, K. and Thompson, J.: “The Economics of Banking” Ch. 4, “Retail and wholesale banking”, p. 60, 2005.

⁴¹ Profesor Rekha Arukumar, Dr G. Kotreshwar Risk management in commercial banks’ Pg3. SSRN WEB.

Këto praktika garantojnë një ekuilibër e stabilitet të sistemit financiar në një vend apo rajon, ndaj ato duhen zbatuar me shumë kujdes në praktikat e kreditimit.

Zbatimi në praktikë i rregulloreve dhe standarteve ka rëndësi të veçantë, ky pohim del qartë nga Yupana Wiwattanakantang (2002), i cili shprehet se:

një varg i madh standartesh të forta mbi financimet, që literatura sugjeron, duhet të jetë e rëndësishme të spejgohet se aksesit me i lehtë ndaj huave, benë që standartet të luajnë një rol me pak të rëndësishëm, duke sugjeruar një mbeshtetje ndaj hipotezës që favorizimi i të afermeve me hua të pamërituara është një faktor i rëndësishëm në dhënien akses të huave afatgjata të cilat i paraprijnë krizave financiare⁴².

Vënia në zbatim e këtyre rregulloreve në mënyrë sa më të përshtatshme me natyrën e biznesit ku operohet, është e vështirë, pasi kërkon punonjës të kualifikuar e kjo në mënyrë të veçantë për vendet në zhvillim.

Ciuriak (2010), thotë që “edhe vëndet e zhvilluara përballen me kufizime të burimeve në terma të të dy çështjeve ato të personelit dhe të sistemit të mbikqyrjes dhe për staf të kualifikuar brenda vetë institucioneve financiare. Për vëndet në zhvillim, situata është akoma më e vështirë sepse i njëjti personel i kërkuar për mbikqyrje ka njohuritë për të fituar më shumë në institucionet financiare se sa ka nevojë mbikqyrja.

Për vetë rëndësinë që kanë marrë praktikat e procedurat e kreditimit në institucione huadhënëse, këto të fundit janë objekt rishikimi të vazhdueshëm nga Komiteti i Basel-it, dhe për të garantuar që operon nën Komitetin e Basel, “The Joint Forum”, është ngarkuar në çështjet e përbashkëta që shqetësojnë bankat, sigurimet dhe mbikqyrësit e sigurimeve duke përfshirë edhe rregulloret e industrisë financiare. Kështu sipas një studimi të bërë nga ky Forum, në Shkurt 2015, i cili synon të mos mbetet në nivelin e konstatimit të ngjarjeve të ndodhura, por të jetë një mjet për të dhënë një gjykim të rregulloreve aktuale të mbikqyrjes rreth riskut dhe situatës së Menaxhimit të Riskut të Kredisë në Banka, si dhe të implikimeve të mbikqyrjes dhe trajtimeve rregullatore të riskut të kredisë.

⁴² Yupana Wiwattanakantang Raja Kali Chutatong Charumilind “Crony Lending- Thailand before the Financial Crisis” March 2002, Pg2.

Gjetjet dhe rekomandimet e studimit të “The Joint Forum” hedhur në diskutim për institucionet financiare i referohen situatës në të cilën Risku i Kredisë, pas fillimit të krizës financiare botërore, ka marrë një rol parësor në banka dhe besueshmëria ndaj stress testeve që përdoren nga modelet e brendshme është rritur ndjeshëm duke riskuar që këto Menaxhime të riskut të kredisë ose modelet rregullatore të kapitalit mund të fshehin rritjen e marrjes së riskut. Ulja e këtij rreziku rekomandohet që mbikqyrësit të tregojnë kujdes ndaj besimit të tepruar të modeleve të brendshme duke kombinuar masa të thjeshta me modelet e sofistikuar për të dhënë një pamje sa më plotë të vlersimit të riskut.

Një tjetër gjetje e rëndësishme sipas Basel Committee (Feb 2015) i referohet momentit ku:

*normat e ulëta të interesit kanë shance të gjenerojnë një tendence “për të kërkuar fitim” nga disa banka, të cilat manifestojnë një risk të toleruar në produkte të ndryshme të tilla si auto huadhënia nga bankat, rritja e aseteve me risk në portofolet e investimit për sigurimin e jetës, duke sjellë si pasojë asete me cilësi të ulët me huamarrës ose partnere me vlerësim të dobët, që gjenerojnë më shumë risk kredie. Për të shmangur këtë risk potencial rekomandohet që mbikqyrësi të rritin vëmendjen ndaj fenomenit të një qasje të orientuar ndaj marrjes së riskut të tepruar duke sjellë nevojën që bankat të kenë një proces të përshtatshëm të menaxhimit të riskut.*⁴³

Për sa më lart rregulloret e sektorit financiar, janë në konflikt me huadhënien individuale dhe vlerësimin e aplikimeve për Kredi nga ana e riskut të kredisë. Hefferman (2005) thekson se rregulloret e sektorit financiar vihen si nominale (të supozuara) për arsye të ndryshme. Së pari të quajtura në konflikt me huadhënien analitikë, do të thotë që ajo që ka rëndësi më shumë është marëdhënia individuale me bankën. Konsiderohet e pakët mënyra se si vlerësohet përfitueshmëria e projekteve të propozuara, dhe pak se ska as vlerësim të

⁴³ Joint Forum, Developments in credit risk management across sectors: current practices and recommendations. February 2015

profilin e riskut të huamarrësit. Së bashku me mungesën e ekspertizës dhe stafit të kualifikuar, do të thotë se nuk janë përdorur metoda të vlerësimit të riskut nga bankat.⁴⁴

Për të garantuar një ekuilibër financiar afatgjatë, marrëveshja e Basel II, propozon përfshirjen e një ndjeshmërie më të madhe të riskut të kredisë. Marrëveshja e re është ndërtuar në tre kollona, Kërkesa për Kapital Minimal, Rishikim i Mbikqyrjes dhe Disiplina e Tregut. Arukunmar & Kotreshwar (2005) shprehen se marrëveshja e re jep një spektër të gjërë të qasjeve nga metodologjitë më të thjeshta tek ato më të avancuara të të dy risqeve atij operacional dhe të kredisë në përcaktimin e nivelit të kapitalit.

Në këtë kontekst, ka disa shqetësime rreth standarteve ndërkombëtare, të cilat mund të krijojnë risk kur nuk janë të përshtatur ndaj elementëve karakteristik të ekonomive përkatëse, dhe duhet të merren në konsideratë kur aplikohen rregulloret standarte moderne.

Ciuriak D (2010), referuar burimit nga të cilat hartohen rregulloret e mbikqyrjes financiare shprehet se:

Sistemi aktual i mbikqyrjes dhe rregullimit financiar është një përfshirje e madhe që përmbledh eksperiencat më të dobishme të fituara me dhimbje nga mësimet e krizave dhe dështimeve. Në ditët e sotme këto çështje ngrejnë pyetjen se si një institucion financiar individual duhet të menaxhojë punën e tij për të mbijetuar e patur sukses, dhe që është Funksionimi Perfekt apo i njohur me shprehjen “state of art” dhe përpjekjet për të përmirësuar atë, përballë pakësimit apo uljes së kthimit të huasë.

Bankat konsiderohen si të veçanta pasi risku dështimit që ekziston në aktivitetin e tyre është i përhershëm megjithë përpjekjet e bëra të derisotme për ta eliminuar atë. Modelet e aplikuara të matjes dhe vlersimit të riskut dhe besimi ndaj tyre jo gjithmonë janë në ato nivele që të krijojnë stabilitet financiar.

Këtë pikpamje e gjejmë të Caballero dhe Krishnamurthy (2008), të cilët theksojnë se:

⁴⁴ Heffernan, Sh.,: “Modern Banking”, Ch. 8.3. The South East Asian Financial Crises, 1997 -99, 2005.

“..një mësim nga kriza botërore financiare është që risku s’është asnjëherë tërësisht i izoluar nga bankat, të cilat mbetën një pjesë e dobët e sistemit financiar. Kur stabiliteti i institucioneve jobankare lëkundet nga mungesa e besimit të modeleve të vlersimit të riskut, investorët “fluturojnë drejt cilësisë” ata kërkojnë vetëm asete likuide dhe të sigurta.”⁴⁵

Bankat si ndërmjetës financiar midis depozituesve dhe huamarrësve duhet të operojnë në mënyrë të atillë që në këtë proces ndërmjetësimi të mos marrin risk të tepruar që venë në rrezik fondet e krijuara nëpërmjet depozitave, gjë e cila garantohej nëpërmjet mbikqyrjes bankare. Sikundër Heremans dhe Paccès (2011) përmendin, “Qëllimi i mbikqyrjes shpesh i njohur si një **“parandalues”** që bankat pre-supozojnë risk të lartë të papranueshëm, i cili mund të vërë në rrezik interesat e kreditorëve, që janë, mbajtësit e depozitave të kursimit në përgjithësi.”⁴⁶

Operimi i aktivitetit kreditues nën rregullore dhe praktika të sakta e të plota kreditimi është plotësisht i zbatueshëm nga bankat tregtare, ndërsa bankat qendrore garantojnë zbatueshmërinë e tyre në çdo praktikë të kreditimit.

⁴⁵ Caballero, Ricardo J. and Krishnamurthy, A.(2008), ‘Collective Risk Management in a Flight to Quality Episode’, *Journal of Finance*, 63 (5), 2195-2230.

⁴⁶ Heremans, D., and Paccès, A.M.,: “Regulation of Banking and Financial Market”, working paper series no 2011/04.

KAPITULLI III – KUSHTET DHE RRETHANAT EKONOMIKE DHE HISTORIKO - SOCIALE, TË CILAT MBËSHTESIN RRITJEN E SHPEJTË TË HUAVE ME PROBLEME

3.1 Hyrje

Rrethanat në të cilat operon një biznes janë shumë dominuese në përcaktimin e metodologjive dhe praktikave që duhen ndjekur në mënyrë që të arrijnë një performancë financiare pozitive, por nga ana tjetër edhe për studiusit në mënyrë të veçantë për t'u përafruar sa më shumë konkluzioneve shkencore në punimet e tyre. Risku i kredisë në Shqipëri është i lidhur ngushtë me këto rrethana, të cilat janë sa historike po aq edhe kulturore dhe si të tilla nuk duhen neglizhuar sa herë i referohemi vlerësimit dhe menaxhimit të riskut të kredisë. Kështu çdo institucion financiar duhet ti ketë parasysh mirë, ti njohë, vlerësojë dhe mat ndikimin e këtyre rrethanave në performancën e bizneseve dhe për pasojë ndikimin që ato kanë në riskun e kredisë, apo në riskun e moskthimit të kredisë.

Izolimi i pashembullt për një periudhë mbi 50 vjeçare, jo vetëm i marëdhënieve tregtare me vënde fqinjë apo dhe vënde të tjera të botës, izoloi vëndin dhe ekonominë nga zhvillimet e vrullshme të rritjes së rendimentit në punë nëpërmjet zhvillimit të teknologjisë dhe menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore. Faktor tjetër, centralizimi i prodhimit dhe shpërndarjes së të mirave materiale ka asfiksuar çdo ide novatore që do të çonin në një stabilitet ekonomik në rritje e progres. Këto faktorë e shumë të tjerë sollën që në fillim të viteve 90' Shqipëria të ishte një nga vendet më të varfëra në botë jo vetëm ekonomikisht por edhe në aspektin e ideve novatore e racionale, për të bërë biznes. Ekonomia e vëndit mbështetej kryesisht nga remitancat, të cilat megjithë kontributin e jashtëzakonshëm që patën në ekonominë e vëndit, nuk mund të ishin një faktorë i përjetshëm bazë për rritjen e ekonomisë. Fillimi i rënies së remitancave, në një farë mënyre u kompensua/zëvëndësua nga krijimi i bankave private të nivelit të dytë, apo siç quhen së fundmi bankat tregtare, të cilat kanë luajtur një rol të jashtëzakonshëm në balancimin e burimeve monetare në vënd. Mbledhja e depozitave nga njëra anë dhe kreditimi i bizneseve nga ana tjetër ndihmoj

shumë në zhvillimin e bizneseve ekzistuese, duke ndikuar jo vetëm në financimin e investimeve afatmesme dhe afatgjata që çonin në zhvillimet e reja të teknologjisë por edhe në financime për kapital qarkullues.

Dora-dorës Sistemi bankar në Shqipëri sa vinte dhe bëhej më konkurrues e paralelisht procesi i formalizimit të ekonomisë ka mbështetur sistemin bankar që të ketë më shumë akses në njohjen e bizneseve individual apo të sektorëve të rëndësishëm apo ekonomisë në tërësi. Edhe pse një vënd me një eksperience shumë të shkurtër të ekonomisë së tregut, sistemi bankar shqiptar i përbërë kryesisht nga degë dhe filale të bankave me emër në botë, arriti të jetë promotor mjaft i rëndësishëm jo vetëm në zhvillimin ekonomik por edhe në aspektin e menaxhimit dhe sjelljen e një kulture të re të menaxhimit të biznesit.

Huadhënia në Shqipëri në formën e saj institucionale dhe të mirëformalizuar kryhet kryesisht nëpërmjet sistemit bankar, dhe më konkretisht bankave tregtare. Në një ekonomi në tranzicion ku me së shumti të vetmit operatore financiarë janë bankat tregtare, këto të fundit janë kthyer në promotorin e zhvillimit ekonomik të vendit. Në 10-15 vitet e historisë së financimit me hua të sektorit privat dhe atij shtetëror në Shqipëri, statistikat tregojnë se kreditimi i ekonomisë nga Institucionet financiare, luajnë një rol të rëndësishëm jo vetëm në aspektin e krijimit të likuiditetit të nevojshëm për zhvillimin e sektorëve të ekonomisë por edhe të kontributit që këto Institucione japin në drejtim të balancimit të saj. Industria e shërbimit financiar në Shqipëri është në hapat e saj të parë drejt konsolidimit e operimit në një treg konkurrues dhe si e tillë është e kufizuar në shërbime dhe entitete financiare në raport kjo relativ me zhvillimin aktual modern të industrisë së shërbimit financiar botëror. Sistemi bankar shqiptar u përball me vështirësi të mëdha të operimit në një mjedis ekonomik të vështirë, ku ekziston shkalla e lartë e informalitet të tregut, e pranuar kjo edhe nga vetë BSH, dhe të mungesës së burimeve të rëndësishme të informacionit si Regjistri i Kredive, i cili ka funksionuar relativisht vonë në raport me ekspansionin e kreditimit në vend.

Liria ekonomike e konsideruar si e kufizuar për shkak të stadit të zhvillimit të vendit, si një faktor frenues për një zhvillim akoma më të vrullshëm ekonomik, ka ndikuar në një

integrim me të ngadaltë të ekonomisë shqiptare me tregun ndërkombëtar, dhe kjo ka frenuar në një farë mase importimin e krizës financiare në vend. E gjejmë me një kontekst të ngjashëm te Greespan (2007), ku shprehet se – sa më e madhe liria ekonomike, aq më e madhe është rrezja e rrezikut të biznesit dhe shpërblimi i tij, dmth fitimi, prandaj akoma më e madhe është edhe prirja për të fituar⁴⁷. Industria e shërbimit financiar në Shqipëri përbëhet nga Institucione të ndryshme financiare siç janë bankat tregtare, Institucionet e kursimit, unionet e kredisë, të gjithë ato entitete, të cilat financojnë asetet/aktivet e tyre nëpërmjet depozitave të qytetarëve. Gjithë institucionet financiare kanë një gjë të përbashkët që është përpunimi i rrezikut dhe kontrollit të balancuar.

Biznesi shqiptar përherë e më shumë operon në një treg global, duke u ndeshur jo vetëm me sfida që lidhen me riskun e vëndit por edhe me risqe të tregut botërore së fundmi. Bankat tregtare në mënyrë të vazhdueshme hartojnë politika e procedura që bëjnë të mundur kufizimin e risqeve në përgjithësi, duke përfshirë këtu riskun e tregut, riskun e kredisë, riskun operativ dhe më tej riskun e normave të interesit dhe atë të likuiditetit.

Aktualisht Industria e tregut financiar në vënd ka një përbërje të thjeshtë të këtij sektori dhe që kryesisht janë institucionet financiare banka dhe jo banka. Të dyja këto nën grupe kryejnë aktivitete të ndërmjetësimit financiar dhe aktivitete ndihmëse të lidhura ngushtë me ndërmjetësimin financiar. Dallimin midis këtyre dy nëngrupeve të mëdha e përbenë fakti se bankat janë pranuese të depozitave, ndërsa institucionet financiare jobanka nuk klasifikohen si pranuese të depozitave. Struktura e thjeshtë e industrisë financiare në vend, dhe gama e pakët e produkteve që shërbehen në treg përbënë një mangësi dhe reflekton integrimin e pamjaftueshëm të këtij tregu me zhvillimet e industrisë financiare botërore, të cilat janë më komplekse dhe përfshijnë shumë ndërmjetës financiare të natyrave të ndryshme dhe produkteve të shumta që ofrojnë. Kjo natyrë dhe strukturë e tregut financiar Shqiptar, megjithë ndikimin e vetë pozitiv në zhvillimin e ekonomisë së vëndit, ka lënë vend për gabime dhe përmirësime. Mungesa e një burse të mirfilltë shqiptare do të ndihmonte shumë sistemin financiar për tu rikuperuar më shpejt dhe do i jepte ekonomisë

⁴⁷ Greespan, Alan “Epoka e Trazirave”, 2007, Pg 316

një impuls më të madh në ringritjen e saj. Industria financiare e tregut shqiptar është e dominuar nga bankat tregtare në një përqindje mjaft të madhe, ndërsa institucionet e tjera të përmendura më sipër janë me një pjesmarrje fare të vogël duke dhënë një ndikim të papërfillshëm në ekonominë e vendit.

Në këtë punim është bërë përpjekje për të konkluduar mbi *vlersimin dhe menaxhimin e risqeve në sistemin bankar shqiptar, duke e parë këtë të lidhur ngushtë me teoritë standarde të vlerësimit e menaxhimit të riskut botëror dhe gjithashtu me rrethanat specifike të vëndit tonë*. Duke e parë si një proces në vetëvete që ka ardhur duke u zhvilluar në kohë, gjithashtu ndikuar nga faktorë politikë e socialë të vëndit gjatë gjithë periudhës së tranzicionit ekonomik të vëndit.


3.2. Qasja e bankave shqiptare në kreditimin e biznesit gjatë krizes globale financiare

Huadhënie do të thotë më shumë se sa thjesht të japësh para; ajo ka të bëjë me besimin, dhe kjo është pak a shumë e njëjta gjë në gjithë botën, kështu që besimi është tërësisht subjektiv, në ngjarjet e krizave, kur bankat humbin besimin, ato nuk japin hua, siç ndodhi e po ndodh në Shqipëri, gjatë periudhës nga 2009 deri më sot, ku bankat kan frenuar ndjeshëm procesin e kreditimit. Sidoqoftë sikundër dhe Caballero dhe Krishnamurthy (2008) theksojnë “...një mësim nga kriza botërore financiare është që risku s’është asnjëherë tërësisht i izoluar nga bankat, të cilat mbetën një pjesë e dobët e sistemit financiar. Kur stabiliteti i institucioneve jobankare lëkundet nga mungesa e besimit të modeleve të vlersimit të riskut, investitorët “fluturojnë drejt cilësisë” ata kërkojnë vetëm asete likuide dhe të sigurta (Callabero 2008).⁴⁸ Krejt e kundërta ndodh në anën tjetër, në besimin e depoziuesve kundrejt sistemit bankar Shqiptar, i cili ka qënë e mbetet stabël dhe i sigurtë, sidoqoftë nuk është plotësisht e qartë nëse kjo është një çështje e besimit ose e pa mundësisë për të patur alterantivave të tjera investuese, në mungesë të një tregu të dytë të

⁴⁸ Caballero, Ricardo J. and Krishnamurthy, A.(2008), ‘Collective Risk Management in a Flight to Quality Episode’, *Journal of Finance*, 63 (5), 2195-2230.

këmbimit për letrat me vlerë të qeverisë në Shqipëri. Portofoli i huave të biznesit të bankave shqiptare është i bazuar në një numër të kufizuar biznesesh, të cilat kanë lidhje direkte e kronike me bankat, në mungesë të një regjistri kombëtar të kredive dhe një stafi të mirë trainuar në kryerjen e analizave të aplikimeve për kredi. Ndërsa roli i menaxhimit të riskut ishte i dobët dhe modest, në zgjedhjen dhe vlerësimin e aplikimeve për kredi cilësisht të plota. Rezultati final i një qasje të tillë ishte që i njëjti humarrës, aktualisht një humarrës potencialisht që nuk performon, ishte financuar nga 3-4 banka të ndryshme, në të njëjtën kohë. Duke marrë në konsideratë faktin që rregjistri i kredisë kombëtare fillojë të operojë në Janar 2008, kjo situatë beri që bankat të kenë vështirësi në identifikimin e borxheve reale në banka të aplikanteve për kredi. Kështu gjatë bumit të kredive e cila i korespondojë periudhës 2003 deri 2008, efënca e regjistrit të kredisë ka qënë pothuaj pa kontribut, dhe operimi i tij në Janar 2008, vetëm sa identifikojë ekspozimet reale të bizneseve në banka. Për sa i takon nivelit të huave me probleme, ato kanë kapërcyer nivelet normale në mënyrë të menjëhershme nga vitit 2009, kur ato arritën mbi 10% kundrejt nivelit mesatar respektiv të 3% deri në 5%, gjatë periudhës 2003–2008, për tu shumëfishuar në 24%, nga fundviti 2012, vit i cili ka shënuar dhe nivelin më të lartë të tyre gjatë kësaj periudhe krize globale, dhe të qëndrojë në pothuaj të njëjtat nivele edhe për vitet në vijim 2013 dhe 2014. (shih Grafikun nr 1).

Grafiku nr 1. Prirja e Huave me Probleme në raport me stokun e Portofolit të huave gjatë 2003-2014



Burimi: Banka e Shqipërisë

Bankave tregtare ju kushtoj shtrenjtë nguti i huadhënies së shpejtë, me një protofol cilësisht të ulët, të shkaktuar nga shmangia e kërkesave bazë minimale të praktikave të huadhënies të ashtuquajturat 5 K-të. Disa banka, të cilat ishin shumë agresive në huadhënie gjatë periudhës 2006-2009 nëpërmjet aplikimit të interesave të ulëta, si rezultat i kostove të ulëta të parave të përfituara nga mëmat e tyre jashtë vendit, prodhuan një numër të madh të huave që bazoheshin në cilësinë dhe vlerën e kolateralit, duke anashkaluar kështu katër K-të e tjera të rëndësishme si Kapaciteti ripagues, Karakteri i klientit, Kapitali dhe Kushtet. Huatë me probleme të këtyre bankave sot variojnë midis 30% - 40% të stokut të portofolit të tyre në total, pjesërisht kjo e ndikuar nga fakti që këto banka nuk kanë kredituar gjatë periudhës së krizës financiare globale, përderisa interesi i tyre primar ishte mbledhja e huave ekzistuese, prandaj edhe stoku i tyre i portofolit të huave ka rënë në mënyrë drastike gjatë gjithë periudhës së krizës globale që filloj në 2009 e që ende nuk po tregon shenja përmirësimi të rëndësishme në mbarë botën.

Në tabelën në vijim janë të dhënat mbi totalin e portofolit në vlerë për çdo bankë si dhe huatë me probleme në vlerë dhe në përqindje mbi total protofolin e çdonjërës prej bankave tregtare në aktivitetin kreditues në vend. (shih tabelën nr 1 dhe grafikun nr 2 në vijim)⁴⁹

Tabela nr 1. Stoku i Portofolit dhe Huatë me Probleme, Dhjetor 2014⁵⁰ për çdo bankë tregtare në Shqipëri.

Në milion lekë

Nr	Bankat Tregtare	Total Portofoli 2014	Hua me Probleme 2014	Hua Probleme në %
1	Banka e Bashkuar	1,774	1,183	67%
2	Tirana Bank	43,756	18,954	43%
3	Credit Agricole	17,148	6,769	39%
4	NBG	27,200	9,748	36%
5	Alfa Bank	33,704	11,102	33%
6	Intesa SanPaolo Bank	46,713	12,997	28%
7	Raiffesen Bank	121,217	31,545	26%

⁴⁹ 9 bankat, të cilat ishin më agresive në huadhënie gjatë periudhës 2006 - 2009, të cilat rezultuan me Hua me Probleme në nivel më të lartë në fund të vitit 2014.

⁵⁰ Banka e Bashkuar përbën një përjashtim nga gjithë sistemi bankar, për nivelin e lartë të huave me probleme, duke qënë se portofoli i saj është i papërfillshëm nuk e kemi marrë në konsideratë si një fenomen tipik.


8	Credins Bank	88,104	17,465	20%
9	Veneto Bank	18,330	2,978	16%
10	Union Bank	14,783	2,302	16%
11	Procredit Bank	23,652	3,520	15%
12	First Investment Bank	6,504	948	15%
13	BKT	104,660	11,779	11%
14	SOGEN	40,208	3,926	10%
15	ICB ⁵¹	3,548	271	8%
	Total portofoli	591,300	135,386	23%

Burimi: Banka e Shqipërisë & raportet vjetore të bankave tregtare

Huatë me probleme konsiderohen gjithë ato hua, të cilat kanë paraqitur vonesa në pagimin e detyrimeve ndaj bankës mbi 90 ditë deri mbi 360 ditë, dhe në varësi të ditë vonesave klasifikohen në klasa të ndryshme, nga nënstandarde, në të dyshimta dhe në të humbura. Këto hua i kushtojnë bilancit të bankave shpenzime të zhvlersimit të tyre nga 20% deri në 100% të tepricës së kredisë, duke përkeqsuar shumë tregues të likuiditetit e përfitueshmërisë së bankës. Situata në 31 Dhjetor 2014 në sistemin bankar për çdo bankë, paraqitet në vijim ku vihet re se, përveç Bankës së Bashkuar, bankat e tjera me nivel më të lartë të huave me probleme janë bankat me origjinë nga Greqia, vendi që ka përjetuar me ashpër krizën financiare globale, dhe që ka importuar efektet e saj dhe në vendin tonë.

Grafiku nr 2. Huatë me Probleme në përqindje ndaj Stokut të Portfolit të huave në Dhjetor 2014 për çdo bankë tregtare në Shqipëri.

⁵¹ International Comercial Bank




Ndërsa bankat në rolin e tyre si huadhënës kanë përjetuar një seri të goditjeve negative të rritjes, qëndrimi dhe qasja e tyre bëhet me konservative në nivelin e tyre substancial duke rritur vëmëndjen ndaj rrezikut të tyre. Dhe kjo është një eksperiencë mjaft e përjetuar në Shqipëri në 4-5 vitet e fundit të rënies ekonomike, ku shumica e bankave në vënd jo vetëm që stopuan kreditimin e klientëve të tyre, por kërkuan kthimin e borxheve në disa raste duke afruar e shtrënguar kohën e ripagimit të tyre. Sistemi bankar Shqiptar e provon këtë duke krahasuar të dhënat statistikore të botuara nga vetë bankat mbi tepricën e portofolit të huave në fund të vitit 2009, që njihet si viti i fillimit të krizës globale financiare, dhe në fund të vitit 2014, i cili pasqyron më mirë efektin që ka patur në nivelin e kreditimit kriza globale financiare. (Shih tabelën nr 2 dhe grafikun nr 3 në vijim):

Tabela nr 2. Qasja huadhënëse e bankave gjatë dy periudhave, bumit të huave kundrejt asaj të krizës financiare

Periudha në vite	2003	2008	2008vs2003	2009	2014	12vs14
Rritja e huave në mild lekë	48	377.5	329	437	591	154
Niveli i Huave me Probleme	3%	6%	3%	11%	23%	12%


Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafiku nr 3. Prirja e huadhënies gjatë bumit të huave kundrejt periudhës së krizës



Ndërsa gjendja e portofolit të huave në 2008 në raport me 2003, gjatë periudhës së bumit të kredisë, është e rritur mbi 7-8 herë, për të njëjtën periudhë gjendja e huave me probleme në 2008 është vetëm dyfishuar nga 3% në 6%. Ritmi i madh i rritjes së huadhënies, në një farë mënyrë ka fshehur cilësinë e portofolit të huave të dhëna gjatë kësaj periudhe. Në të njëjtën logjike do të vlerësojmë edhe situatën e gjendjes së portofolit të huave në 2014 në raport me 2009, gjatë periudhës së frenimit të kreditimit nga bankat tregtare në vend si reagim i rritjes së shpejte të huave me probleme që pasoj nga viti 2009 e deri në ditët e sotme, (shih grafikun nr.4) ku niveli i huave me probleme në 2014, arrin nivelin më të lartë të tyre me

Grafiku nr 4. Prirja e nivelit të huave me probleme gjatë bumit të huave kundrejt periudhës së krizës



Burimi: Banka e Shqipërisë

23% të total portofolit të huave në gjithë sistemin bankar, ose më shumë se dy herë në raport me nivelin e tyre në vitin 2009. Ritmi i huadhënies bankare gjatë kësaj periudhe, në ndryshim me atë të periudhës së bumit të kredive nxori në pah cilësinë reale të portofolit të huave të bankave tregtare të vendit.

3.3 Roli i njësisë së riskut dhe mangesitë e vërejtura në menaxhimin e aktivitetit kreditues në sistemin bankar shqiptar gjatë periudhës së bumit të kredive

Roli i njësisë së Riskut ka marrë një rëndësi të madhe në menaxhimin e portofolit të huave në banka në kohë, për më tepër me shpërthimin e krizës financiare Globale pas vitit 2008.

Banka e shqipërise (BSH), anëtare e Komitetit Basel, si mbikqyrëse e aktivitetit të bankave tregare, ka ushtruar mbikqyrje të fortë por relativisht të vonuar, në një kohë kur portofoli i kredive ishte pothuaj krijuar. Një problem manaxherial i veçantë në Shqipëri është dhënia e financimeve në një apo dy sektorët me përfitueshmëri më të lartë të ekonomisë, të tillë si ai i ndërtimit/shitblerja e pronave dhe tregtia, ku shumica e bankave ngutin e vrapojnë për të kopjuar njëra tjetrën, dhe kjo vetëm për të rritur fitimet e tyre. Bankat priren të kopjojnë njëra tjetrën në shërbimet dhe produktet që ofrojnë ndryshe nga bizneset që operojnë në industri të tjera të cilat konkurojnë në treg duke krijuar novacione të reja ndryshe nga konkurentet e tyre. Bankat ishin të pakujdesshme rreth trendeve të zhvillimit të këtyre sektorëve, kështu këto banka humbën elementin e rëndësishëm që i privonte nga rreziku i moskthimit të huave dhe që është diversifikimi i portofolit të huave. Një tjetër problem manaxherial në sistemin bankar shqiptar, ashtu si edhe në korporatat e mëdha botërore, për shkak se kryesisht ato janë me kapital të huaj, ndikohen nga i ashtuquajti “problemi i agjencisë”, që do të thotë se shumica e bankave operuese menaxhohen nga jopronarët, interesat e të cilëve ndryshojnë nga interesat e pronarëve. Përsa i takon problemit të agjencisë, Matthews dhe Thompson (2005), theksojnë se , “...ndarja e pronarëve nga menaxhimi në korporatat moderne ka krijuar problemin e agjencisë, dhe që është se menaxherët –d.m.th, agjentët-do të operojnë për tju shërbyer interesave të vet tyre, të cilat

mund të mos jenë në interesin më të mirë të mundshëm të pronarëve⁵². Përveç gjetjeve të përmendura më lartë, në shumicën e bankave tregtare, Njësia e Riskut të Kredisë, mori rolin e saj në praktikën e kreditimit pas vitit 2007 dhe në disa banka edhe më vonë, kohë gjatë të cilës portofoli i kredive ishte pothuajse i krijuar. Në këtë situatë është e qartë se roli i menaxhimit të riskut në praktikën e huadhënies ishte modest në krijimin dhe ndërtimin e një portofoli cilësor të kredive. Duke ndjekur kërkimet e kryera në 12 bankat në vënd nga 16 që operojnë në sektorin bankar në Shqipëri, del konkluzioni se 4 banka tregtare nga 9 bankat me aktive në huadhënie krijuan Njësine e Riskut përpara vitit 2006 dhe 5 bankat e tjera vetëm mbas vitit 2007. Përveç kësaj vetëm në 5 banka, Njësia e riskut të kredisë ka autoritet vendimarrës në komitetet e aprovimit të kredisë; në 4 banka Departamenti i Menaxhimit të Riskut të Kredisë nuk ka të drejtë votë por të drejtë rekomandimi, dhe në 4 banka të tjera Departamenti i Menaxhimit të Riskut ka të drejtë VETO, që do të thotë se në se Njësia e riskut refuzon kreditimin e një aplikimi për kredi, pavarësisht anëtarëve të tjerë të Komitetit të Kredisë, rasti refuzohet. Mosrespektimi i praktikave dhe procedurave moderne të kreditimit nga shumica e bankave, të cilat ishin shumë agresive në huadhënie gjatë periudhës 2006-2009 (shih tabelen 2 dhe grafikun nr 3 më sipër)⁵³ nëpërmjet aplikimit të interesave të ulëta, si rezultat i kostove të ulëta të parave të përfituara nga mëmat e tyre jashtë vendit, prodhuan një numur të madh të huave që bazoheshin në cilësinë dhe vlerën e kolateralit, duke anashkaluar kështu K-të e tjera. Gjithë sa më sipër ka rezultuar në një protokoll kredie të sistemit bankar me diferenca të mëdha në nivelet e Huave me probleme që variojnë midis 10% - 42% të stokut të portofolit të tyre në total, pjesërisht kjo e ndikuar nga fakti që bankat me nivele më të larta të HP kanë frenuar tendencën rritëse të kreditimit të ekonomisë dhe në disa raste kanë ulur stokun e portofolit, përderisa interesi i tyre primar ishte mbledhja e huave ekzistuese. Të njëjtën situatë e gjejmë te Ivashiva (2008) e cila shprehet se paniku i krizës financiare globale ka prapsur këto banka në huadhënie të reja, duke çuar në uljen e stokut të portofolit të huave⁵⁴. Pesë K-të (Kapaciteti, Karakteri,

⁵² Kent Matthews, K. and Thompson, J.: "The Economics of Banking" Ch. 4, "Retail and wholesale banking", p. 60, 2005.

⁵³ 9 bankat, të cilat ishin më agresive në huadhënie gjatë periudhës 2006 - 2009, të cilat rezultuan me Hua me Probleme në nivel më të lartë në fund të vitit 2014.

⁵⁴ Ivashiva, V, Scharfstein, D.: "Bank Lending during the financial Crises of 2008", p.8.

Kapital, Kolateral, dhe Kushtet), si faktorët tradicioanal, sipas Greenbaum (2007) nuk u morën në konsideratë në analizat e aplikimeve për kredi, dhe “qëkur “rregullat bazë” zakonisht të krijuara nga eksperiencat e akumuluar, anashkalohen, ato duhet të qëndrojnë në perceptimin teorik të marëdhënies “Ripagimi i huasë i lihet rastit”⁵⁵. Rritja e shpejtë e portofolit të huave, në shumicën e bankave tregtare në Shqipëri gjatë periudhës së lulëzimit ishte e shoqëruar, sikundër shprehur më sipër, nga mungesa e ekspertizës dhe e specialistëve të mirëkualifikuar të kredisë, të cilët duhet të ishin të aftë të përzgjidhnin aplikimet më të mira dhe të suksesshme. Hartimi i raporteve të analizës për aplikuesit e huave është një sfidë për specialistët e kredisë, burimi i informacionit të kredisë së përdorur është shpesh i kushtueshëm dhe jo në të njëjtin nivel cilësie. Regjistri i kredisë në Shqipëri filloj operimin vetëm në Janar të vitit 2008, dhe është bërë një mjet shumë i dobishëm për bankat për marrjen e informacionit rreth huave të huamarrësve që nga fillimi e deri në momentin e kërkimit.

Këtë e shohim edhe te Ciuriak (2010), i cili shprehet se:

*“Roli i informacionit dhe menaxhimi i rrezikut për të mbajtur zhvillimin e rrezikut të zgjeruar brënda sistemit financiar duke parandaluar krijimin e situatave të “super ekspozuara”. Sidoqoftë, psikologjia e zgjerimit është e tillë që kredia është e vlefshme në një çmim—në se jo nga bankat dhe ekonomitë e industrializuara, atëherë nga fondet kapitalit në treg ose të tjerët. Duke mbajtur rolin e tregjeve të rregulluara në mbulimin e rrezikut, rregulloret shtyjnë lëvizjen e veprimeve në tregjet e parregulluara. Kjo ndryshon kanalet nëpërmjet të cilave korrupsioni rrjedh por nuk eliminon atë”.*⁵⁶

Si rezultat i krizës ekonomike financiare, bankat tregtare në Shqipëri ngadalësuan shpejtësinë e aktivitetit kreditues, në një kontrast të plotë me periudhën e bumit të kredive, kur portofolet e tyre të kredive u rritën mesatarisht mbi 50% në vit, rritje e cila çon në

⁵⁵ Greenbaum, S, & Thakor, A.v.: “Contwmporary Financial Intërmediation”, Second Ed, Part III Major “On Balance Sheet” Risks in Banking, Chaptër 5. pg 185, 2007.

⁵⁶ Ciuriak, D.: Implementing Better Banking Regulation And Standards -lessons from the past”, March 2001, (revised Feb 2010).

mbulimin e cilësisë reale të portofolit të kredisë. Tipike, gjatë viteve 2009-2014, rritja mesatare e portofolit të total sitemit bankar ishte më pak se 7% në vit, duke prodhuar kështu një nivel mesatar të huave me probleme prej 23%, në fund të vitit 2012, i cili arriti në 24% në fund të 2013 për të pësuar një rënie të lehtë në 2014 me 23%. (shif tabelen 3 në vijim). Pesë bankat nga 9 më aktivet në aktivitetin kreditues gjatë bumit të kreditmit,


Tabela nr 3. Rezultatet finale të Portfolit dhe nivelit të Huave me Probleme për sistemin bankar 2009 vs 2014

Sistemi Bankar	Rritja e Portofolit në përqindje Gjate periudhes 2009-2014	Huatë me Probleme 2014
Total Portofoli i sistemit	28%	23%
Mesatarja e 5 bankave që ulin portofolin	-23%	36%
Mesatarja e 10 bankave që rritin portofolin	85%	18%

Burimi: Banka e Shqipërisë

ulën stokun e portofolit të huave gjatë periudhës së krizës mesatarisht me 23%, banka të cilat rezultuan në një nivel më të lartë të huave me probleme mesatarisht 36% të stokut të Portofolit të huave të sistemit bankar. Ndërsa në 10 bankat të cilat vijuan me kreditimin e ekonomisë dhe rritën portofolin e huave mesatarisht 85% gjatë periudhës 2009-2014, krahasuar me stokun e vitit 2009 në vit, kundrejt 28% të mesatares së sistemit, niveli i huave me probleme është mesatarisht 18% kundrejt 23% që është mesatarja e sistemit gjatë të njëjtës periudhë. Kjo përmbledhje tregon qartë për efektin që ka vijueshmëria e financimit të biznesit në periudhat e mungesës së likuiditetit, pa qënë të sigurtë së çfarë ritmi rritje duhet të ketë një banke, për t'u konsideruar brenda parametrave normale, për të mos prodhuar në vijim hua me probleme më të mëdha, pasi kjo do kërkonte shumë analiza e detaje që lidhen jo vetëm me kapacitet njerëzore, financiare të vetë bankës po edhe të aftësisë rritëse të tregut ku operon. Grafiku në vijim pasqyron më qartë analizën e situatës së kreditimit gjatë periudhës së Krizës financiare. (Shih grafikun nr 4).

Grafiku nr 4. Ndryshimet e Stokut të Portofolit dhe nivelit të Huave me Probleme 2009 v/s 2014



Burimi: Banka e Shqipërisë

Tabela në vijim (shih Tabelen 4), tregon në detaje për cdo bankë tregtare, qasjen kredituese të secilës prej tyre gjatë periudhës së krizës financiare, ku fenomeni i huave me probleme u shfaq dukshëm. Gjendja në vlerë e huave me probleme në fund të vitit 2014, për disa banka edhe pse u ul ndjeshëm kundrejt nivelit të tyre në fundin e vitit 2009, duke i krahasuar me total portofolin e këtyre bankave, niveli i huave me probleme janë shumë më të larta se

Tabela nr 4. Prirja e portofolit të çdo banke në periudhën e krizës globale dhe reflektimi i kësaj prirje te niveli i Huave me Probleme 2009 kundrejt 2014.⁵⁷

No	BANKAT*	Total Portfoli 2014	Total portofoli 2009	Ndryshimi portofolit 2009 kundrejt 2014	Prirja	Huave me Probleme në %
1	Alpha Bank	33,704	45,492	-11,788	-26%	33%
2	Tirana Bank	43,756	59,214	-15,458	-26%	43%
3	Credit Agricole	17,148	27,150	-10,002	-37%	39%
4	NB G	27,200	37,035	-9,835	-27%	36%
5	Intesa Sanpaolo	46,713	49,685	-2,972	-6%	28%
6	Raiffeisen Bank	121,217	93,410	27,807	30%	26%
7	ICB	3,548	2,278	1,270	56%	8%
8	ProCredit Bank	23,652	20,576	3,076	15%	15%
9	Veneto Bank	18,330	3,742	14,588	390%	16%
10	Union Bank	14,783	9,977	4,806	48%	16%
11	Credins Bank	88,104	30,242	57,862	191%	20%
12	Banka Kombëtare Tregtare	104,660	47,356	57,304	121%	11%
13	Societe Generale	40,208	18,211	21,997	121%	10%
14	First Investment Bank	6,504	1,578	4,926	312%	15%
15	Credit Bank of Albania	1,744	266	1,478	556%	67%
16	UBA	na	na	0		0%
I	Total Portofoli	591,270	446,212	145,058	124,447, 427	23%
I/a	Mesatarja e 5 bankave rënëse				23%	36%
I/b	Mesatarja e 10 bankave rritëse				85%	18%

mesatarja e sistemit bankar. Ky fenomen ka ndodhur ne banka te cilat u fokusuan ne mbledhjen e huave me probleme dhe frenuan kreditimin e bizneseve.

⁵⁷ Është marrë për bazë krahasimi gjendja e stokut të portofolit të huave në fund të vitit 2009, si viti që ka kulmuar nivelin e tij më të lartë, si dhe viti që shënoj fillimin e krizës globale financiare.

3.3 Monitorimi i Portofolit të kredive dhe klasifikimi i kredive nga Njësia e Riskut në sistemin bankar Shqiptar

Njësia e Riskut tashmë e konsoliduar në sistemin bankar në rolin e saj të rëndësishëm në aktivitetin kreditues, sidomos pas krizes ekonomike globale, luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në momentin e aprovimit të kredive por edhe gjatë monitorimit të tyre. Për të arritur objektivat e veta në ruajtjen e një protofoli cilësor njësia e riskut duhet të përdorë teknika të shumta në monitorimin e portofolit të huasë, për të minimizuar e ruajtur nivelin e riskut të moskthimit apo për ta përmirësuar atë. Konkretisht këto teknika mund të përmbledhen shkurt në :

1. Diversifikimi i portofolit të kredisë sipas termave që lidhen me
 - a. Llojin e produkteve të kredisë, si kredi biznesi, kredi individuale, kredi hipotekare etj.
 - b. Sipas valutës, në valutë vëndase dhe të huaj
 - c. Sipas sektorëve të industrisë- këtu përfshihen kreditë e biznesit
 - d. Maturitetit të kredisë, afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.
2. Kolaterali, sigurimi i kredive me kolateral të mirë mundëson kontrollin e riskut të kredisë. Kolateral i mirë përfshin garanci të cilat janë të diversifikuara dhe lehtësisht të likuidueshme.
3. Sigurimi i kredisë, është një produkt sigurimi i cili mbron bankat nga borxhet e këqija. Këtu bëhet fjalë për sigurimin e kredisë nga një shoqëri sigurimi, ku kjo e fundit paguan kredinë në se humarrësi dështon në ripagimin e saj. Sigurimi mund të përfshijë edhe jetën e huamarrësit si dhe kolateralin e venë garanci. Respektimi i rregullave të mbikqyrjes bankare dhe procedurave të brendshme të bankës. Dy nga mekanizmat e përdorura nga mbikqyresit për kontrollin e riskut janë:
 - a. Kapitali rregullator, ku përfshihen kategoritë e ndryshme të kapitalit dhe të rezervave, si edhe elementë të tjera të përcaktuara nga mbikqyrësit.
 - b. Mjaftueshmëria e kapitalit, raporti ndërmjet kapitalit rregullator të bankës me shumën e zërave të aktivitetit të bilancit të ponderuara me rrezikun (12% sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë).

4. Securitisation, është një mënyrë për të zhvendosur portofolin e kredive dhe në të njëjtën kohë riskun e kredisë nga bilanci i bankave. Por nga ana tjetër kjo shoqërohet me një sërë problemesh ekonomike siç edhe u reflektua në vitet e fundit në tregjet financiare globale.
5. Organizimi i një sektori përgjegjës për drejtimin e riskut.
6. Raportimet e historikut të ripagesës së kredive (regjistrat e kredive). Duke filluar nga data 03 Janar 2008 në Bankën e Shqipërisë filloj funksionimi i Regjistratit të Kredive. Kjo ka çuar në një kontroll më të mirë të riskut të kredisë nga sistemi bankar duke qënë se janë të mirë informuar në lidhje me detyrimet e tjera të huamarrësve në sistemin bankar, referuar ekzpozimeve në vlerë, sipas monedhave, llojit të kredive, klasifikimit të tyre sipas cilësisë, historikut të kredive ekzistuese dhe të mbyllura etj.

Klasifikimi i kredive në sistemin bankar në Shqipëri sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë dhe dallimi nga klasifikimi i tyre sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, e ashtuquajtur IFRS (International Financial Reporting Standard).

Përparësia që ka klasifikimi i kredive sipas BASEL II, (IFRS), në raport me klasifikimin e kredive sipas standarteve të Bankes së Shqipërisë, lidhen me ndjeshmerinë më të madhe që ky klasifikim paraqet për këto kredi sipas shkallës së rrezikut të tyre. Ndaj klasifikimi sipas Basel II apo IFRS, që njihet rëndom në komunikimet zyrtare mes bankave, jep një vlersim me të saktë të provigjonimit të kredive, duke bërë të mundur që bankat të krijojnë fonde rezervë në kohën e duhur për të zëvendësuar humbjet që vijnë nga moskthimi i këtyre kredive. Dallimin midis dy standardeve, të rregullores së Bankës së Shqipërisë dhe Basel II (IFRS) e bën kryesisht vlerësimi i kolateralit që mbulon këto kredi, i cili është parësor në provigjonimin dhe klasifikimin e kredive sipas IFRS, ndërsa ditët në vonesë janë parësor në klasifikimin e kredive sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë. Kështu pavarësisht ditëve në vonesë në ripagimin e një kredie, klasifikimi dhe provigjonimi i tyre do të bëhet në varësi të vlerës që mbulon këto kredi dhe cilësisë së kolataralit për nga ana e likuiditetit të tyre. Bankat në Shqipëri tashmë janë në periudhën finale të instalimit të standardeve sipas IFRS, ndaj dhe në bilancet e tyre paraqesin dy pasqyra financiare përkatësisht sipas standardeve të IFRS dhe rregullores së Bankës së Shqipërisë. Rezultatet e tyre në shumicën e rasteve janë shumë të ngjashme. Aktualisht kreditë klasifikohen në pesë klasa, sipas

shkalles së rrezikut që ato paraqesin për moskthimin e tyre. Sa më të shumta të jenë klasat në të cilat bëhet klasifikimi dhe vlerësimi i kredive aq më reale është provigjoni i llogaritur, dhe natyrisht kapitali i bankës. Klasifikimi i kredive sipas kriterit të cilësisë së tyre në sistemin bankar në Shqipëri formalisht bazohet në rregulloren e Bankës së Shqipërisë për administrimin e rrezikut të Kredive. Sipas kësaj rregulloreje, kreditë klasifikohen në pesë klasa bazuar në shkallën e plotësimit të kushteve dhe standarteve të përcaktuara sipas politikave të bankës dhe që lidhet me shkallën e mbulimit me kolateral sipas vlerës së përditësuar të tregut, dhe në cilësinë e likuiditetit të kolateralit, shkallën e aftësisë paguese kundrejt detyrimeve ndaj bankës, në afatin e ripagimit të tyre nga data e maturitetit etj. Pesë klasat e kredive në vetevete përfaqsojnë dy nën grupe kryesore, kreditë cilësore dhe kredi me probleme, ku në kreditë cilësore përfshihen: klasa 1 dhe 2, në të cilat përfshihen ato kredi që plotësojnë në mënyrë cilësore dhe sasiore kushtet dhe standartet e përcaktuara nga banka, ndërsa klasat 3, 4 dhe klasa 5 përfaqsojnë huatë me probleme, për të cilat banka llogarit fonde rezervë të përshtatshme me shkallën e rrezikut që paraqesin nga 20% deri në 100% të tepricës së tyre. Fondet rezervë të llogaritura për huatë me probleme konsiderohen fonde rezervë për mbulimin e rrezikut të zhvlerësimit të huave. Për klasifikimin e huave sipas kategorive të mësipërme, banka analizon sipas përparësisë dhe në mënyrë plotësuese gjithë situatën e klientëve sipas nivelit të plotësimit të çdo standarti. Analiza dhe vlerësimi nga bankat në vetvetë i çdo kredie për të arritur klasifikimin e portofolit sipas klasave ndodh të jetë edhe çështje subjektivizmi e interpretimi, duke realizuar një klasifikim jo real të kredive, për shkak të pamundësisë që vetë bankat kanë në krijimin e fondeve rezervë në kohë krize likuiditeti. Për të lehtësuar barrën e provigjonit që krijojnë bankat në kushtet e një niveli të lartë të huave me probleme, ndërkohë që biznesi përjeton mungesë likuiditeti të theksuar, BSh në Tetor 2013 nxori udhëzuesin për ristrukturimin e kredive individuale dhe të biznesit, i cili i lejonte bankave tregtare që të klasifikonin keto kredi dhe të llogaritnin një provigjon me të ulët mbi tepricën e këtyre kredive. Kjo rregullore e re edhe pse lehtësoj sistemin e kreditimit në vend, duke lejuar më shumë hapësira bankave për të kredituar binzeset të reja dhe me potenciale të mira të rikthimit të kredisë, nga ana tjetër krijoj hapësira për një riskklasifikim jo real të kredive me probleme, të cilat e dhanë efektin e tyre në vijimësi duke mos paguar sipas planit të ri të

riskedulimit të tyre. Vetë bankat tregtare në vend janë përpjekur të jenë fleksibel në negocijim me huatë me probleme duke ju falur jo vetëm interesat e akumuluar por edhe pjesërisht kryegjë, gjë e cila ka bërë të mundur që shumë biznese të mund të krijojnë likuiditet të mjaftueshëm për të lehtësuar barrën e rëndë të borxhit, nëpërmjet shitjes së aseteve nën vlerën e tregut. Të dyja këto iniciativa, rregullorja e re e BSH në Tetor 2013 dhe qasja e përmirësuar që vetë bankat patën ndaj kredive me probleme, përpos anës pozitive që hapi rrugë krijimit të një likuiditeti më të madh në treg, ka lënë vend e hapësirë që klientë të caktuar të përfitojnë nga situata duke mos ju përgjigjur detyrimeve ndaj bankes, në kushtet e përfitimit të këtyre lehtësive.

KAPITULLI IV – NDIKIMI I TREGUESVE MAKROEKONOMIKË NË NIVELIN E LARTË TË HUAVE ME PROBLEME NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

4.1 Hyrje

Në këtë kapitull analizohet ndikimi që kanë patur treguesit makroekonomikë në nivelin e lartë të huave me probleme në sistemin bankar. Analiza e këtyre treguesve makroekonomikë shtrohet për të vlerësuar e marrë në konsiderate faktin se pavarësisht cilësisë së menaxhimit nga vetë bankat, ambjenti ekonomik ka ndikimin e vetë në ecurinë e portofolit të huave dhe nivelin e huave me probleme në veçanti. Metodologjia e përdorur për këtë analizë është ajo statistikore, dhe krahasuese.

Analizimi i këtyre faktorëve / treguesve në këtë kapitull bazohet kryesisht në të dhënat statistikore historike të marra nga faqet zyrtare të institucioneve vendase e ndërkombëtare si INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Banka Botërore etj. Konkretisht në treguesit makroekonomik të tregut vendas dhe atij ndërkombëtar, të cilët u vlerësuan si të rëndësishëm në ndikimin në nivelin e lartë të huave me probleme janë marrë: Prirja rënëse e remitancave si një ndikim direkt i krizës financiare dhe ashpërsimit të saj në vendet ku shumica e emigrantëve shqiptar jetojnë e punojnë, risku politik dhe ndikimi i tij në ekonomi, niveli i papunësisë, niveli i PBB dhe prirjen rënëse të saj shkaktuar nga rënia ekonomike e bizneseve që lidhen me sektorët specifikë të vendit si ndërtimi dhe tregtia, rënia e eksporteve, rritjen e borxhit të qeverisë ndaj bizneseve për ndërtimin e veprave publike etj.

Duke supozuar se ndikimi i treguesve makroekonomikë kanë ndikimin e vetë të rëndësishëm në nivelin e lartë të huave me probleme, këto faktorë do të identifikohen, maten dhe analizohen, duke marrë të mireqënë faktin se njohja e këtyre faktorëve / variablave do të ndihmojë menaxherët e lartë të bankave për të hartuar strategji zhvillimi

dhe praktika e rregullore të aktivitetit kreditues që minimizojnë rrezikun e kredisë të portofolit të tyre, gjithmonë duke vlerësuar e marrë në konsideratë prirjet e tyre në kohë. Thellimi i krizës ekonomike në rajon dhe në botë ka sjellë pasojat e veta edhe në ekonominë shqiptare duke krijuar një situatë të tillë ku rrugëdalja bëhet e vështirë dhe me kosto për të gjithë ekonominë. Huatë me probleme në sektorin bankar në Shqipëri po bëhen gjithnjë e më shumë një çështje kryesore me të cilat përballen bankat, veçanërisht pas fillimit të krizës financiare e globale të 2008-ës. Efektet e krizës, të ndërthurura me faktorë të tjerë specifike të strukturës ekonomike të Shqipërisë, mund të konsiderohen si shkaqet kryesore të rritjes së huave me probleme. Ky kapitull nëpërmjet analizës së të dhënave historike, identifikon shkaqet më specifike në nivel makro të shkaktuara nga kriza financiare globale dhe lokale, duke marrë në konsideratë disa nga treguesit kryesore makroekonomik si dhe prirjet e tyre në kohë në nivelin e huave me probleme. Tregues të tillë mund të përmendim:

- Treguesi i PBB -së dhe Prirja në rënie e tij në 4-5 vitet e fundit,
- Treguesi i nivelit të hyrjeve nga Remitancat dhe prirja rënëse e dërgesave të emigrantëve,
- Niveli i borxhit total dhe prirja rritëse e borxhit të jashtëm ndaj atij të brendshëm të vendit
- Niveli i borxhit të brendshëm të qeverisë dhe prirja rritëse e tij si pasojë e mospagimit të Faturave për punët publike nga qeveria qendrore dhe ajo lokale ndaj biznesit,
- Shkalla e vlerësimit të rrezikut politik në ekonomi për Shqipërinë
- Niveli i IHD –ve dhe prirja rënëse e tyre në vend

Përkeqsimi i këtyre treguesve të sipërpërmendur në kohë kanë qënë të shoqëruara me nivelin e lartë të huave me probleme dhe frenimin e kreditimit të ekonomisë nga ana e bankave, e për më tepër situata rëndohet kur kjo shoqërohet dhe nga një administrim jo adekuat i portofolit të huave nga vetë bankat të cilat kanë patur përqsasje të ndryshme në krediedhëniet ndaj biznesit përpara dhe gjatë periudhës së krizës financiare globale.

Prirja rritëse e huave me probleme në sistemin bankar shqiptar po çon në rritjen e humbjeve të bankave, që vjen nga provigjoni që kërkojnë këto hua me probleme, uljen e kapitalit rregullator, duke shkaktuar rënien e aftësisë për huadhënie e financim në vijim të ekonomisë. Kështu, arrihet në përfundimin se situata aktuale e huadhënies po kalon në një rreth vicioz, dalja nga e cila bëhet e vështirë. Pra në tërësinë e vetë ky kapitull trajton ndikimin në nivelin e huave me probleme të faktorëve makroekonomike të vendit.

Situata e zgjidhjes së huave me probleme bëhet edhe më e vështirë me ndërthurjen e specifikës së veçantë të sistemit bankar shqiptar dhe që është përjetimi i gjithë cikleve të biznesit brënda një afati mjaft të shkurtër kohe. Në vetëm 10 deri 15 vjetë experience të aktivitetit të tyre në sistemin e ekonomisë së lire të tregut, bankat tregtare përjetuan fazën e krijimit dhe instalimit, që zgjati deri në vitin 2003-2004, fazën e lulëzimit të tyre që përkoi me një bum hyrjesh *cash*-i nga burime jashtë ekonomisë vëndit për 5 vjet të tjerë 2003-2008 dhe nga 2009, e deri më sot, i cili është bashkëkohës i një prej krizave më të mëdha botërore e lokale, që pashmangshmërisht ka ndikim në aktivitetin e tij. Gjithë këto cikle ekonomike kaq të shkurtra e shumë të ndryshme nga njëri tjetri i kanë dhënë shumë informacion bankiereve dhe kanë bërë të mundur marrjen e mësimave të duhura, kur bëhet fjalë veçanërisht për huadhënien, rreziqet që shoqërojnë këtë proces huadhënie dhe vënien në zbatim të shumë praktikave moderne, në të përditshmen e tyre. Tregu shqiptar, si pjesë e tregut global, po vuan pasojat e krizës financiare globale dhe asaj shqiptare, që ka filluar nga viti 2008, e cila po tregon përmirësime ekonomike globale apo lokale në nivele ende të pamjaftueshme. Sistemi bankar shqiptar si një pjesë integrale e tërë ekonomisë shqiptare po përballet me pasojat e kësaj krize financiare, që në eksperiencën e tij të shkurtër për më pak se 15 vjet, po përjeton vështirësi të mëdha që çenojnë madje dhe stabilitetin financiar të vendit.

Eksperienca relativisht e shkurtër e sistemit bankar, e shoqëruar me një huadhënie dhe një qasje ndaj biznesit cilësisht të dobët, konkurrenca e ashpër midis bankave për të fituar pjesë tregu në fazën e lulëzimit të ekonomisë shqiptare nga njëra anë dhe kriza financiare globale dhe një tranzicion i gjatë i ekonomisë së tregut, nga ana tjetër, po ndikojnë në shtrydhjen e likuiditetit të biznesit si dhe në uljen e aftësisë pagueuse të tij. Ekonomia Shqiptare tashmë

po përjeton një fazë të gjatë tranzicioni drejt ekonomisë së tregut, duke pasqyruar një sistem financiar të pabalancuar.

4.2 Analiza e Faktorëve makroekonomike si ndërthurje e faktorëve globale me ato specifike shqiptarë dhe ndikimi i tyre në rritjen e huave me probleme.

Faktorët makroekonomike konsiderohen si kryesor në ndikimin që ato sjellin në cilësinë e protofolit të kredive në sistemin financiar, një vlersim të cilin e gjejmë jo rrallë në literaturën botërore. Bankat duhet të kenë në vëmendje të përhershme ndryshimet që ndodhin në treguesit makroekonomik, dhe ti lidhin ato me faktorët sistematik në menaxhimin e rrezikut të protofolit.

Koopman&Lucas, (2003), referuar lidhjes se kushteve makroekonomike me rrezikun e kredisë, theksojnë se:

“Në qoftë se një bankë vendos lidhje midis kushteve makroekonomike dhe faktorëve të riskut sistematik të kredisë, kjo njohje mund të ndihmojë në vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut të protofolit të kredisë gjithë kohën dhe mund të provojë dobiri në dinamikën e kushteve të menaxhimit të rrezikut të kredisë në të cilën mund të ndodhin skenarët e moskthimit të kredive nga një ndryshim i kushteve ekonomike⁵⁸. (Koopman&Lucas, (2003:17),

Ndryshimet e mëdha të kushteve makroekonomike të mjedisit ekonomik të një vendi janë parë të reflektohen në ciklet e biznesit. Kushtet makroekonomike për të cilat mendohet se kanë ndikim më të madh në mungesën e likuiditeti në vend dhe për pasojë rritjen e nivelit të huave me probleme perceptohen nëpërmjet disa treguesve, të tillë si të ardhurat kombëtare, apo niveli i PBB, remitancat, Rreziku politik në ekonomi, shkalla e punësimit etj. Gjithashtu ciklet e biznesit vendas ndikohen nga ciklet e jashtme ekonomike, sic është kriza globale që po përjeton bota në 4-5 vitet e fundit. Disa kërkues si (Yeyati, et al., 2010; Diaz, Mileris etj) kanë gjetur lidhjen midis faktorëve makroekonomik dhe huave me probleme në sistemin bankar. Niveli i huave me probleme bashkëvepron ndryshimet

⁵⁸ Koopman Siem Jan, Lucas Andre “Business and Default Cycles for Credit Risk, sept 2003, pg 17.

makroekonomike duke ndikuar që bankat me nivele të larta të huave me probleme të ndikohen shume nga goditjet makroekonomike.

Ekziston një numër i madh treguesish dhe faktorësh të jashtëm, të cilët ndikojnë dhe kontribuojnë në rritjen e shpejtë të huave me probleme, brënda sistemit bankar shqiptar. Të dhënat e përgjithshme historiko ekonomike, të publikuara kryesisht nga Instituti i Statistikave japin një tablo gjithëpërfshirëse të periudhës së gjithë dekadës së fundit, si për periudhën para krizës, midis vitit 2003 deri në vitin 2008, ndërkohë që ekonomia shqiptare përjetonte fazën e lulëzimit të saj, ashtu dhe gjatë periudhës së krizës financiare, pas vitit 2009, duke kulmuar në vitin 2012, dhe që ende vijon aktualisht. Rënia e vazhdueshme e dërgesave të emigrantëve, rënia e ritmeve të rritjes së PBB-së, pagesat e vonuara të qeverisë dhe paaftësia për të paguar faturat ndaj biznesit për punët publike, problemet e likuiditetit në sektorin e ndërtimit të ekonomisë shqiptare, si dhe kriza ekonomike globale në tërësi po ndikojnë ndjeshëm për rritjen e shpejtë të huave me probleme, me një ritëm të tillë ku aktualisht Huatë me Probleme po shkojnë drejt nivelit 30 për qind të total portofolit të huave në sistemin bankar. Në këtë kontekst këta faktorë janë trajtuar në vijim të këtij kapitulli.

4.2.1. Ndikimi i krizes botërore në uljen e remitancave pasojë e nivelit të lartë të huave me probleme

Shqipëria njihet si vendi që ka shënuar nivelin më të lartë të emigracionit pas viteve 90'të, krahasuar me vendet fqinjë, sipas statistikave zyrtare rreth 30% e shqiptarëve kanë emigruar në vendet europiane, kryesisht në Greqi dhe Itali, vende të cilat në këto 4-5 vitet e fundit kanë përjetuar me ashpër krizën aktuale globale.

Në Shqipëri dërgesat e emigrantëve kanë qënë një burim i rëndësishëm i hyrjes së fondeve, kryesisht në monedhë të huaj në ekonomi, madje më shumë se sa sistemi bankar në tërësi, por vërshimi i këtyre fondeve në vend nuk solli të njëjtën dinamikë zhvillimi ekonomik sa vetë dinamika e hyrjes së cashit nga remitancat.

Integrimi financiar në Europë sipas Abiad (2008) ka rritur lëvizjen e kapitalit duke mbledhur fuqinë nga vendet e pasura në ato të varfëra. Për më tepër këto hyrje parash kanë qënë shoqëruar me grumbullime të ardhurash me një shpejtësi të dallueshme. Për

arësye të thella gjeografike dhe historike vende dhe rajone të ndryshme patën dinamika rritje të ndryshme, dhe nga kërkimi që bëmë gjetëm se vendet me një farë cilësie institucionale dhe integrim financiar kanë tendencën të përjetojnë një rënie më të fortë kapitali.⁵⁹

Nga viti 2003 deri 2009, prirja rritëse e këtyre dërgesave ishte shumë mbresëlënëse, duke krijuar një situatë të balancuar financiare në ekonominë shqiptare ndërsa prirja e raportit të huave me probleme ndaj totalit të protofolit të huave gjatë të njëjtës periudhë shkojnë në kahe të kundërt. Është mëse e qartë që thellimi i krizës në vëndet fqinjë bëri që emigrantët shqiptarë të sjellin gjithnjë e më pak para, duke filluar nga viti 2009 deri më sot, (shihni tabelën nr. 5 dhe Grafikun nr 5).


Tabela nr 5 . Fluksi hyrës i dërgesave të emigrantëve dhe prirjet e huave me probleme nga viti 2003 deri në 2014 (në mild lek)

Periudha	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Remitancat	88	116	128	135	146	149	132	116	89	77	75	90
Prirja e remitancave në %	0%	31%	11%	5%	8%	2%	12%	12%	23%	13%	23%	21%
Huatë me probleme në mild leke	2,4	2,4	3,4	5	10	23	48	68	107	217	132	135
Huatë me probleme në % mbi total protofolin	5%	4%	3%	3%	4%	6%	11%	14%	19%	23%	24%	23%

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

⁵⁹ Abiad, A., Leigh Daniel, & Mody Ashoka “Financial Integration, Capital Moobility, and Income Convergence” September 2008, Pg.7-8.

Grafiku nr 5. Fluksi hyrës i dërgesave të emigrantëve dhe prirjet e huave me probleme nga viti 2003 deri në 2014 (në miliard lek)



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Kjo prirje rënëse është frenuar, dhe gjatë 2014 ka filluar të ketë një prirje pozitive në raport me 3 vitet e ashpërsimit të krizeë globale financiare, (2011-2013) në vendet e rajonit, Greqi e Itali, ku shumica e emigrantëve Shqiptar punojnë e jetojnë. Vihet re se pikërisht në këtë vit (2014), PBB –të për frymë të këtyre vendeve, sipas BB⁶⁰ kanë pësuar një prirje relativisht pozitive, prirje e cila është pasqyruar direkt në hyrjet e remitancave në vend, duke na treguar lidhjen e fortë mes këtyre variablave. (shih Tabela nr. 6 e grafiku nr 6 ne vijim).


Tabela nr. 6. PBB-të për frymë në vendet me flukse më të mëdha hyrese të remitancave

Vendi	2011	2012	2013	2014
Itali	38,364	34,854	35,477	34,960
Greqi	25,962	22,494	21,966	21,682

Burimi: Banka Botërore

⁶⁰ data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD

Grafiku nr 6. Prirja e PBB për frymë në vendet me flukse më të mëdha hyrëse të remitancave



Burimi: Banka Boterore

Bazuar në sa më sipër është lehtësisht e dallueshme se sa e menjëhershme është reflektimi i situatës ekonomike të vendeve hyrëse të remitancave me prirjen e volumit hyrës të tyre në vendin tonë dhe në të njëjtën dinamikë.

4.2.2. Analiza e faktorit të prirjes rënëse të PBB dhe ndikimi i tij në nivelin e huave me probleme

Ngjashëm për huatë bankare, standartet e kredive janë të lidhura me rritjen e PBB-së. Në kushtet kur dhënia e kredive varet nga huadhënësit, standartet janë mekanizmat që përdoren për të përcaktuar tenndecën e huadhënies.

Këtë e shohim të theksuar edhe nga Cappiello (2010), i cili shprehet se:

Në qoftë se, standartet e kredisë shtrëngohen, kjo do të gjenerojë një rënie në nivelin bazë të kredive që financojnë aktivitetet e kompanive dhe konsumatorëve dhe që përfundimisht një kontraktim të PBB-së. Në të njëjtën kohë analistët e kredisë

ndryshojnë standartet e tyre të kredisë sipas pritshmërive që kanë për rritjen reale të PBB-së⁶¹.

Të dhënat statistikore reflektojnë rënie të kreditimit të biznesit gjatë të njëjtës periudhë kur tendenca e PBB-së është në rënie. Megjithë tkurrjen e kreditimit të biznesit gjatë peirudhës së krizes financiare botërore, Bankat tregtare Shqiptare në krahasim me vendet e rajonit kanë mbajtur një nivel kreditimi më të lartë, Raporti vjetor i Bankes së Shqipërisë (2011) e shpreh qartë diferencën e prirjes kredituese të Shqipërisë kundrejt vendeve të tjera të rajonit: “ Në krahasim me vendet fqinjë të EQJ -së, Shqipëria është ndër vendet me rritjen më të lartë të kredisë për sektorin privat gjatë periudhes 2007 -2011, sipas BSH (2011) dhe ky rezultat i dedikohet rritjes ekonomike si një shpjegues kryesor⁶² . Kjo qasje e bankave tregtare shqiptare ndaj kreditimit të biznesit gjatë kësaj periudhe vlerësohet të ketë qënë një ndër elementet që ka amortizuar ashpërsimin e kushteve të likuiditetit në ekonomi. Ndërsa rritja e PBB-së para krizës financiare, me një mesatare prej 6% në vit, i është dedikuar kryesisht zhvillimit eksploziv të sektorit të ndërtimit. Gjatë krizës financiare prirja rritëse e PBB-së ka rënë në mënyrë të konsiderueshme nga 3% në madje 1%, gjatë vitit 2012 (sipas FMN-së), kohë në të cilën janë marrë të dhënat krahasuese, ndërsa ka vijuar rënia e PBB deri në vitin 2013 me 0,5%. Huatë me probleme në sistemin bankar janë një kopje e anasjelltë e plotë e prirjes rënëse të PBB-së, siç mund të evidentohet gjatë gjithë periudhës së kohës marë në analizë (shih Tabelën nr. 6 dhe Grafikun nr. 6).

⁶¹ Lorenzo Cappiello 1, Arjan Kadareja 2, Christoffer Kok Sørensen 3, and Marco Protopapa 4, “Do bank loans and Credit standards have An effect on output? A panel approach For the euro area”, Working paper series No 1150 / January 2010. Pg 13. SSRN WEB


⁶² BSH Raporti vjetor 2011, Faktoret percaktues te ecurise se kredise per sektorin privat ne vendet e EQJ, fq 88,

Tabela nr 6. Prirja historike e nivelit të PBB dhe Huave me Probleme në Shqipëri gjatë 2003-20014.

Periodha	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
PBB në perqindje për Shqipërinë	5.7	5.9	5.5	5.0	5.9	7.5	3.4	3.7	2.5	1.6	1.4	1.9
Huate me Probleme ndaj totalit të huave në perqindje	5%	4%	3%	3%	4%	6%	11%	14%	19%	20%	23,4%	22,7%
Prirja historike e Huave me probleme në vetvete	0%	1%	39%	53%	101%	118%	113%	43%	57%	102%	-	1.8%

Burimi: Banka Boterore, Banka e Shqipërisë, Raportët vjetore të bankave tregtare.

Grafiku nr 6. PBB-ja dhe prirja e Huave me Probleme nga viti 2003 deri në 2014 (në %)



Burimi: Banka Boterore, Banka e Shqipërisë, Raportët vjetore të bankave tregtare.

Gjatë kësaj periudhe, burimi kryesor i fondeve likuide në treg, më shumë se sistemi bankar, ishin dërgesat e emigrantëve.

Tregu shqiptar ende nuk është i diversifikuar në sektorë të ndryshëm prodhimi e shërbimi, në keto kushte sektori i ndertimit si me prioritar në rritjen ekonomike, për shkak të përqendrimit të lartë të ekonomisë vetëm në këtë sektor ka krijuar kështu teprica të dukshme të mjediseve dhe hapësirave të lira ndërtimore që nuk shiten, e që krijojnë një

problem serioz likuiditeti në mbarë ekonominë. Prirja e PBB-së është e lidhur ngushtësisht me prirjen e dërgesave të emigrantëve gjatë gjithë kësaj periudhe. Ajo që dallohet në këtë kontekst është që, përpara krizës prirja e ritmit të rritjes së këtyre dërgesave ishte më e lartë se ajo e PBB-së, çka dëshmon se këto hyrje parash janë përdorur për konsum dhe nuk kanë shkuar në investime drejt aktiviteteve prodhuese, të cilat do të çonin në rritjen e të ardhurave të vazhdueshme në treg dhe që të kontribuonin në një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Gjatë periudhës së thellimit të mëtejshëm të krizës financiare botërore dërgesat e emigrantëve fillojnë dhe bien ndjeshëm, ndërsa ritmi i rritjes së PBB-së bie në mënyrë të moderuar deri në 1 përqind ndërsa huatë me probleme që shoqërojnë këtë tendencë, kapërcejne nivelin e tyre historik në 2009 për të vijuar me rritje të mëtejshme deri aktualisht. Për të kuptuar këtë prirje në se efekti i rritjes së huave me probleme janë vetëm faktorët makroekonomik apo edhe faktorë që kanë të bëjnë me cilësinë e huadhënies të vetë bankave, krahasuar huatë me probleme në vlerë nga njëri vit në tjetrin pa marrë për bazë vlerën e portofolit të huave në total, dhe ku vihet re se huat me probleme filluan të rriten nga viti 2005, duke arritur kulmin në vitin 2008, sic mund të vihet re në tabelen nr. 7 më poshtë. Duhet theksuar se është e rëndësishme që të dhënat historike të interpretohen me kujdes, pasi kjo mund të sjellë manipulime të ecuresë financiare ekonomike në vënd. Në këtë logjikë, këtu janë konsideruar të dyja prirjet e huave me probleme, krahasuar si me stokun e portofolit total të huave, ashtu dhe me vetë vlerën e huave me probleme nga njëri vit në tjetrin.

Tabela nr 7. Huatë me Probleme në vlerë dhe përqindje për sistemin bankar, gjatë bumit të kreditimit dhe krizës globale.

Periudha	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Hua me Probleme historike	2,410	2,435	3,378	5,175	10,394	22,658	48,149	68,721	107,581	217,581	132,989	135,386
ndryshim i në % i Huave me Probleme	5%	4%	3%	3%	4%	6%	11%	14%	19%	20%	23.4%	22.7%

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në këtë kapitull analiza fokusohet në efektin që kanë faktoret makro në ecurinë e HP, ndaj për të verifikuar dhe analizuar në terma të matshëm varesinë që ka variabli i PBB ndaj nivelit të huave me probleme

4.2.3. Rreziku Politik i ekonomisë, dhe ndikimi i tij në ecurinë financiare të biznesit

Në nivel makro, Shqipëria konsiderohet si një vënd me rrezik të lartë, kështu që rreziku i kredisë si një element i rëndësishëm që influencohet nga rreziku politik është në një nivel të lartë dhe kjo është bërë e evidente kryesisht gjatë gjithë periudhës së tranzicionit ekonomik e politik të vendit.

Në botë për matjen e rrezikut Politik të Ekonomisë, përdoret treguesi i Pasigurisë politiko ekonomike, *EPU indeks*, (Economic Policy Uncertainty Index) i cili mund të shkaktohet dhe rritet me fillimin e recensionit si ajo që po përjetojmë që prej 2008-2009, pasi pasiguritë e bizneseve dhe qytetarëve kundrejt qeverisjeve të reja, rreth taksimit në të ardhmen, shpenzimeve, rregulloreve, kujdesi ndaj shëndetit dhe politikat monetare janë të mëdha. Së dyti, kjo rritje në pasiguritë politike ngadalëson recuperimin e ekonomisë nga recensionin duke bërë që bizneset dhe konsumatorët të shtojnë në kohë investimet, punësimin dhe shpenzimet për konsum.

Sikundër më sipër në mund të vlerësojmë treguesin EPU në Shqipëri, duke sjellë në mëndje rezultatet e studimeve ndërkombëtare rreth këtij treguesi, që bazohet në ngjarjet ekonomike dhe politike, të cilat kanë influencuar në rritjen ekonomike ose zgjatjen e recuperimit ekonomik. Mund të përmenden ngjarjet e fundit politike të vitit 2013, lidhur me politikat ekonomike të qeverisë së re shqiptare rreth hartës elektorale lokale, amendimit të ligjit të taksimit, reformat qeveritare referuar strategjisë së turizmit, të cilat influencojnë negativisht performancën financiare të biznesit, të cilët kanë investuar në bregdetin Shqiptar dhe këto ndryshime ndalojnë apo ngadalësojnë investimet e reja në këtë sektor ekonomik, dhe që ka të bëjë në mënyrë të veçantë me pasiguritë që lidhen me hartat gjeografike dhe planet e qeverisë të rregullimit territorial.

Rezultatet e përmendura më sipër të këtyre ngjarjeve politike mund të maten nga tendenca e PBB, niveli i papunësisë, rënia e tendecës së investimeve etj. Niveli i PBB për 2013 preku nivelin me të ulët gjatë krizës ekonomike në nivelin e 1%. Niveli i papunësisë u rrit në fund të vitit 2013 në kuotën 16,9%, investimet në Shqipëri ranë 30% gjatë 2013 krahasuar me 2012.⁶³ Natyrisht, sapo pasiguritë bien poshtë, kompanitë fillojnë të punësojnë dhe investojnë përsëri duke ju adresuar kërkesës në treg të pashprehur / padukshme. E njëjta gje ka ndodhur në Shqipëri ku viti 2014 shënoj një rritje PBB me 1,89% kundrejt 0,9% që ishte në 2013. Ekonomia shqiptare reflekton në mënyrë të menjëhershme të tilla politika, për shkak se është një ekonomi e vogël dhe e pastabilizuar, duke dhënë goditje ndaj biznesit dhe rënie të ekonomisë në tërësi.

4.2.4. Niveli i ulet i IHD dhe ndikimi i tërthortë në cilësinë e portofolit të huave

Niveli i IHD dhe ndikimi i tij në ekonomi dhe për pasojë në nivelin e huave me probleme është një tjetër tregues që marrim në konsideratë në këtë studim.

IHD në një vend janë të lidhura ngushtë me vlersimin e rrezikut Sovran, ndaj Shqipëria si një vend me rrezik të lartë sipas vlersimit të agjensive ndërkombëtare, ka patur historikisht një nivel modest të investimeve të huaja në vend.

Të dhënat statistikore të nivelit të IHD për Shqipërinë me shpërthimin e krizes financiare globale dhe mbas saj mund të jetë një provë apo evidence e shqetësimit nga investitorë ndërkombëtare rreth Rrezikut Sovran. Niveli i IHD për Shqipërinë konsiderohet në nivele modeste krahasuar me vendet e rajonit dhe gjatë katër viteve të fundit, statistikatat treguan një përmirësim. Qeveria u sforcua të bëjë privatizimin e disa hidrocentraleve gjatë 2013 me qëllim që të siguronte fondet e nevojshme për të paguar detyrimet e saj ndaj të tretëve, ky moment ka influencuar në rritjen e nivelit të IHD për këtë vit (shih tabelen nr. 10 dhe Grafikon nr. 8 në vijim).

⁶³ Sipas INSTAT (Instituti i Statistikave) (2013)


Tabela nr 10. IHD kumulative për Shqipërinë gjatë periudhës 2003 deri 2014

(Në miliard euro)

Albania	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
FDI	1,829	1,829	1,829	1,829	1,829	2,061	2,261	2,435	3,399	3,261	2,854	2,516

Burimi: Ministria e Financave

Grafiku nr 8. Prirja rënëse e IHD për Shqipërinë gjatë 2003 deri 2014 në miliard Euro



Burimi: Ministria e Financave

Vendi ynë konsiderohet një vend me rrezik të lartë investimi, për shkak të tranzicionit të gjatë ekonomik të vendit po edhe të vlerësimeve ndërkombëtare të cilat e konsiderojnë Shqipërinë si një vend që nuk favorizon klimën e fitorshme ndaj biznesit. Shqipëria realisht nuk është një nga vendet me mundësinë më të lartë të moskthimit të borxhit, edhe pse të dhënat e saj të borxhit në 2012 kundrejt 2011, janë përkeqësuar, kështu PBB në përqindje ndaj borxhit për 2012 është 61,6% kundrejt 58,9% për 2011. Bilanci i llogarisë korente është pothuaj i njëjtë për të dy vitet kumulative -1,374 kundrejt -1,356 për 2011. Vlerësimi i Rrezikut Sovran sipas matjes së Standard and Poor's është B+, (marë nga [www. One world nations on line.org](http://www.OneWorldNations.org) August 2012),⁶⁴ e megjithatë shifrat tregojnë se niveli i IHD – ve dhe treguesit e tjerë makroekonomik nuk janë inkurajues.

4.4. Rrethi vicioz i ekonomisë ndikuar nga ndërthurja e variablave makroekonomike dhe qasja e bankave shqiptare në huadhënien ndaj biznesit

Për sa i përket faktorëve që ndikojnë në aktivitetin kreditues të bankave tregtare duhet theksuar së, prirja e ritmit të rritjes së huadhënies gjatë periudhës para krizës, mund të

⁶⁴ [www. One world nations on line.org](http://www.OneWorldNations.org), Country Risk Analysis “List of Sovereign Debt and credit rating of countries” data from 1st August 2012


përshkruhej nga një eufori e krijuar nga faktoret makroekonomike të përmendur me sipër si dhe konkurrencës midis bankave tregtare, e cila solli krijimin dora-dorës të një portofoli me cilësi të dobët, të shkaktuar kryesisht nga: financimi i projekteve me rrezik; financimi i sipërmarrësve me ecuri të dobët; përqëndrimi i huadhënies në sektorët e ndërtimit dhe pasurive të paluajtshme. Përfundimi që nxirret nga analiza është që prirja rritëse e huave me probleme nga viti 2005, tregon qartë ndikimin edhe të faktorëve të tjerë, përveç atyre që lidhen drejtpërsëdrejti me krizën globale ekonomiko-financiare, të cilët po ndikojnë dukshëm në përkëqësimin e aktivitetit operacional të sistemit bankar në vetvetë (shihni tabelën nr. 15 dhe grafikun nr. 13).

Tabela nr 15. Remitancat, PBB-ja dhe prirja e huave me probleme nga 2003 deri në 2014.

Periudha	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Remitancat mld eur	89	120	129	136	147	150	132	116	89	77.2	75	90
Prirja e remitancave %	0%	31%	11%	5%	8%	2%	12%	12%	23,3 %	13%	-3%	20%
PBB në % për Shqipërinë	5.7	5.9	5.5	5	5.9	7.5	3.4	3.7	2.5	1.6	1.4	1.9
Huatë me probleme historik, (në ml lekë)	2,410	2,435	3,378	5,175	10,394	22,658	48,149	68,721	107,581	217,581	132,988	135,835
Pesha e huave me probl kundrejt nivelit aktual '14	2%	2%	2%	4%	8%	17%	35%	51%	79%	160 %	98%	100 %

Burimi: Banka Botërore, INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Grafiku nr 13. Prirjet e dërgesave të emigrantëve dhe PBB-së kundrejt prirjes së Huave me Probleme gjate 2003-2014



Burimi: Banka Boterore, INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Duke mare në konsiderat, efektet që kriza globale ekonomike e financiare prodhoi dhe shënoi në ekonominë shqiptare dhe në veprimtarinë e biznesit shqiptar mund të përmbledhet në dy pika:

- (1) rritje e përgjithshme e portofolit të huave me probleme dhe
- (2) shtrëngimi i kushteve për huadhënie për të gjithë klientët, nga sistemi bankar, sikundër theksohet dhe nga Meka (2011)⁶⁵.

Për shkak të efekteve të krizes globale, Bankat reagueshan duke ngadalësuar huadhënien dhe raporti i huave ndaj depozitave u zvogëlua nga 65 përqind në vitin 2009, në 58 përqind në vitin 2010. Kështu, prirja rënëse e financimit të ekonomisë nga i gjithë sistemi bankar, krijimi i një portofoli huash i padiversifikuar mirë, konkurrenca e ashpër mes bankave, gjatë periudhës para fillimit të krizës, mund të renditen si faktorët kryesorë ndikues në prirjen rritëse të huave me probleme në sistemin bankar shqiptar. Gjithashtu, gjatë dhe pas periudhës së krizës, huadhënia është në rënie sepse:

- bankat tregtare financojnë më pak veprimtarinë ekonomike,
- bankat ngarkojnë norma interesi disi më të larta, për arsye të rritjes së rreziqëve në ekonomi,
- kërkohet vlerë më e lartë kolaterali.

⁶⁵ Meka, E.: “Corporate Bonds - A New Way for Financing Corporate in Albania”, ECONOMICUS, No.7, UET/PRESS, Fall 2011, p.32.

Huadhënia ndaj biznesit, veçanërisht gjatë periudhës 2005 - 2008, njohu ritmet më të larta të saj, gjatë gjithë historikut të sistemit bankar tregtar në Shqipëri. Gjatë kësaj periudhe, huadhënia nga sistemi bankar nuk shërbeu vetëm për të lehtësuar likuiditetin në treg, por gjithashtu ka mbuluar dhe problemet e vërteta të rritjes së huave me probleme. Këto ritme të pazakonta huadhënieje normalisht janë shoqëruar me një stok portofoli të huave me cilësi të dobët, fakt ky që verifikohet lehtësisht dhe me rritjen galopante të huave me probleme, sapo ritmi i huadhënies ulet në nivele normale.

Duket se shkalla dhe ritmi i rritjes së huave me probleme nuk përbën shqetësim apo nuk tërheq vëmendje, për sa kohë që krijohet në vijim një bazë e madhe e stokut të portofolit total të huave. Zakonisht sistemi bankar i raporton huatë me probleme gjithnjë në krahasim me totalin e stokut të portofolit të huave të të njëjtës periudhë, në një kohë kur është e njohur që huatë standarde nga momenti që janë disbursuar, kanë ciklin e maturitetit të tyre nga 2 deri në 3 vjet dhe është pikërisht pas kësaj periudhe kohe kur fillojnë dhe rriten huatë me probleme.


Përmbledhtazi, mund të pohohet se, është kjo pikërisht arsyeja pse niveli i huave me probleme fillon të evidentohet veçanërisht nga viti 2007, kur shumica e portofolit ishte krijuar, në një pjesë të mirë, që nga viti 2002 dhe në vijim. Ndersa realisht shenjat e e para janë dhënë që në vitin 2005, ku ritmi i rritjes së tyre në vetvete (dhe jo i marre si raport me total portofolin) krijoj prirjen e pare rritëse. Për më tepër, këto hua me probleme fillojnë e bëhen më shqetësuese dhe serioze kur portofoli i huave në total fillon të ketë një prirje të qëndrueshme rritëse më të ulët gjatë vitit 2009, e për më tepër, kur në vijim portofoli i huave vazhdon të ketë prirje renëse mbas vitit 2011. Stoku i portofolit total të huave në sistemin bankar është akoma më i ulët gjatë vitit 2012, e përveçse shkakton probleme likuiditeti për financimin e veprimtarisë së biznesit në tërësi, jep një tablo më të mirë të prirjes në rënie të huave me probleme, kur krahasohen me të njëjtat hua me probleme të vitit 2011, si dhe një pamje jo reale të prirjes së tyre, kur krahasohen me një portofol më të ulët të huave (shihni tabelën nr. 16 dhe grafikun nr 14).

Tabela nr 16. Prirja e huadhënies dhe e huave me probleme dhe gjëndja e stokut të huasë

Periudha	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Stoku i huasë (mld lek)	48.2	61	112	51.7	260	378	438	491	566	572	568	591
Prirja e huadhënies në %	35%	26%	85%	53%	51%	45%	16%	12%	15%	1%	-1%	4%
Hua me probleme (mld lekë)	2.4	2.4	3.4	5.2	10.4	22.7	48.1	68.7	108	133	133	136
Hua me problem në %	5%	4%	3%	3%	4%	6%	11%	14%	19%	23%	23%	23%

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Grafiku nr 14. Prirjet e huadhënies dhe huatë me probleme gjatë periudhës 2003 - 2014



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Dalja nga ky rreth vicioz është në dorën e vetë bankave, duke përsheptuar procesin e zgjidhjes së huave me probleme; është i njohur fakti se sa më e shkurtër koha e zgjidhjes së këtyre huave, aq më shpejt do të mund të dilet nga kriza dhe rekuperohet ekonomia dhe financimi i vazhdueshëm i saj.

Të dhënat historike të tendencës së PBB për dhjetë vitet e fundit, pasqyron një situatë mjaft sfiduese për operatorët huadhënë s bankar në treg, të cilat të kombinuara me të dhënat e HP për të njëjtën periudhe tregojnë një lidhje dhe varesi të këtyre variablave me njëri tjetrin (Shih tabelën nr 17 në vijim).

Tabela nr 17. Prirja historike e nivelit të PBB-së dhe Huatë me probleme në Shqipëri gjatë 2003-2014

Period	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
PBB në % për Shqipërinë	5.7	5.9	5.5	5.0	5.9	7.5	3.4	3.7	2.5	1.6	1.4	1.9
Hua probl %	5	4	3	3	4	6	11	14	19	22.7	23.4	22.7

Burimi: Banka e Shqipërisë, Raportët vjetore të bankave tregtare.

Variabli i PBB është marre e shkëputur/ndarë nga variablat e tjerë, dhe kjo pasi PBB ndikon në mënyrë të njëjtë nivelin e huave me probleme për çdonjëren bankë tregtare. Tendenca e PBBP ka një rol të rëndësishëm në nivelin e Huave me Probleme, në mënyrë të ndjeshme, bankat duhet të marrin në konsideratë tendencen e PBB gjatë procesit të huadhënies.

Për të ardhur në rezultatet dhe konkluzionet e mësipërme, u morë për bazë të dhëna të stokut të portofolit të huave të çdo banke dhe nivelit të huave me probleme nga fundi i vitit 2014 dhe duke krahasuar këto të dhëna me fundvitin 2009, (shih tabelen nr 18 në vijim), u fokusuam në më shumë se 9 bankat nga 16 operuese në Shqipëri, të cilat kanë mbi 7% të aksioneve në treg të portofolit total të huasë të gjithë sistemit bankar, pikërisht në momentin e shpërthimit të krizës ekonomike në fund të vitit 2009, dhe konkluduar si në vijim:

1. Shumica e bankave, konkretisht 7 nga 9 banka të përzgjedhura si me aktive në huadhënie (përveç Intesa SanPaolo dhe BKT) kanë dyfishuar aksionet e tyre në treg, gjatë periudhës 2003-2008.
2. Vetëm dy banka, BKT dhe Credins Bank, nga 9 banka të marra në studim ruajtën nivelin e huadhënies në mënyrë të moderuar, të cilat rezultuan në një nivel më të ulët të huave me probleme në fund të vitit 2014.
3. Gjashtë nga 9 bankat e përzgjedhura kanë nivelin më të lartë të huave me probleme krahasuar me nivelin mesatar të sistemit bankar.

4. Pesë nga gjashtë banka, kanë ulur/zvogëluar stokun e portofolit të huave gjatë krizës dhe tashmë stoku i tyre i portofolit ka një rënie mesatare me 23% krahasuar me rritjen e mesatare të portofolit të sistemit me 32%. Vëmë re që këto banka janë ato banka me kapital të huaj nga vendet ku kriza financiare ka patur ndikim më të madh, të tilla si Greqia dhe Italia.
5. Niveli i huave me probleme në bankat që kanë ulur stokun e portofolit të huave gjatë kësaj periudhe mesatarisht me 36%, Ndërsa 9 bankat e tjera të cilat rritën portofolin e huave mesatarisht me 85%, niveli i tyre i huave me probleme nuk ka tejkaluar nivelin mesatar prej 18%, dhe që është me një diferencë të dukshme ndaj nivelit mesatar të huave me probleme të sistemit që shënon 23%.

Tabela nr 18. Stoku i portofolit dhe Huatë me probleme të çdo banke tregtare shqiptare midis viteve 2009 dhe 2014.

(Në miliard lekë)

No	BANKAT*	Total Portofoli 2014	Total Portofoli 2009	Ndryshimi i Stokut te Portofolit 2009 vs 2014	Prirja	Huatë me Probleme
1	Alpha Bank	33,704	45,492	-11,788	-26%	33%
2	Tirana Bank	43,756	59,214	-15,458	-26%	43%
3	Credit Agricole	17,148	27,150	-10,002	-37%	39%
4	NB G	27,200	37,035	-9,835	-27%	36%
5	Intesa Sanpaolo	46,713	49,685	-2,972	-6%	28%
6	Raiffeisen Bank	121,217	93,410	27,807	30%	26%
7	ICB	3,548	2,278	1,270	56%	8%
8	ProCredit Bank	23,652	20,576	3,076	15%	15%
9	Veneto Bank	18,330	3,742	14,588	390%	16%
10	Union Bank	14,783	9,977	4,806	48%	16%
11	Credins Bank	88,104	30,242	57,862	191%	20%
12	BKT	104,660	47,356	57,304	121%	11%
13	Societe Generale	40,208	18,211	21,997	121%	10%

14	First Investment Bank	6,504	1,578	4,926	312%	15%
15	Credit Bank of Albania	1,744	266	1,478	556%	67%
16	UBA	na	na	0		0%
I	Total Portofol i sistemit	591,270	446,212	145,058	124,447,427	23%
I/a	Mesatarja e 5 bankave renë se				23%	36%
I/b	Mesatarja e 10 bankave rritëse				85%	18%

Gjithë rezultatet e mesipërme pasqyrojnë dhe bëjnë shumë të qartë efektet korelative të tendencës së stokut të Portofolit në nivelin e Huave me Probleme dhe për të përjashtuar efektet e tendencës së portofolit, dhe të gjejme ndikimin e sakt të çdo variabli në nivelin e huave me probleme, u bë një qasje të ndryshme. Kapitulli në vijim do të trajtoje gjithë variablat që kanë të bëjnë me cilesinë e menaxhimit të portofolit të huave nga vetë bankat, si dhe ndikimin që keto variabla japin në nivelin e huave me probleme.

KAPITULLI V - ANALIZA E STRUKTURËS SË TREGUT TË INDUSTRIËS FINANCIARE DHE SISTEMIT BANKAR NË VEÇANTI

Në këtë kapitull do të trajtojmë strukturën e tregut financiar në tërësi për të vlerësuar e ndarë efektin që këto të fundit japin në nivelin e huave me probleme në përgjithësi. Gjithashtu trajtohet struktura e tregut bankar dhe efektet që sjellë në tërësinë e ecurisë së vet këtij sektori në treg, pavarësisht veçantisë që ka secila prej tyre në mënyrë individuale në menaxhimin e portofolit të huasë. Në këto kushte merr rëndësi trajtimi i këtyre faktorëve, pasi edhe pse ndikojnë njësoj në cilësinë e portofolit të sistemit bankar ashtu si edhe treguesit makroekonomik, kanë rëndësinë dhe peshën e tyre reale në nivelin e huave me probleme. Më konkretisht këto faktorë janë konsideruar ato të cilët lidhen me strukturën e tregut financiar dhe atë bankar në veçanti, duke veçuar përpos kontributit që sistemi bankar shqiptar ka dhënë në drejtim të zhvillimit ekonomik të vendit edhe mangësitë e tij në aspektin e mungesës së një strukturë të plotë të operimit të institucioneve financiare alternative përveç bankave. Një hapësirë në këtë kapitull i është kushtuar dhe aspektit të konkurrencës bankare dhe efektet e kundërta të saj në nivelin e huave me probleme, për shkak të konkurrencës së ashpër mes tyre për të fituar aksione në një treg relativisht të vogël për numrin e bankave operuese. Gjithashtu është analizuar Regjistri i kredisë, rëndësia që ka në operimin e tij si një burim informacioni mjaft i rëndësishëm dhe ndikimi që ka patur në kohë në cilësinë e huadhënies bankare. Analizimi i këtyre faktorëve del nevojë për të qartësuar paraprakisht ndikimin që ka ambjenti i tregut financiar në cilësinë e portofolit të huave në banka, për të parë më qartë dhe saktësuar peshën që ka menaxhimi i çdo njëres prej bankave në cilësinë e portofolit përkatës, në kushte të njohura të tregut në të cilin operojnë.

5.1. Sistemi bankar Shqiptar në fazën e tranzicionit ekonomik dhe efektet që ka patur në cilësinë e portofolit të huave

5.1.1. Struktura e sistemit të industrisë financiare në Shqipëri

Aktualisht industria e ndërmjetësimit financiar në vënd përbëhet nga institucionet hüdhenëse që janë 16 bankat tregtare, si dhe kompani të tjera operuese në këtë treg dhe që janë 4 kompanitë e sigurimeve, si dhe fondacione e unione kredie.

Fondet e pensionit dhe Fondet e investimit, leasing dhe factoring janë ende në fazën fillestare të futjes në treg dhe përbëjnë një peshë shumë të vogël në tërësinë e sistemit financiar në vënd. Segmentimi i tregut financiar në Shqipëri konfirmon një përqëndrim të sektorit bankar në të, ndërsa institucionet e tjera të përmendura me sipër janë me një pjesëmarrje fare të vogël të tyre në tërësinë e industrisë financiare të vendit. Kështu siç vihet re dhe nga Tabela nr 11 dhe Grafiku nr 9 në vijim, sistemi bankar, në 5-6 vitet e fundit zë një peshë mesatare prej rreth 81% të sistemit, ndërkohë që pesha e segmenteve të tjerë është e ulët.


Tabela nr 11. Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite (në përqindje)

	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Sistemi bankar	75.9	76.7	77.5	80.9	84.7	87.9
Institucione jo banka	1.5	1.7	2.2	2.7	2.5	2.6
SHKK-të dhe unione	0.6	1.7	0.8	0.8	0.7	0.78
Shoqëri sigurimi	1.4	1.4	1.5	1.4	1.5	1.5
Fonde pensioni			0.01	0.01	0.01	0.02
Fonde Investimi						1.1

Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti Mbikqyrjes financiare

Vetë sistemi bankar, i përbërë nga 16 bankat tregtare, vjen në rritje të aksioneve të tij në treg dhe në vitin 2013 ka kulmuar me një peshë prej rreth 88% të tregut të industrisë financiare në Shqipëri. Pra sistemi financiar në Shqipëri i dominuar nga ai bankar, ndërkohë që pesha e segmentëve të tjerë është e ulët është promotori kryesor i zhvillimit ekonomik të vëndit.

Grafiku nr 9. Pesha që zë sektori bankar në sistemin financiar në Shqipëri në fund 2013



Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti Mbikqyrjes financiare

Aktualisht bankat tregtare në Shqipëri janë mbështetur në kapital të huaj në masën prej 92.2 % e kapitalit në sistemin bankar shqiptar, ku sipas Dushku (2013) ai me origjinë nga Bashkimi Evropian vijon të zërë peshën më të madhe në strukturën e kapitalit të sistemit bankar⁶⁶.

Në seksionin në vijim do të analizojmë strukturën bankare në vend si dhe efektet negative të saj në drejtim të një konkurrence të ashpër midis bankave që ka prodhuar një portofol kredie jo cilësor.

5.1.2. Struktura e tregut bankar dhe efektet e kundërta të Konkurrences së saj në cilësinë e portofolit të huave.

Mbas viteve 90' me hapjen e vëndit ndaj ekonomisë së tregut, dhe sistemi bankar shqiptar si pjesë e tij, hapi dyert e vërshimit të kapitalit të huaj që erdhi si rezultat i hapjes së shumë

⁶⁶ Dushku, E & Kota, V. "Modeli financiar në Shqipëri: Qasje ndaj të dhënave të panelit" Material Diskutimi, Banka e Shqipërisë 14 (73) 2013. pg. 11. Në tekst referuar si: Dushku (2013). fq. 11

filialeve dhe degëve të bankave të huaja në vend, duke u bërë kështu pjesë e zhvillimeve të fundit në tregun financiar global. Vetëm pak banka kanë filluar të operojnë nga viti 1996, dhe çfarë është më e rëndësishme, gjithë këto banka filluan të bëhen shumë agresive në huadhënie, veçanërisht mbas vitit 2004 deri 2008, pikërisht gjatë periudhës së euforisë ekonomike dhe bumit të kredive në Shqipëri, fenomen i cili rezultoj të ishte mbarë botërore.

Numri i bankave operuese në tregun shqiptar konsiderohet relativisht i lartë në kushtet e një tregu ekonomik të kufizuar në aspektin sasior të tij por edhe të integritetit financiar, dhe ky disproporcion ka qënë shkak që bankat të konkurronin mes tyre për të dominuar tregun.


Pa harruar efektet pozitive të konkurrencës bankare gjatë fazës së hyrjes, bankat kanë adoptuar dhe kërkojnë objektiva shumë të larta në drejtim të rritjes së huadhënies, prandaj financuan projekte me risk, të cilat dështuan të prodhojnë histori suksesi. Kur kombinohet ky faktor me krizën financiare lokale dhe botërore, situata është praktikisht duke ndikuar në stabilitetin e sistemit bankar në Shqipëri. Analizimi i të dhënave historike të sistemit bankar shqiptar, në kuadrin e kërkimeve më të fundit aktuale, nxjerr konkluzione të drejta mbi efektet reale të kundërta të konkurrencës bankare në kushtet specifike të vëndit. Përveç efekteve pozitive në krijimin e një tregu standard dhe të drejtë, konkurrenca bankare në Shqipëri ka prodhuar gjithashtu disa efekte të kundërta dhe kjo është e lidhur shumë me vet sektorin bankar. Disa evidenca të efekteve anësore të konkurrencës bankare në Shqipëri mund të përmendim faktin e operimit të një numri relativisht të madh të bankave tregtare Shqiptare të cilat konkurojnë në një treg relativisht të vogël duke shkaktuar ndërtimin e një portofoli me cilësi të ulët, i cili shpejt mundi të çojë në problemet e likuiditetit, brënda sistemit financiar. Tabela nr. 12 Grafiku nr. 10 dhe Grafiku nr. 11 në vijim, tregojnë qartë përqëndrimin bankar në treg të tyre nisur nga koha e hyrjes në treg, si dhe karakteristika e vlerës së aseteve që zotërojnë dhe të portofolit të huave.

Tabela nr 12. Bankat tregtare në Shqipëri, sipas vitit të krijimit, aksionet e tyre në treg ndaj totalit të aktiveve, dhe portofolit të huave sipas Shtator 2013.

Viti krijimit.	Emri Bankes	Total Aktive në Leke	Në % ndaj sistemit	Total Portofoli në Leke	Protofoli ndaj aktiveve në %
1991	Raiffeisen Bank	323,136,334	28%	134,136,033	42%
2000	BKT	227,102,744	19%	86,500,584	38%
1998	Intesa Sanpaolo Bank	138,020,830	12%	50,097,011	36%
1996	Tirana Bank	94,406,469	8%	56,515,232	60%
2003	Credins Bank	92,605,448	8%	62,548,919	68%
1996	Alpha Bank	73,379,976	6%	38,523,319	52%
2004	Societe General	60,604,226	5%	32,076,576	53%
1996	NBG	42,329,454	4%	27,523,373	65%
1999	ProCredit Bank	41,161,734	4%	23,211,152	56%
1999	Emporiki Bank	32,069,397	3%	23,883,626	74%
2005	Veneto Bank	15,960,575	1%	11,485,324	72%
1999	FIB	9,833,120	1%	5,049,551	51%
1997	ICB	8,620,359	1%	2,503,949	29%
1996	UBA	6,432,135	1%	1,741,423	27%
2003	Banka e Kreditit	1,808,965	0%	26,876	1%
2006	Union Bank	n.a	0%	15,877,000	
	TOTAL	1,167,471,766		571,699,948	

Burimi: Banka e Shqipërisë


Grafiku nr 10. Aktivet e çdo banke tregtare në përqindje ndaj totalit të aktivave të Sistemit Bankar Shqiptar, Shtator, 2013.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Për të parë ndikimin që ka patur në aktivitetin kreditues të bankave ky segmentim i tregut bankar shqiptar, ju referuam të dhënave statistikore të publikuara nga Banka e Shqipërisë për një periudhë 10 vjecare 2003-2013, mbi stokun e portofolit në vite si dhe prirjen e tij gjatë kësaj periudhe.

Grafiku nr 11. Portofoli i huave të çdo banke tregtare ndaj total portofolit të huave të Sistemit Bankar Shqiptar, Shtator 2013.



Burimi: Banka e Shqipërisë


Sikundër shihet dhe nga tabela nr 13 dhe grafiku nr 12 në vijim, konkurenca bankare ka ndikuar në një rritje të ethshme të portofolit të huave gjatë periudhës kur këto banka kishin përfunduar fazën e instalimit të tyre në treg, dhe filluan kreditimin e ekonomisë në ritme shumë galopante, kohë e cila përkon me vitet 2005 deri 2008.

Tabela nr 13. Prirja rritëse e kreditimit dhe Stoku i portofolit të huave në vite

Periudha	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
stoku portofolit të huave	48.3	60,9	113	173	260	378	438	491	566	572	563	591
rritja në %	35%	26%	85%	53%	51%	45%	16%	12%	15%	1%	-1.6%	5.0%

Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafiku nr 12. Prija rritëse e huadhënies në sistemin bankar shqiptar gjatë 2003-2014



Burimi: Banka e Shqipërisë

Siç mund të vihet re lehtë në Tabelat dhe grafikët më sipër, përveç faktit që shumica e bankave kanë qënë tashmë në treg më herët sesa viti 2000, ato janë bërë aktive në aktivitetin huadhënës mbas 2004 deri 2008, (sipas të dhënave të publikuara nga BSH mbi stokun e portofolit të kredisë në vite) duke konkuruar njëra tjetrën në një huadhënie intensive. Vihet re se ka një përqëndrim shumë të lartë të sistemit bankar Shqipëtar, në pak banka dhe ku 5 banka, nga 16 banka operuese në treg, zotërojnë më shumë se sa 75% të total aktiveve të gjithë sistemit, (shih tabelën dhe Grafikun 5 më sipër), ndërsa numri i degëve bankare në Shqipëri për një mijë banorë është 0,17 degë për një mijë banorë, e cila është më e ulëta në rajon. Akoma më i lartë fenomeni i përqëndrimit të aktiveve dhe huave, dhe që është tipike për tregun bankar në Shqipëri, veçanërisht fakti se dy bankat ish shtetërore: BKT dhe Banka e Kursimeve, sot RZB Al, zotërojnë shumicën e aktiveve brënda sistemit financiar, gjatë dallgëve të para të zgjerimit të aktivitetit bankar tregtar. Sot, të dy bankat akoma zotërojnë 47% të tregut të aseteve dhe si pasojë rreth 40% të totalit të portofolit të huave. Struktura e tregut e sistemit bankar në Shqipëri është e ngjashme me atë të Greqisë, e cila përjetoi së fundmi problemet më të ashpra të mungesës së likuiditetit. Sidoqoftë, tiparet specifike të vëndit e bëjnë të vështirë nxjerrjen e konkluzioneve rreth strukturës më të mirë të tregut bankar. Duke parë ngjashmërinë me bankat greke, në mund të guxojmë të mendojmë që sistemi bankar Shqiptar mund të përjetoi një përkeqsim të mëtejshëm të cilësisë së portofolit të huasë. Ngjashëm si në vënde të tjera të Europës

Lindore, bizneset në Shqipëri nuk kanë kapital të mjaftueshëm për të mbajtur balanca normale kundrejt borxheve, dhe ato janë ende larg nga të qenit të konsoliduar e sofistikuar për tu mbështetur në burimet e brëndshme financiare. Këto biznese nuk kanë kapacitete të mjaftueshme menaxhimi. Gjithashtu, buxhetimi, parashikimi, kërkimet e tregut dhe zhvillimi strategjik për shumicën e bizneseve në Shqipëri nuk janë ende praktika normale biznesi. Ekonomia e tregut Shqiptar nuk është e mirë diversifikuar ndërsa për një kohë të gjatë ka mbetur e fokusuar në sektorët e ndërtimeve civile dhe importet e mallrave të konsumit, më shumë se sa në sektorë prodhimi dhe eksportet, të cilat do të krijonin një bazë të rëndësishme për një zhvillim të qëndrueshmë e afatgjatë të vendit. Kështu, nën frymën ku paratë merren lehtësisht, administratorët e bizneseve investuan në projekte me rrezik të lartë pa patur një strategji konkrete të përdorimit me efektivitet të tyre. Nga ana tjetër, tregu i mbushur me shumë fonde të lira, krijuan situatën e një ekonomie të mbi financuar, nga shumë burime si: remitancat, donacionet, etj, të cilat të gjitha së bashku ishin shumë mbrapa kapacitetit të tregut për ti absorbuar ato në mënyrën me efëcente. Për disa banka, të cilat kishin tashmë fonde të lira, veçanërisht ato me kapital të huaj, kjo situatë përkoj me fazën e bumit të huadhënies brënda tregut Shqiptar, ku shumë fonde të huaja të lira vërshuan. Bankat me 100% kapital të huaj përëndimor, përjetuan një avantazh të fortë kundrejt bankave të tjera të huaja dhe atyre lokale në fillim. Biznesi privat në Shqipëri ishte i papërgatitur për të shfrytëzuar të tilla fonde të mëdha relativisht në mënyrë të suksesshme në projekte me përfitueshmëri afatgjatë.

Gjithë faktet e përmendura më sipër kontribuojnë në një portofol cilësisht të dobët dhe në rritjen e huave me probleme, të origjinuara kryesisht gjatë periudhës 2005 - 2008. Gjatë kësaj periudhe shumë të shkurtër kohe, shumë fonde të lira vërshonin në Shqipëri nga shumë burime si: remitancat, IDH (investimet direkte të huaja), duke rritur likuiditetin përtej nevojës në treg dhe veçanërisht atë bankar, situatë e cila në mënyrë konsistente shoqërohej me një rritje të shpejtë të portofolit të huave dhe huave me probleme. Po kështu numri i bankave operuese dhe atyre më agresive në huadhënie vijnë në rritje paralele me portofolin e huave. Problemet e këtij vrapi të furishëm në huadhënie nga bankat dhe huamamrja nga bizneset bëhen evidente dhe dalin në pahë me shpërthimin e krizës globale

financiare. (Shih Tabelën nr. 14 në vijim). Në këtë tabelë janë përfshirë të dhënat e ecursisë së sistemit bankar në huadhënie në katër periudhat domethënëse të tij, periudha e instalimit të bankave në treg (2000-2002), periudha e fillimit të huadhënies (2003-2005), periudha e bumit të kreditimit (2006-2009) dhe periudha e krizës globale financiare (2010-2014), kohë në të cilat shfaqja e huave me probleme arrin nivele të paparashikuara.

Duke marrë në konsideratë faktorët e tregut në Shqipëri, është e lehtë të kuptosh vrapin dhe ngutën e gjithë bankave tregtare për të kapur aksione të këtij tregu. Në këtë kontekst, bankat vunë objektiva të larta dhe shumë agresive në huadhënie, të cilat sollën situatën e neglizhimit të parimeve bazë në praktikën e huadhënies. Kështu, portofoli i huave, gjatë kësaj kohe, kishte një tendencë rritje më të shpejtë dhe një përkeqsim të cilësisë së tij.

Shqipëria, si shumica e vendeve në rajon, përjetoi një trend konstant të rritjes së vlerës së kolateraleve, (pasurive të patundshme, të cilat influencuan në një shtim oreksi për bankat për të rritur portofolin e huave, në mënyrën e një konkurrence të padrejtë dhe të ashpër, me argumentin që vlera e kolateralve është garancia e ripagimit të huasë edhe në kushtet e një huaje cilësisht të dobët.

Tabela nr 14. Ecuria e bankave dhe prirja e huadhënies bankare në katër periudha kohore⁶⁷

Vitet	2000-2002	2003-2005	2006-2009	2010-2014
Nr i Bankave	11	13	16	16
Nr i Bankave huadhënëse	9	10	16	16
Nr i huadhënësve agresive	6	8	16	4
Portofoli në Billion	3	7	31	59
Huatë me probleme në billion	-	0,3	2,2	13.5

Burimi: Banka e Shqipërisë

⁶⁷ Ndarja në tre periudha bazohet në tre ciklet që ka përshkruar sistemi bankar Shqiptar, atë të instalimit të bankave, fillimit të aktivitetit huadhënës, dhe bumit të kredive, duke kombinuar të dhëna statistikore mbi nr e bankave, nën cilësimin e bankave huadhënëse, dhe agresive, si dhe stokut të portofolit të kredive në këto periudha.

Në këto rrethana bankat i kushtuan më pak vëmendje cilësisë së huadhënies dhe për më tepër, cilësisë së portofolit në tërësi. Në kushtet e një përkeqsimi të cilësisë së portofolit të huave, bankat mund të llogarisin provigjone të pamjaftueshme për riskun real që paraqet portofoli i huave, kjo pasi e bëjnë pamjen më optimiste të vlerës së kolateraleve, të cilat mundësojnë që bankat të paraqiten me tregues financiar optimal për të vijuar mbijetesën e tyre në treg.

5.1.3. Regjistri i kredive dhe roli i tij si një mjet i rëndësishëm në identifikimin e cilësisë së kredikërkuesve .

Regjistri i Kredive është një mjet shumë i fuqishëm në duar të institucioneve huadhënëse, i cili furnizon me informacion mjaft të qënësishëm e thelbësor këto institucione, duke shërbyer si një burim informacioni i pazëvendësueshëm për këta përdorues. Qëllimi bazë i ngritjes së Regjistrit të kredive është për të qendëruar gjithë informacionin mbi kreditë e individëve dhe bizneseve në një vend të vetëm. Regjistri i kredive si koncept është krijuar dhe ka funksionuar për herë të parë në Amerikë në fund të viteve 1800, ndërsa në Europë për herë të parë regjistri i kredive ka filluar të operojë në Gjermani në vitin 1930. Në Rajonin e Europës Lindore, dhe vendet e Ballkanit, ku përfshihet dhe vendi ynë, regjistri i kredive ka filluar operimin midis viteve 1997 (Greqia) deri në vitin 2010 (Maqedonia). Regjistri i Kredive në Shqipëri ka filluar operimin e tij në 03 Janar të vitit 2008, qëllimi i të cilit si edhe kudo në botë nuk është vetëm qëndërzimi i të dhënave por në mënyrë të veçantë, synimi i tij është ulja potenciale e rrezikut të kredisë nga institucionet huadhënëse dhe përdoruese të tij. Kështu bankat tregtare si përdorues të këtij burimi të jashtëzakonshëm informacioni, ndihmohen shumë në vendimarrjet e tyre ndërsa janë në fazën e analizës së aplikimeve të reja për kredi por edhe në fazën e ndjekjes dhe monitorimit të kredive të dhëna, për të parë në kohë aftësinë paguese të huamarrësve bazuar në barrën e borxheve në kohë si dhe qasjen e klientit ndaj institucioneve huadhenese.

Sipas publikimit të Bankës së Shqipërisë aktualisht (2008), pjesëmarrës në Regjistrin e Kredive janë 16 banka, 12 subjekte financiare jobanka që ushtrojnë aktivitetin e kredidhënies dhe të qirasë financiare, një shoqëri kursim-krediti që ushtron aktivitetin e pavarur nga unionet si dhe dy unione të shoqërive të kursim-kreditit në rolin e

përfaqësuesve të shoqërive anëtare të tyre. Fillimisht, raportuese të të dhënave në Regjistrin e Kredive ishin vetëm bankat dhe degët e bankave të huaja. Nga Nëntori i vitit 2010, baza e të dhënave është pasuruar edhe me informacionin e raportuar nga subjektet financiare jobanka dhe shoqëritë e kursim-kreditit.⁶⁸

Informacioni që përcillet nga regjistri i kredive është i tillë që nëpërmjet të dhënave sasiore mbi barrën e borxhit, kolateralet e vëna për këto borxhe, afatet e pagimit të këtyre borxheve, detyrimet mujore, jep të dhëna cilësore edhe mbi vonesat apo korrektesinë e shlyerjes së tyre në kohë, duke ndihmuar kështu vendimarrësit kredidhënës jo vetëm të ndërmarin vendime të drejta për financim ose jo të një aplikimi të caktuar por edhe për të bërë një vendimarrje të saktë në drejtim të përcaktimit të termave të shlyerjes së këtyre kredive, në një mënyrë të tillë që kreditë e dhëna të jenë konform praktikave dhe procedurave të kreditimit por edhe të jenë një ndihmë për biznesin duke planifikuar kohën dhe mënyrën e shlyerjes në varësi të kapacitetit të tij pages. Përveç institucioneve huadhënëse, Regjistri i kredive është i rëndësishëm edhe për institucione të tjera për kërkime e studime për të vlerësuar nivelet e borxhit të bizneseve apo individëve.

Duke qënë se informacioni që mbart është individual dhe mjaft i ndjeshëm, përdorimi i tij nuk është i hapur për publikun, por vetëm për subjekte të autorizuar siç janë kredidhënësit.

Informacioni që përmban Regjistri i Kredisë, është pozitiv dhe negativ për kredimarrësin dhe ky informacion me këto të dhëna ruhet në Regjistër për 5 vjet. Historiku i shlyerjes së kredive nga kredimarrësit i shërben vendimarrësve të institucioneve huadhënëse për të financuar ose jo aplikuesit për kredi. Raporti i kredimarrësit, që raportuesit e të dhënave marrin si produkt nga Regjistri, përmban informacion mbi shumën e kredisë, shlyerjet e saj, shumat e vonuara, garancitë e vëna për të, të dhëna për linjat e kredisë ku kredimarrësi është person i lidhur, si dhe historikun e statusit të kredisë për dy vitet e fundit. Raporti i kredimarrësit mund të gjenerohet nga çdo subjekt bankar dhe financiar që është pjesë e Regjistrit të Kredive, si dhe nga Banka e Shqipërisë.

⁶⁸ www.bankofalbania.org “Regjistri I Kredive”,

Ndikimi i Regjistrat të Kredive në cilësinë e huadhënies në sistemin bankar Shqiptar

Rëndësia që ka Regjistri i Kredisë në cilësinë e huadhënies, është një fakt i cili nuk ka nevojë për interpretime dhe argumente. Bota e financave moderne e ka vënë në funksion këtë burim të rëndësishëm informacioni, si një nevojë e domosdoshme për të ulur rrezikun e kredisë, dhe rritur efektivitetin e huadhënies bankare dhe rritur më tej volumin e kredidhënies.

Në botë operojnë dy tipe të regjistrave të kredive, ato private dhe publik, ku regjistrat privatë konsiderohen si më shumë përparësi se sa regjistrat publik, ndërsa në Shqipëri operon Regjistri i Kredive publike.

Vladimir Simovic (2011) në studimin e tij mbi ndikimin e Regjistrat të Kredisë në Europën Lindore, jep argumente të qarta mbi dallimet që kanë regjistrat e kredisë private nga ato publik, duke i dhënë prioritet Regjistrave private, si me efektiv në matjen e borxhit, për shkak se ato e shtrijnë fushën e mbulimit me informacion në më shumë burime se sa ato publike.⁶⁹

Miller (2003), thekson se për të identifikuar efektet e regjistrave publike mbi nivelin e borxhit, duhet të nisemi nga qëllimi parësor i themelimit të tyre, dhe që është kontrolli i likuiditetit dhe riskun e sistemit në sektorin bankar, se sa huatë në vlera të vogla të cilat do të regjistrohen dhe që do të jenë të shumta.⁷⁰

Në këtë kontekst Regjistri i Kredive në Shqipëri, ka një kontribut modest në rritjen e cilësisë së huadhënies, dhe kjo jo vetëm për tipologjinë e tij, si regjistër publik se sa për shkak se operimi i tij ka filluar relativisht vonë në raport me ekspansionin e zgjerimit të kredidhënies që përkon kryesisht në periudhën 2003-2008, siç ka dale edhe nga analiza e kryer e këtij punimi. Në kushtet e një operimi relativisht të vonuar, si dhe shtrirjes në një kohë të kufizuar të kredidhënies nën operimin efektiv të regjistrat kombëtar publik të

⁶⁹ Vladimir Simovic, Vojkan Vaskovic, Marko Rankovic, Slobodan Malinic “The impact of the functional characteristics of a credit bureau on the level of indebtedness per capita: Evidence from East European countries”, *Baltic Journal of Economics* 11(2) (2011) 101-130

⁷⁰ Miller Mj (2003) “Credit reporting around the globe, In: Miller MJ ed “Credit reporting Systems and the International Economy, MIT Press, Cambridge.

kredive, analiza e efektivitetit të tij në vetvete në raport me një regjistër privat nuk do të na jepte ndonjë diferencë domethënëse që do të shërbente këtij punimi.

Matja e efektivitetit të Regjistrimit të Kredive mund të vlerësohet, duke krahasuar kredidhënien në një periudhë para dhe pas funksionimit të regjistrimit të Kredive, por duke qënë se funksionimi i regjistrimit të kredive në Shqipëri përkoj me fillimin e krizës globale, e cila solli për pasojë frenimin nga bankat tregtare të kredidhënies, ky krahasim do ishte jo i përshtatshëm duke na dhënë një vlersim jo të saktë të efektivitetit të përdorimit të tij nga bankat tregtare në procesin e kredidhënies. Në llogaritjen e efektivitetit të këtij regjistri ka edhe një pengesë teknike, që lidhet me faktin se regjistri kredisë nuk nxjerr të dhëna që tregojnë numrin e kredimarrësve për ekspozimet e dhëna në sistemin bankar.

Formula e përdorur, nëse do të ekzistonin të dhënat e plota, do të na ndihmonte të kishim një vlerësim të saktë të efektivitetit të këtij regjistri kredisë midis një periudhe kredidhënie pa regjistër të kredive dhe gjatë periudhës së ekzistencës dhe përdorimit të informacionit nga ky regjistër.

Si konkluzion bazuar në sa më sipër, vlerësohet se efektet e regjistrimit të kredive në Shqipëri, për kohën në të cilën është shtrirë ky studim është më shumë në drejtim të monitorimit të kredive të dhëna se sa në sasinë dhe cilësinë e kredidhënies. Megjithatë roli i tij është po aq i rëndësishëm sa edhe ai në momentet e vendimarrjes për kredidhënie të reja, pasi ndihmon bankat të vlerësojnë rrezikun real të portofolit të kredive të dhëna, duke marrë masa për të përmirësuar cilësinë e tij. Gjithsesi roli i regjistrimit të kredive në Shqipëri konsiderohet modest në cilësinë e portofolit për sa kohë, funksionimi i tij ka qënë pas ekspansionit të kredidhënies nga bankat tregtare në vend.

5.2. Faktorët që lidhen me menaxhimin e portofolit të huave nga vetë bankat si ndikues në nivelin e lartë të huave me probleme

Në këtë seksion jepen disa observime, vlerësime, dhe gjetje mbi çdo njërin prej variablave/faktorëve që potencialisht mendohet se ndikojnë në cilësinë e portofolit të huave si pasojë e një administritimi jo të përshtatshëm të vërejtur në vitet e bumit të kredive. Çdo njëri prej faktorëve do të merret në analizë veçmas dhe në fund të gjithë së bashku këta

faktorë do të vlerësohen duke matur ndikimin e tyre në cilësinë e protofolit të huave në sistemin bankar në vend duke përdorur analizat krahasuese dhe modelet statistikore.

Faktorët cilësorë që konsiderohen në këtë vlerësim, përfshijnë faktorët që lidhen me cilësinë e huadhënies, Rolin e njësisë së Riskut në banka, diversifikimi i portofolit të huave, përmirësimi i procedurave dhe rregulloreve në procesin e huadhënies kontrollit dhe monitorimit të huave, kualifikimet dhe tranimet e stafit të punonjësve të kredisë, problemet e agjencisë etj. Këto do të jenë variablat kryesor ku është fokusuar analiza dhe kërkimi i këtij nënkapitulli. Analiza e këtyre faktorëve synon të vërtetojë hipotezën kryesore të këtij studimi.

Përmbledhtas nëpërmjet modelit statistikore të përshtatshëm, ky trajtim do të jetë në gjendje t'i përgjigjet çështjeve të tilla si:

- Cili është roli i vetë menaxhimit të Bankave në këtë proces dhe
- A është mirëadministrimi i portofolit të kredisë kyç për të patur një protofol kredie të shëndetshëm dhe stabilitet bankar?

Në këtë nënkapitull analizohen praktikrat dhe procedurat e kreditimit në sistemin bankar shqiptar gjatë dekadës së fundit, dhe rolin që ka luajtur risku në këtë proces, të cilat do të jenë baza mbi të cilën jepen disa rekomandime mbi zgjidhjen e huave me probleme, diversifikimin e portofolit brënda kufijve të tolerueshëm e të menaxhueshëm ndaj rrezikut si dhe stabilitetin financiar të bankës.

Ekonomia Shqiptare tashmë po përjeton një fazë të gjatë tranzicioni drejt ekonomisë së tregut, duke pasqyruar një sistem financiar të pabalancuar.

Sikundër theksojnë Meka & Meka (2012): Në mungesë të burimeve financiare konkurruese, përveç financimit nga bankat, bizneset shqiptare po përballen me një pranim “të detyrueshëm” të kushteve të shtrënguara, të ofruara në mënyrë të sinkronizuar nga gjithë bankat, si dhe një ofertë të kufizuar të huadhënies, në periudhën midis 2009-2012 dhe madje gjatë vitit 2013.⁷¹

⁷¹ Meka, E.& Meka, S (2012).: “Albanian financial system in front of global & financial crisis - a new approach to ensure long-term sustainability”, June 2012, p.5.

Për vetë natyrën e veçantë të sektorit bankar, menyra se si zgjedh të menaxhoje aktivitetin kreditues, venies në zbatim të politikave që çdo bankë zgjedh lidhur me përpjekjet për të maksimizuar efikasitetin dhe përmirësuar menaxhimin e rrezikut të tyre, luajnë rol të rëndësishëm në ndikimin e tyre vendimtar në ecurinë e huave me probleme.

Të dhënat e përgjithshme historiko ekonomike, të publikuara kryesisht nga Instituti i Statistikave japin një tablo gjithëpërfshirëse të periudhës së gjithë dekadës së fundit, si për periudhën para krizës, midis vitit 2000 deri në vitin 2007, ndërkohë që ekonomia shqiptare përjetonte fazën e lulëzimit të saj, ashtu dhe gjatë periudhës së krizës financiare, midis viteve 2008 dhe 2012. Pikerisht faza e pare e bumit të kredive mendohet dhe vlerësohet të jetë periudha në të cilën bankat me ngut për të përfituar nga situata makroekonomike për të rritur kapitalet e tyre dhe aksionet në treg, duke kredituar bizneset pa qenë në përputhshmeri të plotë me standardet moderne të kreditimit.

Rritja e shpejtë e portofolit të huave, në shumicën e bankave tregtare në Shqipëri gjatë periudhës së lulëzimit ishte e shoqëruar gjithashtu nga mungesa e ekspertizës dhe e specialistëve të mirëkualifikuar të kredisë, të cilët duhet të ishin të aftë të përzgjidhnin aplikimet më të mira dhe të suksesshme. Vjen ky konkluzion, nga fakti se procesi i kreditimit të biznesit filloj pa arritur të krijoj një staf të mirëkualifikuar në këtë fushe në shumicën e bankave.

Hartimi i raporteve të analizës për aplikuesit e huave është një sfidë për specialistët e kredisë, burimi i informacionit të kredisë së përdorur është shpesh i kushtueshëm dhe jo në të njëjtin nivel cilësie. Regjistri i kredisë në Shqipëri filloj operimin vetëm në Janar të vitit 2008, dhe është bërë një mjet shumë i dobishëm për bankat për marrjen e informacionit rreth huave të huamarrësve që nga fillimi e deri në momentin e kërkimit.

Aftësitë bazë të bankierit në kredi shtrihen në mbledhjen dhe përpunimin e informacionit më të vlefshëm dhe relevant, me një kosto sa më të ulët, pa thyer kërkesat legale ose normat shoqërore. Kjo do të thotë identifikimin e burimit të informacionit dhe përdorimin e burimeve standarde në mënyrë sa më të zgjuar.

Situata e rritjes ekonomike të vendit para viteve 2008-2009, ku PBB arriti nivelet e 6-8%, krijoj një qasje të gabuar të të dy paleve pjesëmarres në procesin e kreditimit, si të kredimarresve dhe po ashtu të kredidhënësve. Kredimarresit, kryesisht bizneset në kushtet e një ofertë të bollshme në treg nga ana e bankave, dhe lehtësisë së gjetjes së fondeve në treg, kreditë e marra lehtësisht nga kredidhënësit i përdorën në projekte me afate të gjata të kthimit të tyre, kryesisht në investimet në pasuri të patundshme. Ndërsa bankat nga ana e tyre, në kushtet e burimeve të shumta të fondeve dhe etjes për të zotëruar sa më shumë aksione në një treg të kufizuar neglizhuan standartet e kreditimit, duke krijuar një protofol kredie të tillë që sapo situata e likuiditetit në treg filloj të përkeqsohej, ky protofol kredie demonstrojë menjëherë cilësinë e tij të dobët nëpërmjet rritjes së menjëhershme të huave me probleme.

5.2.1. Roli i procedurave dhe rregulloreve në nivelin e huave me probleme

Menaxhimi i huasë në një bankë është një instrument tepër i rëndësishëm në garantimin e suksesit apo dështimit të një institucioni huadhënës. Sistemi bankar Shqiptar, relativisht i ri në ekonominë e tregut, filloj të aplikojë procedura dhe rregullore të huadhënies pasi portofoli i huave pothuajse ishte krijuar, ndërkohë që Roli kyç i menaxhimit të riskut dhe procedurat respektive të tij ishin pothuajse të panjohura për shumicën e bankave në Shqipëri, gjatë periudhës së lulëzimit të kredidhënies në vënd. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë ka qënë relativisht e vonuar në marrjen e rolit të saj në procesin e kontrollit dhe monitorimit të instalimit të rregulloreve dhe strukturave të huadhënies si një standard i detyrueshëm për tu zbatuar në praktikë për bankat tregtare në vend.

Në këtë seksion, do të trajtohen disa nga arësyet kryesore pse bankat Shqiptare mbetën prapa në aspektin e aplikimit dhe zbatimit të praktikave dhe procedurave moderne të menaxhimit të riskut, gjatë periudhës së bumit të kredive dhe spjeron pse procedurat dhe rregulloret që synojnë të rregullojnë gabimet gjatë procesit të kredidhënies, ose përmirësimit të cilësisë së portofolit, janë me kosto të lartë dhe me pak sukses. Gjithashtu, ky seksion vë theksin në mungesën e kualifikimit dhe trainimit të oficerëve të kredisë në banka, pasi shumica e këtyre bankave praktikojnë “trainimin gjatë punës”, dhe vetëm pak

banka kujdesen për trainimin e stafit të tyre, dhe praktikojnë një strukturë organizative të përshtatshme, të cilat ishin më shumë të fokusuara në shitje se sa në risk.

Sidoqoftë, disa leksione mbi rregulloret financiare dhe mbikqyrjen mund ti nxjerrim lehtësisht, pasi faktorët influencues në krizën financiare Shqiptare janë pak a shumë të ngjashme me ato të botës, edhe pse është e ndikuar dhe nga faktorë që lidhen me Shqipërinë. Roli i mbikqyrjes së Bankës së Shqipërisë në sistemin bankar Shqiptar, si një instrument i mbikqyrjes së rreptë të aktivitetit kreditues të bankave tregtare vjen relativisht vonë në kohë. Rregulloret dhe mbikqyrja në sistemin bankar Shqiptar u bë e detyrueshme dhe operative gjatë praktikave të huadhënies, kur portofoli i huave ishte pothuaj i krijuar. Siç mund të shihet lehtësisht në Tabelën nr 19, dhe 19/1 sipas të dhënave të publikuara të Bankës së Shqipërisë, rreth 80% e portofolit ekzistues u krijua gjatë periudhës 2006-2009, Ndërsa gjatë viteve 2000-2004, vetëm 11% dhe diferenca prej vetëm 9%, u krijua në vitin 2009 dhe deri më sot, që përkon praktikisht gjatë periudhës së krizës financiare.

Tabela nr 19. Prirja e huadhënies kundrejt huave me probleme, dhe pesha historike e tyre kundrejt totalit të portofolit gjatë 2003 -2008.

Periudha	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Huatë me probleme, (në mil lekë)	2410	2435	3378	5175	10394	22658
Ndryshimi në % i huave me probleme	5%	4%	3%	3%	4%	6%
Total Portfoli huasë	48,209	60,874	112,593	172,486	259,846	377,631
Ndryshimi i Portfolit të huasë	0	12,665	51,719	59,893	87,360	117,785
Ndryshimi në % i Total Portfolit	34.50%	26.27%	84.96%	53.19%	50.65%	45.33%
Huatë me probleme kundrejt nivelit aktual 2014.	1.77%	1.79%	2.49%	3.81%	7.65%	16.68%

Burimi: Banka e Shqipërisë

Tabela nr 19/1. Tendenca e huadhënies kundrejt Huave me probleme, dhe pesha historike e tyre kundrejt totalit të portofolit gjatë 2009 -2014.

Periudha	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Huatë me probleme, (në mil lekë)	48149	68721	107581	217581	132988	135835
Ndryshimi në % i huave me probleme	11%	14%	19%	20%	23,5%	22,7%
Total Portfoli huasë	437,722	490,861	566,217	572,000	567,760	591,300
Ndryshimi i Portfolit të huasë	60,091	53,139	75,356	5,783	-4,240	23,540
Ndryshimi në % i Total Portofolit	15.91%	12.14%	15.35%	1.02%	-1%	4%
Huatë me probleme kundrejt nivelit aktual 2014.	35.45%	50.59%	79.20%	160.18%	97.90%	100.00%

Burimi: Banka e Shqipërisë

Rregulloret moderne mbi praktikat e huadhënies në sistemin bankar Shqiptar, morën formë në 2007 dhe pas tij, duke qënë kështu paksa i pasinkronizuar me periudhën e bumit të kredive, gjatë të cilës portofoli i kredive ishte pothuajse krijuar.

Banka e Shqipërisë ka qënë duke ekzaminuar e zbatuar jo një Basel I të pastër të kërkesave për mbikqyrje, se sa ta përdorë atë për të përshtatur setin e kërkesave të Basel I. Standartet e tilla të përshtatura të Basel I, ndihmuan bankat në Shqipëri të pengojnë efektet e krizës së fundit financiare, por provuan që ishin të paplota, në aspektin e sigurimit të një menaxhimi afatgjatë të cilësisë së portofolit të huave.

Basel II është në proces për tu aplikuar në sistemin bankar Shqiptar nga vitit 2014 e në vazhdim, kështu kjo mund të klasifikohet si një tjetër faktor, që ndikon në cilësinë e ulët të portofolit të huave të trashëguar në banka.

E gjejme këtë të Arukunar (2005), i cili shprehet se: *Marëveshja kapitale e Basel II, është porpozuar të përfshijë një ndjeshmëri më të madhe të riskut. Marëveshja e re jep një spektër të gjërë të qasjeve nga metodologjitë më të thjeshta tek ato më të avancuara të të dy risqeve atij operacional dhe të kredisë në përcaktimin e nivelit të*

*kapitalit. Marëveshja e re është ndërtuar në tre kollona, Kërkesa për Kapital Minimal, Rishikim i Mbikqyrjes dhe Disiplina e Tregut.*⁷²

Kërkesa për minimumin e kapitalit vendosur nga banka e Shqipërisë, për sistemin bankar në Shqipëri është 12%, që është më i lartë krahasuar me vënde të tjera të zhvilluara, të cilat e kanë 8%, për të mbuluar riskun potencial në ngjarjet e krizave financiare të ardhme, dhe shumë afër me kërkesat e Basel III, i cili nuk është më shumë se 15%.

5.2.2. Roli i njesise së Riskut gjatë procesit të huadhënies në sistemin bankar Shqiptar

Një tjetër faktor i rëndësishëm në fenomenin e prirjes rritëse të huave me Probleme është se Njësia e Riskut të Kredisë, mori rolin e tij në praktikatat e kreditimit nga vitit 2007 dhe në disa banka edhe më vonë, kohë gjatë të cilës portofoli i kredive ishte pothuajse i krijuar. Në këtë situatë është e qartë se roli i menaxhimit të riskut në praktikatat e huadhënies ishte modest në krijimin dhe ndërtimin e një portofoli cilësor të kredive.

Rritja e shpejtë në huadhënie nga sistemi bankar Shqiptar (gjatë periudhës para krizës të 2006-2009) ndaj projekteve me risk, kryesisht në industrinë e ndërtimit dhe pasurive të paluajtëshme, shumica në mungesë të një ambienti të fortë të rregulloreve bankare, tashmë vunë në një risk të konsiderueshëm stabilitetin financiar të tyre

Duke ndjekur kërkimet e kryera në përmjet pyetsoreve në terren, në 12 bankat në vënd nga 16 që operojnë në sektorin bankar në Shqipëri, del konkluzioni se 4 banka tregtare nga 9 bankat me aktive në huadhënie krijuan Departamentin e Riskut përpara vitit 2006 dhe 5 bankat e tjera vetëm mbas vitit 2007.

Përveç kësaj vetëm në 5 banka, Departamenti i riskut të kredisë ka autoritet vendimarrës në komitetet e aprovimit të kredisë; në 4 banka Departamenti i Menaxhimit të Riskut të Kredisë nuk ka të drejtë votë (të drejtë rekomandimi), dhe në 4 banka të tjera Departamenti i Menaxhimit të Riskut ka të drejtë VETO (që do të thotë se në se risku refuzon kreditimin e një aplikimi për kredi, pavarësisht anëtarëve të tjerë të Komitetit të Kredisë, rasti refuzohet).

⁷² Arunkumar, R., and Kotreshwar, G.: “Risk Management in Commercial Banks”, Dec.2005.

Banka të caktuara instalojnë njësinë e riskut të kredisë jo si një funksion në dobi të rritjes cilesore të huadhënies por me tepër si një detyrim ligjor e rregullativ, dhe keto banka aktualisht ndeshen me probleme të mëdha në menaxhimin e portofolit të huave. Risku kredisë në keto banka kufizohet në dhënien e rekomandimeve autoritetit vendimarrës në bankë për çdo aplikim individual kredie, pa patur autoritet e të drejtë vendimarrëseje.

5.2.3. Monitorimi i portofolit të huave si dhe menaxhimi i huave me probleme

Monitorimi i huave është një proces që ka rëndësi të madhe në ruajtjen e cilësisë së portofolit të huave të dhëna dhe nivelin e kthyeshmërisë së tyre. Ndaj dhe ky proces përveç kontributit që ka dhënë në ruajtjen e cilësisë së portofolit të huave, ka kaluar për shkak të një mangesie që lidhet me ndarjen e punës në bankë, duke e kanalizuar procesin e monitorimit jo në struktura të specializuara, pora e të cilave do mbështetej në hartimin dhe zbatimin e procedurave moderne e të përshtatshme të monitorimit të kredive, si dhe duke mbabtur në fokus rritjen e nivelit të kualifikimit të stafit të punonjësve të kredisë që kryejnë këtë proces.

Për shkak edhe të madhësisë së disa bankave, të cilat janë relativisht të vogla, struktura operuese e bankave si dhe kualifikimi i punonjësve të kredisë që synon specializimin e tyre sipas profilit të riskut që paraqesin portofolet e kredisë, është i kufizuar ngaqë bankat kanë një buxhet të vogël e të pamjaftueshëm për një strukturë organizative dhe kualifikim të duhur të stafit të kredisë. Ndarja e strukturës së punës, do të thotë specializim më të thellë të proceseve të punës dhe kualifikim të punonjësve. Në shumicën e bankave për një periudhë të gjatë kohe deri para shpërthimit të krizës globale, ndjekja e kredive me probleme mbetej të e njëjta strukturë që monitoron gjithë portofolin e kredisë. Pamjaftueshmëria e njohurive të thella të punonjësve në ato fusha të industrive që kreditohen nga bankat, bënë që procesi i monitorimit të huave të jetë rrallë herë një rutinë jo shumë e dobishme dhe në funksion të ruajtjes së cilësisë së portofolit.

Dhënia e financimeve në një apo dy sektorët me përfitueshmëri më të lartë të ekonomisë, të tillë si ndërtimit/shitblerja e pronave dhe tregtia, ku shumica e bankave ngutin e vrapojnë për të kopjuar njëra tjetrën, dhe kjo vetëm për të rritur fitimet e tyre është një problem

kryesor, i cili ul efektivitetin e një monitorimi sado cilësor qoftë. Bankat ishin të pakujdesshme rreth prirjeve të zhvillimit të këtyre sektorëve, kështu këto banka humbën elementin e rëndësishëm që i privonte nga rreziku i moskthimit të huave dhe që është diversifikimi i portofolit të huave. Një huadhënie e tillë, e bënë të vështirë rezultatin që duhet të ketë në cilesinë e portofolit procesi i monitorimi. Procesi i monitorimit sado cilësor të jetë, rezultati i punës së tij do të varet nga cilësia e përzgjedhjes, analizës dhe vendimarrjes në dhënien e huave.

Nguti i madh i bankave për të arritur objektivat që synonin një rritje të shpejtë dhe fitim të lartë krijoj një situatë e cila favorizon atë që konsiderohet problemi i agjencisë, dhe që ka dhënë efektin e vetë në cilesinë huadhënëse në sistemin bankar Shqiptar (kjo ndikuar nga fakti se shumica e bankave janë të huaja, që do të thotë se shumica e bankave operuese menaxhohen nga jopronarët, interesat e të cilëve ndryshojnë nga interesat e pronarëve), Struktura organizative e bankave, e cila synon një kualifikim e ndarje më të specializuar të proceseve të punës, ka qënë një proces që ka marrë kohë, dhe krijimi dhe funksionimi i njësive të specializuara të monitorimit gjithashtu, gjë e cila ka sjellë një monitorim portofoli të kredive me hapësira për përmirësim.

Monitorimi i huave me probleme, për nga vetë natyra e vështirësive që kanë në menaxhimin e tyre, është kryer nëpërmjet strukturave të sektorit të kredisë, dhe cilësia e menaxhimit ka qënë ende larg nivelit të kërkuar për këto lloj kredish. Në këto kushte i njëjti staf që menaxhon huatë standarde kryen edhe menaxhimin e huave me probleme, duke ulur kështu eficientë në zgjidhjen e tyre dhe kthimin e likuiditetit të shpejtë për financimin e ekonomisë. Këto struktura në shumicën e bankave janë krijuar vonë pasi fenomeni i rritjes së shpejtë të huave me probleme u shqaf dukshëm.

Prirjet rënëse në financimet e reja të bankave shqiptare, në përmjet politikave shtrënguese të kreditimit, si përgjigje ndaj fenomenit rritës të huave me probleme, përveç që psikologjikisht ndikoj në rënien e besimit të biznesit në sipërmarrjet dhe iniciativat e tyre, dhe praktikisht mungesën e fushave dhe sektorëve fitimprurës për tu financuar çoji në një rritje të mëtejshme të huave me probleme duke krijuar një rreth vicioz nga i cili vështirëson daljen nga kjo situatë.

Në periudhën fillestare të shfaqjes së fenomenit të rritjes së shpejtë të huave, bankat vepruan në panik, duke kërkuar në disa raste shlyerje totale të huave, apo duke kaluar për ekzekutim të menjëhershëm kolaterale të mbulonin këto kredi, pa arritur të negocionin afate e kushte të përshtatshme ripagimi me klientët e tyre. Ndërsa nga ana tjetër bankat u gjendën të papërgatitur në pengesat e shumta ligjore që dilnin për ekzekutimin dhe shitjen e pronave si kolaterale për këto kredi, duke krijuar një ngërç të fortë dhe pengesë serioze në zgjidhjen e shpejtë të huave me probleme. Variablat që kanë ndikuar me efekt më të madh në rritjen e huave me probleme të identifikuara nga analiza jonë, janë:

- Fleksibiliteti i negocijimeve nga ana e bankave kur kanë të bëjmë me hua me probleme,
- Struktura organizative në banka dhe ndarja e qartë e punës midis njësive të Risk-ut dhe Shitje-s,
- Proçedurat e kreditimit gjatë huadhënies dhe cilësia e tyre në aspektin e të qenit të forta dhe të përshtatshme në raport me situatën ekonomike të biznesit vendas
- Prirjet huadhënëse të bankave në kohë, pra ndryshimi i stokut të portofolit të huave, duke ruajtur vazhdueshmërisë e financimit të biznesit.

Sikunder Impavido et al (2012) thekson *“Shqërtësimi i fundit me nivelin e lartë të huave me probleme, në mënyrë të vazhdueshme është vonesa potenciale që ato sjellin në ringritjen e ekonomisë, dhe konsiderohen si një çengel që tërheq pas apo pengon rritjen ekonomike”*.⁷³

Ky është rasti dhe momenti për Shqipërinë, ku niveli i lartë i huave me probleme si dhe vonesa në zgjidhjen e tyre po mban peng ekonominë e vendit, duke ngurtësuar fonde në asete jo prodhuese.

⁷³ Impavido, G., Klinge, C., Sun, Y.: “NPLs and the Macroeconomy” Chapter 2, 2012.

KAPITULLI VI. FAKTORËT NDIKUES NË NIVELIN E HUAVE ME PROBLEME NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

6.1 Hyrje

Në dy kapitujt e mësipërm nëpërmjet analizave empirike arritëm të identifikojmë gjithë variablat e varur me ndikim në nivelin e huave me probleme duke përdorur analizat krahasuese statistikore, nga ku baza e këtij gjykimi ishin të dhënat statistikore të publikuara nga BSH, BB, Ministria e Financave, INSTAT, dhe vetë Bankat Tregtare. Në gjithë studimet e kryera botërore në fushën e riskut të kredisë, është evidentuar se sa ndikim kanë faktorët makroekonomik globale dhe kombëtar në cilësinë e portofolit të huave, e në mënyrë të veçantë nivelin e huave me probleme si një tregues mjaft sinjifikativ. Ndaj dhe në kushtet e një niveli të huave me probleme kaq të lartë dhe në rritje, dihet që faktorët makroekonomik zënë një vend të rëndësishëm në këtë ndikim. Njëjtë janë trajtuar edhe faktorë që lidhen me sistemin bankar në tërësi, strukturën e tij, konkurrencën bankare dhe elementë të tjerë të rëndësishëm si regjistri i kredisë me një ndikim të ndjeshëm në nivelin e lartë të huave me probleme sot. Çfarë synohet në vijim të këtij studimi është ndarja e variablave që kanë efekt të barabartë në gjithë sistemin bankar nga variabla që lidhen me qasjen individuale të tyre në menaxhimin e portofolit të kredive dhe më tej matja e ndikimit të këtyre të fundit në nivelin e huave me probleme.

Në këtë kapitull gjen një shtrirje e analizë të gjërë, veçanërisht përgjigjet e pyetsorëve të kryera në menaxherë të niveleve të ndryshme në bankat tregtare në vend, të cilat janë konsideruar si të dhëna parësore për të matur ndikimin që kanë elementë të rëndësishëm të menaxhimit të huave nga secila bankë në nivelin e lartë të Huave me Probleme dhe me cilësinë e huadhënies nga vetë bankat, të tillë, si: Rolin e njësisë së riskut në aktivitetin kreditues, mirëdiversifikimi i portofolit të huave, procedurat dhe rregulloret në se janë të përshtatshme dhe bashkëkohore në procesin e huadhënies kontrollit dhe monitorimit të huave, sa i ndjeshëm është faktori që lidhet me problemet e agjencisë etj, do të jenë aspektet kryesore ku është fokusuar analiza dhe kërkimi i këtij punimi si një sektor ku bankat kanë në dorë të bëjnë ndryshimet dhe përmirësimet e duhura që synojnë një portofol cilësor dhe stabilitet afatgjatë të bankës në treg.

Hipoteza kryesore e këtij punimi është: Mireadministrimi i portofolit të kredisë, në kushtet e njohjes së faktorëve ndikues të jashtëm e të brendshëm, ka një rol kyç në uljen e rrezikut të huasë dhe kredive me probleme.

Për të arritur në konkluzione të sakta dhe shkencore mbi masën e këtij ndikimi u përdor një qasje tjetër nëpërmjet pyetsorëve në terren të cilat ju adresoheshin niveleve të ndryshme të menaxhimit të portofolit të kredive në bankat tregtare, që synonin identifikimin dhe konfirmimin e variablave ndikues në nivelin e huave me probleme. U realizuan 50 pyetsore⁷⁴ të plotësuar me përgjigje nga menaxherë të niveleve të ndryshme në 16 bankat tregtare në vend me fokus kryesor bankat që kanë një peshë më të madhe në huadhënie. Numri 50, doli domethënës (sinjifikant) nga modeli, dhe nxori rezultate të cilat u përfshin në tabelë ndaj u mjaftuam me këtë numër të intervistuarish. Pyetsori përmbante 22 pyetje nga të cilat grupoheshin sipas problematikave që lidheshin me:

- Rolin e njësisë së riskut, vitin e krijimit të kësaj njësie në bankë, mbi cilësinë e autoritetit të tij, si njësi vendimarrëse apo rekomanduese, me të drejtë Veto ose jo,
- Rregulloret dhe procedurat e kredidhënies në gjykimin e tyre a janë të përshtatshme, apo të forta, që i referohen nivelit të kreditimit, mbulimit me kolateral, aftësisë paguese e kushteve të tjera përtej atyre të përcaktuara nga Autoriteti Mbikqyrës i BSH.
- Ndarjen e punës dhe strukturën organizative brenda sektorit të kredisë në banka, nëse Shitja e Risku operonin si dy njësi të veçanta dhe që përcojnë analizat e aplikimeve për kredi në aspekte të ndryshme të çdo aplikimi individual në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra, ku fillon dhe mbaron procesi i punës së njëres njësi dhe njësisë tjetër nëse ka mbivendosje të punës nga njëra tjetra.
- Menaxhimi i huave me probleme nëse kryhet nga njësi të specializuara, kur fillon dhe mbaron procesi i punës së kësaj njësie, sa fleksibël është banka në negocijime me kredimarrësit në vonesë, etj

⁷⁴ nga të cilët: 5 CRO (Credit Risk Officer), 2 CFO (Chief Finance Officer), 10 Drejtorë Degësh, 10 Drejtorë njësish Risku, 10 analistë kredie nivel senior, dhe 8 drejtorë njësish rekuverimi.

- Trainimi i stafit të kredisë, sa i organizuar e planifikuar është në bankë, si përzgjidhet stafi i punonjësve të kredisë, sa të njohur janë menaxherët me nivelin e portofolit të kredisë dhe huave me probleme në bankën e tyre etj.

U përpunuan gjithë të dhënat e analizuar të cilësisë së portofolit në një bazë më të gjerë dhe të detajuar. U përzgjodh një kampion ($n = 50$), në mënyrë që të nxirrej informacion mbi të gjithë bashkësinë që përmbledh observimet e mundshme në lidhje me një variabël, ose fenomen të caktuar. Ky kampion ishte i rastësishëm me qëllim që të rezultonte përfaqësues për bashkësinë nga i cili ishte shkëputur. Kur një model statistikor rezulton sinjifikativ (domethenes), do të thotë që vlen për atë numer (n) kamponi që është marre në studim, sepse testet e sinjifikativitetit llogariten pikerisht për atë numer. Me pas bazohemi në tabelat e shpërndarjes për të verifikuar nëse për atë numer (n), kampioni është sinjifikativ ose jo për një test. Pikerisht vlera që rezulton nga llogaritjet kontrollohet në tabelat e shpërndarjes. Nëse rezulton domethënëse, variabli ka kontribut në atë model, për atë numër kampioni. Përpunimi i gjithë të dhënave të analizuar të cilësisë së portofolit u krye në një bazë më të gjerë dhe të detajuar. Si burime dytësore në analizen tonë janë marrë të dhënat statistikore të publikuara nga Institucione financiare si Banka e Shqipërisë dhe bankat tregtare, për dy vitet ekstreme 2009, viti në të cilin shpërtheu kriza financiare dhe 2012, viti në të cilin efektet reale të krizës janë manifestuar më shumë në cilësinë e portofolit të huave të sistemit bankar Shqiptar. Duke kombinuar këto të dhëna me përgjigjet e marra nga pyetsorët që i drejtoheshin menaxherëve të kredive në nivele të ndryshme, rreth procesit të huadhënies në bankat e tyre për të gjithë 16 bankat tregtare operuese në Shqipëri.

Është bërë një përpjekje për të përcaktuar efektet reale që kanë ndikuar në prirjen rritëse të menjëhershme të huave me probleme, duke kombinuar variablat sasiore me të tjerë variabla cilësore, të tillë si efektet që lidhen me rregulloret dhe praktikatat që zbatohen gjatë procesit të huadhënies, qasja e riskut të kredisë në procesin e huadhënies dhe çështjet që lidhen me zgjidhjen e huave me probleme, dhe nga të tjerë variabla referuar kushteve të tregut, të tillë si prirja e PBB, Remitancat, borxhi Sovran etj.

Gjithë informacioni i mësipërm i marrë nga pyetsorët, si dhe nga BSH, INSTAT, Ministria e Financave dhe bankat tregtare u përpunuan duke përdorur modelin statistikor SPSS, për këtë qëllim, dhe rezultatet treguan dhe provuan një varësi e korelacion mjaft të fortë dhe impresionues për shumicën e variablave. Më konkretisht për secilin variabël do të paraqitet analiza deskriptive / përshkruese dhe koeficientët e varësisë si dhe formulat që përcaktojnë lidhjen dhe varësinë e këtyre variablave ndaj faktorit kryesor që është Niveli i huave me probleme.

6.2 Analiza përshkruese / deskriptive e variablit të PBB


PBB konsiderohet si një faktor i cili ndikon në mënyrë të barabartë në gjithë sistemin bankar te niveli i huave me probleme. Ky variabël është konsideruar si një variabël që përmbledh në mënyrë të sintetizuar gjithë faktorët makro, që i referohen kushteve të tregut marrë nga prirja e PBB gjatë të njëjtës periudhë të analizës së portofolit të kredisë. Më konkretisht Prodhimi i Brendshëm Bruto është një tregues ekonomik që paraqet vlerën me çmimet e tregut të të gjitha të mirave materiale dhe shërbimeve të prodhuara brenda një shteti në një periudhë të caktuar (zakonisht një vit). Variabli i PBB-së është një nga treguesit kryesorë makroekonomik për të matur prirjen e ecurisë ekonomike të tregut në tërësi dhe ndikimin e tij në nivelin e huave me probleme. Duke përdorur të dhënat statistikore mbi prirjen historike të PBB në mbi 10 vitet e fundit si dhe të dhënat mbi nivelin e huave me probleme në Shqipëri, u bë përpunimi i tyre nëpërmjet këtij modeli statistikor, nga ku rezultatet treguan dhe provuan një varësi e korelacion mjaft të fortë dhe impresionues të këtij variabli ndaj nivelit të huave me probleme. Verifikimi i hipotezës për modelin u realizua duke u bazuar në dy alternativa:

- Hipoteza 0 - Nuk ka relacion linear midis nivelit të huave me probleme dhe variablit të PBB-së
- Hipoteza 1 – Ka relacion linear midis nivelit të huave me probleme dhe variablit të PBB-së

Testi F- provoj se hipoteza 0 refuzohet, ndërsa provoj se Hipoteza 1 pranohet, për $PBB = 0$ ky variabel nuk ka kontribut, ndërsa për $PBB \neq 0$, variabli ka kontribut ne nivelin e huave

me probleme. **Variabli i PBB**, është marrë i shkëputur nga variablat e tjerë, dhe kjo pasi, sikundër e theksuam më lartë treguesi i PBB ndikon në mënyrë të njëjtë në nivelin e huave me probleme për çdonjëren bankë tregtare. Sic shihet në Grafikon nr 15 në vijim, analiza përshkruese tregon qartazi korrelacionin linear që kanë treguesit të PBB me nivelin e huave me probleme.

Grafiku Nr. 15. Analiza përshkruese/deskriptive e faktorit të PBB në raport me nivelin e Huave me Probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë, raportet vjetore të bankave tregtare.

(Treguesit e prirjes së PBB, i referohen Variablit të kushteve të tregut, gjatë të njëjtës periudhë të analizës së portofolit të kredisë).

Është e qartë se huatë rezultojnë të kenë ecuri më të mirë gjatë periudhave kur PBB i një vendi është më i lartë. E parë në këndvështrimin e kërkesës, rritja e PBB do të ishte i barabartë me rritjen e Konsumit, Investimeve, Shpenzimeve Qeveritare dhe rezultantes pozitive të vlerës së Eksporteve me atë të Importeve. Pra gjatë një periudhe rritëse të PBB (refelektuar kjo edhe në një rritje të përgjithshme të ecurisë së treguesve të ekonomisë, përfshirë këtu edhe një rritje të likuiditetit), tregu është llogjikisht më i prirur të përgjigjet pozitivisht në shlyerjen e detyrimeve financiare të marra përsipër. Ai ka mundësi të prekshme materiale dhe psikologjike për t'u përgjigjur kundrejt pagesës së huave.

Sikundër e dallueshme edhe në grafikun e mësipërm, shumica e bankave ka reflektuar nivele të huave me probleme më të ulëta gjatë periudhës kur PBB është në nivele më të larta dhe e kundërta kur tendenca e PBB-së është rënëse, huatë me probleme rriten ndjeshëm. Më në detaje vlerat e huave me probleme rezultojnë të jenë mbi 10% kur niveli i PBB-së është nën 5%. Me rritjen e nivelit të këtij variabli, huatë me probleme rezultojnë të jenë në nivelet e 6% për pjesën më të madhe të Bankave të marra në analizë. Sipas grafikut vërehet në mënyrë të qartë tendenca e rënies së huave me probleme me rritjen e PBB-së.

6.3 Analiza deskriptive e variablit të prirjes kredituese të bankave ndaj nivelit të Huave me Probleme

Në vijim do të sjellim të gjithë variablat e identifikuar nga analiza përshkruese që janë në korrelacion me nivelin e huave me probleme. Këto variabla lidhen direkt me prirjen historike huadhënëse të aktivitetit kreditues në nivel të çdo banke ndaj biznesit, ndikimi i të cilëve në nivelin e huave me probleme është i ndryshëm në banka të ndryshme dhe konkretisht:


Variabli “Ndryshimi i nivelit të portofolit” është në korrelacion të zhdrejtë me nivelin e huave me probleme (shih grafikun Nr. 16, në vijim).

Ky variabël tregon qasjen e bankave në kreditimin e biznesit, i cili për banka të cilat kanë vijuar të kenë qasje pozitive e të përshtatshme ndaj biznesit duke vijuar me rritje të portofolit të huave edhe gjatë krizës globale, niveli i huave me probleme ka qënë relativisht i ulët. Ndërsa për banka të cilat janë treguar konservatore me fillimin e krizës globale duke ulur ritmet e kreditimit nëpërmjet masave shtrënguese për kolateral shtesë dhe kushte të tjera, niveli i huave me probleme është rritur përtej mesatares së nivelit të huave me probleme për gjithë sistemin bankar. Bankat, kapitali i të cilave vjen nga mëma nga vendet me origjinë ku kriza financiare globale ka dhënë efekte më të forta mungese likuiditeti, ulën dhe stopuan ritmet e kreditimit, e cila solli për pasojë uljen e stokut të tyre të portofolit, duke krijuar që niveli i huave me probleme të reflektojë një normë relativisht më të lartë edhe në kushtet e rënies së tyre në vlerë absolute. Në këtë kontekst huatë me probleme në raport mbi një bazë më të vogël të portofolit të huave reflektuan nivel më të

lartë në përqindje të huave me probleme, se sa realiteti. Në banka të tilla niveli i huave me probleme arriti në 33-42% të stokut të huave dhe janë bankat me kapital nga mëma kryesisht nga vende si Greqia e Italia, që njihen për ashpërsimin e krizës financiare në raport me vende të tjera të rajonit. Vëmë re se nga grafiku që tregon se si prirja e huadhënies ndikon në nivelin e huave me probleme, vetëm një vlerë është jashtë tendencës në grafik, e cila është vlera që lidhet me FIB (First Investment Bank), portofoli i kredisë së të cilës është në vlerë të pa konsiderueshme në raport me portofolin e kredive të bankave të tjera dhe nivelin e Huave me Probleme të rezultuara nga ato.

Sipas grafikut të mëposhtëm vërehet se me rritjen e vlerës së portofolit të kredive, niveli i huave me probleme ka tendencën të bjerë. Vlen të theksohet se rritja e disbursimeve të reja, bënë që të rritet vlera e mbetur (outstanding) e portofolit të kredive duke sjellë për rrjedhojë edhe rënien e raportit të kredive me probleme mbi totalin e këtij portofoli.

Grafiku Nr. 16 Ndryshimi i nivelit të portofolit në raport me nivelin e huave me probleme




Kjo reflekton një rënie të huave me probleme në vlerë, por cilësia e portofolit të ri është ende e panjohur, duke qënë se kërkon një kohë llogjike përformimi për t'u provuar. Pra përmirësimi i huave me probleme është i prekshëm me rritjen e kreditimit dhe për rrjedhojë vlerës së portofolit, por theksi i Institucioneve Financiare në çdo rast duhet të fokusohet në cilësinë e disbursimeve të reja nëpërmjet analizës, matjes dhe monitorimit skrupoloz të çdo kredie.

6.4 Analiza deskriptive / përshkruese e variablit të llojit të procedurave ndaj nivelit të Huave me Probleme

Variabli “Procedurat e huadhënies janë të forta apo normale” ishte në korrelacion me nivelin e huave me probleme. Ky variabël, në një gjykim më të plotë ka lidhje me variablin në vijim të rolit të riskut në aktivitetin kreditues në banka. Pasi aty ku risku ka operuar më herët si njësi e veçantë dhe me rol të rëndësishëm aktiv në aktivitetin kreditues të bankave, procedurat dhe praktikat e kreditimit kanë qënë më të forta. Shumica e menaxherëve u përgjigjën për procedura normale, bankat e tyre treguan nivele të ndryshme të huave me probleme, që varionin nga 15% deri në 42% të portofolit të huave. Ndërsa menaxherët e tjerë që u përgjigjën për procedura të forta në huadhënie, niveli i huave me probleme është stabil në jo më shumë se 10 deri 15%, duke rezultuar me nivelet më të ulëta të huave me probleme krahasuar me nivelin prej 23% të huave me probleme të sistemit bankar në tërësi. Më e konkretizuar kjo varësi duket në grafikun në vijim, (shih grafikun nr 17). Pra sa më të forta, shtrënguese dhe të zbatohen rigorozikisht politikat, procedurat, rregullat e një Banke aq më i kontrolluar është niveli i kredive me probleme.

Grafiku Nr. 17 Procedurat e huadhënies janë të forta apo normale në korelacion me nivelin e huave me probleme



shifra minimale dhe maksimale (deri në 40%). Pra rreziku që vlerat e huave me probleme të lëvizin mbi mesataret e tregut është më i lartë, duke u përkthyer në rrafshim të kapitalit

të Bankave dhe rezultate në vlera më të ulta. Në përgjithësi Bankat mundohen të zbusin procedurat e kredidhënies, për të lehtësuar disbursimin e një kredie, në mënyrë që të jenë me konkurrese në një treg me vështirësi të caktuara dhe ku aktoret e ekonomisë janë të kufizuar. Kjo “luftë” e heshtur ndërmjet Institucioneve Financiare, të cilët përpiqen të “punojnë” dhe njëkohësisht të jenë në linjë me procedurat (pra duke mos i shkelur ato) penalizon cilësinë e kredidhënies, e cila përkthehet llogjikisht në problematika në kthimin e huasë. Pra, në konkluzion, praktika më e mirë rezulton të jetë vazhdimësia e kredidhënies, por duke treguar kujdes në cilësinë e saj nëpërmjet mitiganteve të ndryshëm të rrezikut. Praktika ka treguar se vendosja e kushteve dhe penalizimeve që nënkupton mosplotësimi i këtyre kushteve, sjell performancë më të mirë të kredive të dhëna. Sigurisht kjo duhet të jetë fryt i një analize të thellë e gjithëpërfshirëse dhe duhet të shoqërohet me një ndjekje e monitorim të fortë të klientit.


6.5 Analiza deskriptive e variablit të Autoritetit të njësisë së Riskut ndaj nivelit të Huave me Probleme

Variabli që i referohet Autoritetit të njësisë së Riskut në procesin e huadhënies, nëse është Autoritet Aprovues apo Rekomandues, efekti i këtij variabli në nivelin e huave me probleme nuk ishte domethënës / sinjifikant. Kjo gjetje argumentohet me faktin se njësitet e Riskut në shumicën e bankave u instaluan mbasi shumica e portofolit ishte krijuar. (shih grafikun nr 18 në vijim). Për më tepër që cilësia e autoritetit të riskut nëse rekomandues apo aprovues, nuk e vë njësinë e Riskut në rol për sa i takon vendimmarrjes së kreditimit individual. Por në këtë kënd vështrim ky variabël nuk është i ndjeshëm ndaj nivelit të huave me probleme dhe kjo gjetje gjen bazë logjike. Megjithatë eksperiencia ka treguar se kujdesi i treguar në rastin e një njësie risku aprovuese është më i lartë, krahasuar me skenarin kur e njëjta njësi risku ka vetëm rol rekomandues në vendimin e disbursimit të një kredie. Pikerisht këtu hyn në lojë faktori psikologjik. Vlerësuesit e dedikuar të riskut në një Bankë, janë në mënyrë të natyrshme më të prirur drejt kujdesit dhe analizës skrupuloze në rastin kur ata janë përballë një autoriteti aprovues në kredidhënie.

Në konkluzion, nëse njësia e riskut të një Banke ka autoritet aprovues, cilësia e portofolit të kredive priret të jetë më e mirë, por fakti që vendimet merren në formë kolegjiale bën që

përgjegjësia personale e secilit prej anëtareve të riskut të moderohet e të jetë më e zbutur në të gjithë aspektet.

Grafiku Nr. 18. Cilësia e Autoritetit të njësisë së Riskut në Aprovues apo Rekomandues mbi cilësinë e Portofolit të huave



Një variabël tjetër, mjaft i rëndësishëm që u mor në konsideratë në këtë analizë, është ai që lidhet me cilësinë e Autoritetit të njësisë së Riskut në banka në procesin e huadhënies, duke e vlerësuar Autoritetin e Njesisë së Riskut në rolin e tij primar dhe më cilësor, të faktit në se ka të drejtë VETO ose JO VETO gjatë procesit të vendimarrjeve për çdo aplikim individual kredie. Vetëm katër banka u përgjigjën se Risku ka të drejtë VETO për të refuzuar aplikime kredie për raste kur vlerësimi i tyre është negativ. Kështu huatë me probleme në bankat ku Risku ka të drejtë VETO, niveli i huave me probleme rezultonte me nivele të stabilizuara me 10 deri 15%, Ndërsa në bankat ku Autoriteti i njësisë së Riskut nuk ka të drejtë VETO, huatë me probleme variojnë nga 10 deri në 41%. (shih grafikun nr 19 në vijim). Me pak fjalë, e drejta dhe detyrimi i VETO-s në njësitë e riskut të kredisë bën që huatë me probleme të luhaten rreth shifrave mesatare të tregut, ndërkohe që e kundërta ndodh kur VETO-ja mungon. Kjo e fundit sjell që vlerat e huave me probleme të luhaten me larg mesatares, duke nënkuptuar, për rrjedhojë, rrezik më të lartë e rezultat me të ulët për aksioneret e Bankës.


Me pak fjalë, mund të pohojmë çfarë konkluduar rreth grafikut Nr. 18 (Cilësia e Autoritetit të njësisë së Riskut në se Aprovues apo Rekomandues mbi cilësinë e Portofolit

të huave) sipas të cilit në se njësisë së riskut i jepet e drejta e VETO-s është përfundimisht i prirur të reagojë me më shumë kujdes kundrejt miratimit ose jo të një kërkesë për kredi nga një klient i caktuar. Përgjegjësia në vendimarrje bën që anëtarët e njësisë së riskut të jenë më të përgjegjshëm e ndërgjegjshëm kundrejt zgjedhjes së ekuilibrit më të mirë ndërmjet të bërit biznes të një Banke, përfitimit më të lartë dhe shkallës së rrezikut që i përket ky përfitim.

Ata priren të analizojnë dhe matin “urinë për rrezik” të një Banke dhe punojnë t’i përshtasin kësaj “urie” klientët me cilësorë dhe fitimin më të lartë të mundshëm.

Në konkluzion, një nga faktorët që mund të përdorë një Bankë për të kontrolluar nivelin e Huave me Probleme është dhënia e VETO-s në vendimarrje për njësitë e riskut te kredisë. Në këtë mënyrë, anëtarët vendimarrës të riskut do të jenë individualisht më të kujdesshëm, duke parashikuar përgjegjësinë e përballjes me Autoritet e jashtëm mbikqyrës e kontrollues.

Grafiku Nr. 19 Cilësia e Autoritetit të njësisë së Riskut VETO ose JO, në korelacion me cilësinë e portofolit të huave.



6.6 Analiza deskriptive e variablave të tjerë të cilët nuk rezultuan me varësi të dallueshme apo më pak të dallueshme ndaj nivelit të Huave me Probleme

6.6.1 Analiza deskriptive e variablit që lidhet me trainimin e stafit të kredisë në banka

Përveç Variablave të mësipërm të cilët rezultuan në korelacion të dallueshëm me nivelin e huave me probleme, një prej variablave të përfshirë në analizë dhe në model nuk rezultojnë në korelacion. Konkretisht bëhet fjalë për variablin e “Trainimit të stafit të punonjësve të sektorit të kredisë”, i cili në banka ku trainimet ishin më të shpeshta niveli i kredive me probleme nuk tregonte varësi të njëjtë ndaj këtij variabli. Një shpjegim i kësaj gjetjeje gjëjmë të faktit se me futjen në treg të hyrësve të rinj në sistemin bankar të bankave të mëdha apo të mesme në treg sidomos gjatë viteve 2003-2005, punësimi i stafit të ri, u mor nga ato ekzistues të sistemit bankar, ku nëpërmjet ofrimit të pagave më të larta u arrit të përzgjedhnin punonjësit më të kualifikuar e me eksperiencë. Kështu bankat që në strategjinë e tyre kryenin trainime të shpeshta të punonjësve të tyre, lëvizja e tyre drejt bankave që ofronin paga më të larta ishte fenomeni që mund të ketë dhënë këtë rezultat në këtë analizë. Në këtë studim nuk është trajtuar thellë analiza e efektivitetit të punonjësve të kredisë si një elemente i vecantë në peshën që ka ky variabël në cilësinë e portofolit të huave, dhe kjo do të jetë objekt i një hulumtimi të vecantë, për shkak se është një çështje që kërkon një analizë të gjërë të fenomenit shkak – pasojë. Vlerësohet se jo gjithmonë një pagë e mirë apo shpërblim i lartë i punonjësve të kredisë con detyrimisht në një qëndrim e qasje më pozitive në procesin e analizës së aplikimeve për kredi. Trajtimi i punonjësve të kredisë duhet parë në një këndvështrim të gjërë dhe që përfshin jo vetëm elemente motivues financiarë po edhe elementë jo financiarë të promovimit të tyre në punë. Përpos faktit që disa banka kanë zbatuar skema të shpërblimit të punonjësve të kredisë bazuar në volumin e kredive të dhëna për analistë të shitjes ndërsa kanë neglizhuar shpërblimin e punonjësve të kredisë që monitorojnë protofolin e huave të dhëna, bazuar në tregues të cilësisë së këtij portofoli, të tilla si niveli i huave me probleme, ditët në vonesë të portofolit në menaxhim etj. Gjithashtu ndryshimi në kohë të skemave të shpërblimit të punonjësve të kredisë ka

qënë një faktorë që vlerësohet se mund të ketë ndikuar në një demotivim të punonjësve të kredisë.

Në punimin e tij mbi kapitalin human, Agalliu A (2013)⁷⁵, gjejmë pothuaj të njëjtat konkluzione, ku janë identifikuar problematika të mëdha në trajtimin e punonjësve në sistemin bankar Shqiptar, për sa i takon motivimit të tyre në punë si dhe kualifikimit të tyre, ku ndër të tjera vë theksin në vështirësinë në gjetjen e informacioneve të plota mbi kualifikimet e punonjësve në banka, duke e interpretuar këtë mungesë si të qëllimshëm për të fshehur nivelin e ulët profesional të punonjësve në sistemin bankar, dhe kjo pasi bankat punësojnë punonjës pak të kualifikuar me synim që të ofrojnë paga më të ulëta në favor të uljes së kostos së punës.

Sa i vërtetë ky pohim po aq edhe i diktueshem, pasi mund të lërë vend për debate e diskutime të mëtejshme mbi këtë çështje, nëse mungesa e transparencës së bankave referuar cilësisë së burimeve njerëzore është e qëllimshme për të fshehur nivelin e ulët të punonjësve të tyre apo nëse një neglizhence burokratike dhe se tregu i punës nuk plotëson nevojat e bankave për punonjës të kualifikuar. Gjykojmë se analiza e këtij variabli është mjaft delikat, dhe shpesh subjektiv për shkak se lidhet direkt me natyrën njerëzore e cila është mjaft subjektive në vlerësimet dhe gjykimet e tyre, ndaj dhe studimi i këtij variabli paraqet vështirësi në arritjen e konkluzioneve të sakta dhe nevoja për më shumë studime në këtë fushë është shumë e domosdoshme, si një aspekt i veçantë dhe kompleks ku përfshihen ndikimet që ka një ekip punonjësish i mirëtrajtuar në suksesin e një banke që përkthehet në një korelacion të zhdrejtë me nivelin e huave me probleme dhe cilësinë e portofolit të tyre.

Po në këtë punim të Agalliu A (2013)⁷⁶, gjejmë me vlerë konkluzionin e nxjerrë nga intervistimet e punonjësve se vetëm 12% e punonjësve largohen nga banka për pagë më të lartë ndërsa 88% e tyre largohen për arsye të tjera, ky pohim është mjaft i rëndësishëm nga ku del nevoja për përmirësime thelbësore në trajtimin e kapitalit human.

⁷⁵ Agalliu A, “Kapitali Human Perballe sfidave të sistemit bankar në Shqipëri” (2013), fq. 141

⁷⁶ Po aty, fq. 143


Megjithë kontributin e dhënë në drejtim të krijimit të një niveli profesional e teknik të punonjësve, sektori bankar si industria më e formalizuar në vend në krahasim me sektorë të tjerë të ekonomisë, përsëri është evidente fakti që ka vend për të përmirësuar ndjeshëm praktikën e punësimit, dhe motivimit të punonjësve nëpërmjet stimulave materialë dhe jo materialë

6.6.2 Analiza deskriptive e variablit që lidhet me ditët e kalimit të kredive në njësinë e rekuperimit sipas ditë vonesave

Një tjetër variabël i marrë në konsideratë që ka ndikuar në nivelin e lartë të Huave me Probleme, por jo sinjifikantë si variablat e parashtruar më sipër, lidhet me kohën e ndjekjes së këtyre kredive nga momenti që ato paraqesin vonesa të ripagimit të tyre nga njësitë e specializuara në banka. Pak banka kanë patur njësinë e rekuperimit të kredive me probleme, si njësi të specializuara, ndësa krijimi dhe funksionimi i të cilës është vendosur mbas vitit 2009 në shumicën e bankave, dhe kjo pasojë e nevojës së natyrshme që doli si pasojë e rritjes së menjëhershme të Huave me Probleme pas këtij viti. Kalimi për ndjekje nga kjo njësi e specializuar në shumë banka bëhej me vonesë, pas 90 ditëve, gjë që tregoj një rezultat jo të kënaqshëm në rekuperimin e tyre të plotë apo pjesor. Analiza tregoj se sa më shpejt këto hua me probleme të kalojnë e trajtohen nga njësitë e specializuara në bankë për rekuperim, aq më i ulët niveli i tyre, dhe e kundërta. Kjo gjetje bëhet e qartë në grafikun nr 20, në vijim, në të cilin del shumë qartë se kalimi i këtij portofoli në njësinë e rekuperimit pas 60 ditësh rezulton si më efikas në drejtim të nivelit të huave me probleme, ku shumica e bankave që zbatonin praktikën e kalimit pas 60 ditëve vonesë kanë nivele të huave me probleme më të vogla se sitemi. Përfshirja e një strukture të re në ndjekjen e huave dhe rikthimin e kapitalit të investuar në Banke ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në të dyja kunderpartitë (Banke-Klient). Nga njëra anë menaxherët e kredive (analistët dhe njësitë shitëse, të cilët janë përgjegjës për kontaktin me klientin) përcjellin rastin pranë një njësie tjetër pasi ezaurojnë në kohë dhe në përpjekje të gjitha mundësitë për t'a rikthyer shumën e nevojshme brenda afatit të paracaktuar. Kjo ndihmon Bankën drejt një evitimi të ndërlikimit verbal e personal të një punonjësi me një klient aktual. Nga ana tjetër, klienti fillon të kontaktohet nga personel i ri (i panjohur deri në këto momente për të) i Bankës

dhe kjo i jep një shtyrje procesit të pagesës, duke qënë se impakti psikologjik për klientin është më i lartë. Në një farë mënyre ai shtyhet të rivërë në plan të parë korrektesën kundrejt partnerit Bankë, duke kanalizuar likuiditetet e tij në favor të saj, ose përpiqet të gjejë mënyra dhe burime të reja shlyerjeje në rastet kur mundesitë e tij shlyerëse kanë ndryshuar krahasuar me momentin e analizës.

Grafiku Nr. 20 Niveli i Huave me Probleme në varësi të ditëve në vonesë para kalimit në njësinë e Rekuperimit.



Sipas grafikut konkludojmë se përcjellja e ndjekjes dhe kontaktit me një klient në vonesë, pranë njësisë së rekuperimit, paraqet vlera të huave me probleme më të përqëndruara rreth mesatares së tregut në rastin kur kjo njësi ndërhyr pas 60 ditësh vonesë në shlyerje. Rasti i ndërhyrjes pas 90 ditësh vonesë paraqet vlera me ekstreme krahasuar me mesataren, duke nënkuptuar rrezik më të lartë për Bankën. Ndërkohë, nëse do të interpretonim rastin e ndjekjes nga njësitë e rekuperimit që pas ditës së 30 të vonesës nga klienti, përveç faktit që rezultoi se nuk përdoret nga shumë Banka, mund të themi se konkluzioni nuk ndihmon drejt një korrelacioni të drejtë. Në lidhje me këtë të fundit, eksperiencia ka treguar se 30 ditë nuk janë të mjaftueshme për të pohuar paaftësinë konkrete të mos shlyerjes ose mos korrektesës së një klienti. Klienti është i prirur të krijojë një marrëdhënie partneriteti me Bankën, që presupozohet të jetë afatgjatë dhe përcjellja e tij, fill pas 30 ditësh, në një njësi

të re bënë që realisht, llogjikisht dhe psikologjikisht të vihet në lëkundje kjo marrëdhënie. Pra, në këtë aspekt, presupozohet që Banka të provigjonojë më shumë klientin e kategorizuar në PAR (portofoli në risk), por të vazhdojë të menaxhohet nga e njëjta strukturë shitëse dhe të vendosë t'a besojë tek një tjetër njësi pas 60 ditësh. Ky afat është i mjaftueshëm për të kuptuar korrektesën e një klienti dhe përpjekjet e dështuara të njësisë shitëse për të rikthyer fondet e investuara në Bankë.

6.7 Interpretimi i Koeficientëve të rezultuar për çdo variabël në korelacion me nivelin e Huave me probleme, dhe formula që përcakton masën e ndikimit të tyre në nivelin e huave me probleme.

Koeficientet e çdo variabli në korelacion me nivelin e Huave me probleme, rezultuar nga analiza e bërë nëpërmjet modelit statistikor SPSS janë si në vijim: (shih tabelën nr. 19). Sic vihet re nga tabela e mëposhtëme, variablat e përzgjedhur nga analiza që ndikojnë në nivelin e huave me probleme janë pesë dhe konkretisht: Struktura e qartë midis njësive Risk dhe Shitje; Proçedura të forta kundrejt atyre normale; Nr i ditëve në vonesë të HP para se të kalojnë në njësinë e rekuperimit; natyra e negocijimeve me kredimarrësit me probleme, në se fleksibël apo të ngurta, dhe tendenca e huadhënies që shprehet si faktor i ndryshimit të stokut të portofolit.

Ndarja e qartë midis dy strukturave Risk dhe Shitje në aktivitetin kreditues të një banke, nga studimi doli se ka efekt në uljen e nivelit të huave me probleme me koeficientin - 22,155. Në se nuk ka një ndarje të tillë efekti është 0 (zero). Ky është një nga variablat kryesore, i cili rezultoi të kishte ndikim në përmiresimin dhe menaxhimin e Huave me Probleme.

Tabela nr 19. Koeficientët e korelacionit të çdo variabli të marë në analizë me nivelin e huave me probleme

Variablat	Koeficientët e pastandardizuar		Koeficientët e Standardizuar	T	Sig
	B	std error	Beta		
Konstantja	-18.592	7.135		-2.606	0.06
Strukturë e qartë Shitje e Risk?	-22.155	7.472	-0.911	-2.965	0.41
Procedura të forta vs normale?	-30.862	4.87	-1.166	-6.338	0.003
Nr ditëve vonësë të huave me probleme	0.260'	0.072	0.508	3.338	0.22
Negocijime fleksibël të huave me probleme	35.363	5.443	1.543	6.497	0.03
Ndryshimi i stokut të portofolit	-0.044	0.16	-309	-2.7	0.054

Eksperiencia e deritanishme në sistemin bankar ka treguar se shumica e bankave, (bëhet fjalë sidomos për periudhën e bumit të kredive 2003-2008), aplikonin një strukturë të vetme për menaxhimin e kredive, që nga aplikimi deri në shlyerjen totale të saj, dhe vetëm 2-3 banka patën një ndarje të qartë të strukturave kredituese Risk Shitje që në nisje të aktivitetit kreditues. Ndarja e qartë ndërmjet strukturave që kanë kontaktin e drejtpërdrejtë me klientin dhe atyre që qëndrojnë "në hije" duke analizuar dhe konkluduar të gjithë procesin pa kontaktuar klientin u përqs dhe u adoptua me hapa të ngadaltë nga Bankat që operojnë në Shqipëri. Kjo nuk ndodhi vetëm për shkak të kompleksitetit dhe kohës së nevojshme që kërkon ndarja dhe mirëpërcaktimi i detyrave që duhet performuar nga secila strukturë për të plotësuar procesin e plotë të procedurave të një kredie (duke filluar nga kontakti i parë me klientin, e duke vijuar me analizën, miratimin, disbursimin dhe monitorimin e rikthimit të shumave përkatëse në Bankë), por edhe për shkak të natyrshme nga një mentalitet i "mësuar" prej kohësh në mënyrën e operativitetit normal të një Banke, ku një strukturë konkludon çdo hallkë të procesit.

Ndarja e qartë e detyrave mes dy strukturave Risk-Shitje u adoptua nga eksperiencia ndërkombetare e sistemeve bankare. Disa nga bankat operative me kapital të huaj në Shqipëri operuan që në zanafillë me ndarje të detyrave ndërmjet këtyre dy strukturave. Modeli operacional i këtyre Bankave imitoi modelin e Bankave mëmë në shtetet ku këto të fundit ushtrojnë veprimtarinë. Më pas përshtatja e këtij modeli me kushtet dhe ambjentin e ri që gjetën në Shqipëri, kërkoi kohën dhe modifikimet e nevojshme për të mundësuar "jetesën" në treg.

Theksi u vendos në mirëpërcaktimin e detyrave të secilës strukturë, duke u munduar të garantohej në maksimum evitimi i kontaktit me klientin në mënyrë paralele nga të dyja strukturat. Pikërisht ky ishte edhe celësi që do të sillte impakt në përmirësimin e cilësisë së portofolit të kredive. Në këtë mënyrë aksionerët dhe Menaxhmenti i Lartë i një Banke garantonte analizën e paanshme dhe të ftohtë të një kërkesë për kredi. Kontakti i drejtpërdrejtë me klientin ndikon në gjykimin dhe arsyetimin e aprovimit të një kredie. Ndërkohë, analiza ftohtë pa asnjë kontakt, por vetëm duke u mbështetur në dokumentacionin dhe informacionin e përcjellë nga shitja, bënë që gjykimi të jetë i plotë dhe në favor të Bankës.

Pikërisht kjo ishte kthesa e një mentaliteti të adoptuar që në gjenezë. Bërja e të gjitha detyrave nga e njëjta strukturë nuk garanton më tej cilësinë e kërkuar për gradën e vështirësive të tregut, në kohën kur portofoli po merrte përmasa të mëdha. Në këtë mënyrë kontakti me klientin mbetej përfundimisht në njësinë shitëse, ndërkohë që analiza, vendimarrja dhe kontrolli i portofolit në nivel të përgjithshëm realizohej nga njësitë e riskut. Garantimi dhe ruajtja e kësaj ndarjeje është një nga pikat e nxehta të sistemit bankar. Udhëzimi dhe vendimi duhet të vijë nga strukturat më të larta të një Banke dhe të respektohet me rigorozitet nga të gjitha njësitë teknike dhe operative.

Lloji i Proçedurave në se të forta apo normale në proçesin e kreditimit, ka një efekt në uljen e nivelit të huave me probleme me koeficientin -30,862. Pra në se banka operon me praktika dhe proçedura të forta në aktivitetin kreditues niveli i huave me probleme ulet me

këtë koeficient, në se operon me procedura normale, këto procedura nuk kanë efekt në uljen e nivelit të huave me probleme.

“Numri i ditëve në vonesë” të huave me probleme, para se të kalojnë për ndjekje nga struktura të specializuara në banke, siç është rekuperimi ka një efekt në uljen e nivelit të huave me probleme me koeficientin 0,260 e shumëfishuar me numrin e ditëve. Sa më gjatë të qëndrojnë pranë njësive të shitjes për ndjekje që nga moment që këto hua shfaqin vonesa aq më i lartë niveli i huave me probleme, dhe sa më shpejt të kalojnë aq më i ulët niveli i tyre.

“Negocijimet fleksibel”, kanë gjithashtu efekt në uljen e nivelit të huave me probleme. Në se banka qëndron e ngurtë në negocijimet me klientët që vonojnë pagesat e huave, niveli i huave me probleme rritet ndjeshëm me koeficientin e 35,363, ndërsa në se banka është fleksibël në negocijimet me ta niveli i huave me probleme ulet ndjeshëm.

Ndryshimi i stokut të portofolit, shpreh tendencën e kreditimit të bankave gjatë periudhës së mungesës së likuiditetit në treg. Dhe në varesi të qasjes që bankat patën në këtë periudhë, ndikoj në nivelin e huave me probleme me koeficientin -0,044. Kështu për banka që patën rritje të portofolit të huave më të madhe se 0%, kjo qasje ka ndikuar në uljen e nivelit të Huave me Probleme e shumëfishuar kjo rritje në përqindje me koeficientin -0,044. Ndërsa bankat që patën një rritje të barabartë me 0, efekti është 0 në nivelin e Huave me Probleme dhe në rastet e prirjes negative me < 0 , niveli i Huave me Prbleme rritet i shumëfishuar me përqindjen rënëse të portofolit të huave.

Në mënyrë të përmblodhur interpretimi i koeficienteve të Variablave që rezultojnë në korelacion me nivelin e huave me probleme është si vijon :

1. Bankat që kanë një qasje fleksibël në negocijimin me klientët joperformues kanë nivele më të ulëta të huave me probleme, krahasuar me nivelin mesatar të huave me probleme të gjithë sistemit bankar, ky variabel rezulton me koeficientin e pastandardizuar Beta 35,363

2. Bankat që aplikojnë procedura të forta dhe bashkëkohore gjatë procesit të huadhënies, rezultojnë në një nivel më të ulët të huave me probleme, 10-15% krahasuar me nivelin mesatar të sistemit bankar 23% të huave me probleme. Koeficienti i pastandardizuar Beta është -30,862
3. Bankat që kanë strukturat më të mira, përshkrimet e punës që reflektojnë qartë përgjegjesit midis njësive të Shitjes dhe Riskut, koeficienti i pastandardizuar Beta është -22.155
4. Të tjerë variabla që ndikojnë në mënyrë të moderuar në nivelin e huave me probleme është numri i ditëve mesatare në vonëse në të cilin këto hua joperformuese kalojnë për monitorim pranë njësisë së rekuperimit të bankës. Koeficienti i pastandardizuar Beta është 0,260.

Formula e cila shpreh korelacionin në të cilën variablat e studiuar kanë ndikuar në nivelin e lartë të huave me probleme, bazohet në rezultatet e mësipërme dhe është:

*Rritja e Huave me probleme në % = - 22.155*strukturë e qartë e njësive Risk dhe Shitje – 30.862*procedura të forta + 0.260*nr ditëve te rekuperimi + 35.363*negociata të ngurta – 0.044*rritje e stokut të Portofolit të huave në % - 18.592*

Gjithë variablat janë me dy opsione, (PO = 1 dhe JO = 0), përveç numurit të ditëve të rekuperimit (që merr vlerat 30, 60 or 90 ditë) dhe rritja e stokut të Portofolit në % që është rritja reale për çdo bankë.

Me ndihmën e formulës, e cila lidh gjithë variablat me rritjen e nivelit të huave me probleme, konkludohet në këtë përfundim: ***Gjatë procesit të huadhënies, banka duhet të marrë në konsideratë sigurimin që ka një strukturë të qartë mes njësive të Risk-ut dhe Shitje-s, ka në funksion procedura të forta dhe ruan prirjen e huadhënies në nivele normale. Gjithashtu Bankat duhet të jenë të shpejta në negociimet e tyre me huatë që nuk përformojnë apo ato me probleme në ripagimin e tyre, duke qënë fleksibël në negociata me huamarrësit në interes të të dy palëve.***

Një test i veçantë është bërë për të parë efektin e PBB në nivelin e huave me probleme. Të dhënat statistikore janë marë për periudhën 2003 deri në vitin 2013, për të dy variablat PBB dhe nivelit të Huave me Probleme. Nga testi rezultoj se prirja e PBB afekton / ndikon nivelin e huave me probleme njësoj në të gjithë sistemin bankar.

Në vijim tabela nr 20, me koeficientet përcaktues të varësisë së këtij faktori ndaj nivelit të Huave me probleme ku tendenca e PBB jep ndikim në nivelin e huave me probleme në të gjithë sistemin bankar me koeficientin e pastandardizuar Beta -2,954⁷⁷.

Formula në të cilën PBB ndikon në nivelin e lartë të huave me probleme është:

$$HP \text{ në } \% = -2.954 * PBB \text{ në } \% \text{ për Shqipërinë} + 22.278 \text{ (koeficienti standard)}$$

Tabela nr 20. Të dhënat tabelare të koeficientëve statistikore për PBB dhe korelacionin e tij me nivelin e Huave me Probleme

Koeficient					
Model	Koeficient i pastandardizuar		Koeficient i Standardizuar	t	Sig.
	B	Gabimi std	Beta		
1 (Constant)	22.278	4.265		5.223	.001
PBB në % për Shqipërinë	-2.954	.845	-.759	-3.496	.007
a. Variablat e varur: % e H. Probl ndaj stokut tot të huave					

⁷⁷ Një test i veçantë është bërë për të parë efektin e PBB në nivelin e huave me probleme. Të dhënat statistikore janë marë për periudhën 2000 deri në vitin 2012, për të dy variablat PBB dhe H.P.

Ku:

HP në % - Përqindja e Huave me Probleme ndaj total portofolit të huave

-2,954 – koeficienti me shenjë negative, i shumëzuar me nivelin e PBB në %, tregon se:

- për një tregues të PBB > 0 , niveli i huave me probleme ka tendencë zbritëse, sa më e madhe të jetë treguesi i PBB –se aq më i ulët niveli i huave me probleme
- për një tregues të PBB < 0 , niveli i huave me probleme ka tendencë rritëse, dhe për vlera 0 dhe më të vogla të PBB, niveli i huave me probleme rritet ndjeshëm.

Del qartë se prirja e PBB ka një rol të rëndësishëm në nivelin e Huave me Probleme, ndaj në mënyrë të ndjeshme, bankat duhet të marrin në konsideratë tendencën e PBB gjatë procesit të huadhënies.

KAPITULLI VII: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të këtij punimi u arrit në konkluzione mjaft të rëndësishme të cilat kanë vlerë të njihen dhe nga të cilat sugjerohen rekomandime të rëndësishme që mbrojnë dhe garantojnë stabilitetin financiar të një banke.

Punimi verifikoj hipotezën kryesore se: “Mirëadministrimi i portofolit të huasë ka një rol kyç, në uljen e rrezikut të huasë dhe huave me probleme, duke garantuar ecurinë dhe stabilitetin financiar të bankës, dhe më tej, del me një gjetje të re dhe akoma më specifike që lidhet po me këtë hipotezë, e cila ka të bëjë me një element mjaft të rëndësishëm të administrimit portofolit të huave, që është: Mungesa e një ndarje të qartë të strukturës organizative në sektorin e kredisë dhe procesin e kredidhënies në banka, ka rezultuar të jetë një faktor i rëndësishëm i cili ka dhënë efekte negative në cilësinë e portofolit të huave. Nga analiza vërtetuese e këtij studimi doli se pak banka kanë që në fillim të aktivitetit të tyre një ndarje të qartë të strukturës organizative të njësive së shitjes dhe riskut në aktivitetin e tyre kreditues, portofoli i huave të të cilave rezulton me një portofol të huave me probleme në nivele të ulëta në raport me bankat që e kanë neglizhuar këtë element.

Sistemi bankar Shqiptar mbetet një nga sektorët më të formalizuar të ekonomisë që i ka mbijetuar me sukses sfidave të një ekonomie në tranzicion dhe pak të formalizuar, por që gjithashtu ka përjetuar dëme në ecurinë e tij deri në lëkundjen e stabilitetit financiar. Ekonomia Shqiptare është ende larg të qenit një ekonomi e mirë diversifikuar në sektorët natyrorë të saj, e cila është baza për një zhvillim afatgjatë dhe të qëndrueshëm. Detyra e ndërtimit të një ekonomie tregu të plotë ka qënë e vështirë dhe e vonuar. Sidoqoftë kriza ekonomike botërore nxori problemet reale të ekonomisë së vendit, duke treguar që rritja ekonomike në vitet e para të tranzicionit nuk krijoi baza për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik afat gjatë por plotësoj nevoja immediate për konsum.

Rreziku politik në ekonomi është një çështje shqetësuese dhe me efekt ndikues në dështimin e ripagimit të huave, dhe kjo është më shumë intuitive se sa e marë nga frekuenca e të dhënave makroekonomike, të cilat janë të munguara. Investimet e Huaja Direkte pavarësisht rritjes së tyre nuk kanë patur një prurje në nivelin e duhur që të mund të ndikonin pozitivisht në një zhvillim më të qëndrueshëm dhe afatgjatë të ekonomisë në tërësi.

Sidoqoftë, sistemi bankar shqiptar arriti të përballoj me sukses sfidat e njëres prej krizave financiare globale më të mëdha që nga kriza botërore e vitit 1933. Kjo krizë financiare globale e mbartur në ekonominë e rajonit dhe vendit tonë, dhe efektet e saj në ekonominë e vendit dhe sektorin bankar në veçanti, ndërgjegjësoi dhe i dhanë mësim mjaft të vlefshme menaxherëve të lartë të bankave në drejtim të vlerësimit të situatës së bumeve ekonomike si shenjat e para të krizave të mëdha.

Prirja rritëse e huave me probleme në sistemin bankar shqiptar po gjeneron një rritje të provigjionimeve të bankave nga huatë me probleme dhe ato të humbura, rënien e kapitalit rregullator dhe të mjaftushëmrisë së kapitalit, duke ulur kështu aftësinë huadhënëse të bankave, e cila në fund krijon një rreth vicioz që vonon rekuperimin e ekonomisë në tërësi. Faktorët makroekonomikë ende ndikojnë negativisht në prirjen e huave me probleme, sidomos shkalla rënëse e rritjes së PBB-së dhe normat e interesit, të cilat i mbajnë klientët e bankave të ekspozuar ndaj vështirësive për rishlyerjen e huave. Rreziku i kredisë, dhe

kreditë me probleme, janë mjaft të lidhura me zhvillimet ekonomike të vendit dhe faktorët socialë e kulturorë që ndikojnë në to.

Dështimi i konkurrencës bankare, e cila rezultoj në një qëndrim të gabuar në drejtim të huadhënies, e shoqëruar me krizën globale financiare ka shkaktuar një nivel të lartë të huave me probleme, destabilitetin e sistemit bankar dhe një rënie të gjatë të zhvillimit ekonomik. Numri i madh i bankave relativisht të mëdha operuese në treg, ka sjellë problemin e huave të këqia, veçanërisht kur këto banka nuk investojnë huadhënie ndaj biznesit në mënyrë të vazhdueshme.

Struktura e tregut financiar Shqiptar ku sektori bankar përbënë mbi 93% të tij krijon kushte për një ekonomi të pabalancuar, ndërsa, përqëndrimi i bankave tregtare përsa i përket tipareve specifike të vendit tonë, e bënë të vështirë të dalim në konkluzione të përshtatshme dhe të aplikueshme të një strukture më të mire të tregut bankar.

Hipoteza kryesore e këtij studimi se Mirëadministrimi i portofolit të huasë ka një rol kyç në uljen e rrezikut të huasë, duke garantuar një portofol cilësor kredie dhe me nivel të menaxhueshëm të kredive me probleme, është vërtetuar nëpërmjet gjetjeve në vijim:

- **Gjetja e re e këtij punimi është: Shumica e bankave tregtare në vend nuk kanë një strukturë të qartë organizative në sektorin e kredisë, ku rolet e njësive të jenë të ndara dhe pa mbivendosje detyrash e përgjegjësish me njëra tjetren dhe sidomos midis dy strukturave baze Risk dhe Shitje, ku secila të operojë në mënyrë funksionale duke rritur efektivitetin në punë që synon ruajtjen e një protofoli kredie cilësor e nivel të menaxhueshëm të kredive me probleme.**
- Standartet e përshtatura të Basel I, ndihmuan bankat në Shqipëri të pengojnë efektet e krizës së fundit financiare, por provuan që ishin të paplota, në aspektin e sigurimit afatgjatë të menaxhimit të cilësisë së portofolit të huave. Banka e Shqipërisë ka qënë relativisht e vonuar në marrjen e rolit të saj në procesin e kontrollit dhe monitorimit të instalimit të rregulloreve dhe strukturave të huadhënies si një standard i detyrueshëm për tu zbatuar në praktikë për bankat tregtare në vend. Regjistri i kredisw si njw burim informacioni mjaft i vlefshwm

megjithw kontributin e tij tw rwndwsishwm nw parandalimin e huadhwnieve cilwsisht tw dobwta, ishte i vonuar nw kohw relativisht me bumin e kreditimit tw sistemit bankar.

- Vënia e rolit të riskut parësor e dominues në vendimarrjet e kredisë është një fenomen që ndodh në gjithë bankat kredidhënëse pasi kanë dalë e përjetuar një eksperiencë të dhimbshme nga krizat financiare, dhe kjo ka ndodhur dhe në bankat shqiptare. Eksperienca botërore ka treguar se roli i riskut dobësohet dhe kalon në plan të dytë në momentet e bumeve ekonomike, dhe ky është një fenomen i cili duhet të jetë i kontrolluar në mënyrë që banka të ruajë parametrat e duhur në një huadhënie që garanton portofol cilësor kredie e stabilitet afatgjatë të bankës në të gjitha fazat e ciklet ekonomike që përjeton ekonomia e vendit.
- Rivlersimi i shpejtë në kohë i kolateraleve dhe konkretisht pronave të patundshme në vend, krijoj te bankat tregtare gjykimin e gabuar se një mbulim i mirë me kolateral është një garanci për kthimin e plotë të kredivë, madje edhe ato me shkallë rreziku jo të tolerueshëm, duke mos marrë për bazë kriteret e tjera bazë për një hua dhënie të shëndetshme e që është baza e një portofoli kredie cilësor.
- Trajtimi i punonjësve në tërësi mbetet një aspekt i rëndësishëm për tu përmirësuar nga bankat, ndërsa në veçanti trainimet e punonjesve të sektorit të kredisë, janë shpesh të rralla dhe nuk krijojnë një bazë të mirë njohurish të përshtatshme për të përballuar vështiresitë që hasen gjatë analizave të aplikimeve për kredi në kushtet e mungesës së informacioneve të qënësishme e të nevojshme.
- Zgjidhja e huave me probleme nga ana e bankave ka marë kohë të gjatë duke krijuar një situatë të tillë ku recuperimi i ekonomisë nga efektet e krizës financiare botërore ende duket larg dhe po has vështirësi të mëdha. Zgjidhja e shpejtë e huave me probleme nëpërmjet negocijimeve të buta e të shumta është çelësi që çliron bankën nga barra e provigjoneve dhe rrit likuiditetin në treg për të financuar biznese fitimprurëse e të sigurta.

Rekomandimet dhe Përdorimet e tyre në praktike

Zhvillimet e fundit në sistemin bankar, dhe në treg treguan se recuperimi i borxheve të këqia është i vështirë dhe me kosto të lartë. Në këto kushte, rekomandimet e kryera, bazuar në gjetjet që kanë dalë nga analiza e bankave tregtare, gjejnë zbatim praktik për çdo institucion financiar në vend si dhe për bizneset korporatë.

Integrimi i biznesit shqiptar me atë botërorë është një proces i pandalshëm, që vjen natyrshëm si një reflektim i operacioneve që kanë të bëjnë me këmbimin e lirë të mallrave.

Në mënyrë të veçantë bizneset korporatë kanë të rëndësishme të vendosin praktika të përshtatshme që vlerësojnë dhe matin riskun në çdo marrëdhënie me partnerë në biznes, për çdo transkasion që lidhet me blerjet dhe shitjet, kushtet e pagesave, duke konsideruar profilin e riskut që paraqesin në treg këto të tretë në marrëdhënie. Duke marrë në konsideratë diversifikimin e portofolit të marrëdhënieve të shitjeve dhe blerjeve, nëpërmjet alternativave paralele, me një sy të fortë ndaj tendencave të prirjeve të zhvillimeve ekonomike në treg.

Rekomandimet e cituara në vijim vlejnë për çdo subjekt tregtar, (bankë apo biznes) të konsiderojë në mënyrë të veçantë, gjetjen e re të këtij punimi e cila ka të bëjë me vënien në zbatim të një ndarje të qartë të strukturës organizative, e cila garanton efektivitet të punës dhe cilësi.

Më specifikisht duke qënë se është marrë për bazë sistemi bankar shqiptar, rekomandimet i referohen konkluzioneve dhe gjetjes së këtij punimi dhe që janë si vijon:

- Rekomandohet vënia në zbatim e një strukture organizative, e cila të ketë një ndarje të qarte të punës midis njësive të Risk-ut dhe Shitje-s, nëpërmjet një specifikimi të plotë e të thellë të detyrave, sipas profilit të punës që mbulojnë duke garantuar një operativitet normal pa mbivendosje apo hapësira bosh në zinxhirin e funksionimit të procesit kredidhënës. Rëndësia e kësaj ndarje të strukturës organizative, ndikon në krijimin e një protofoli cilësor në vijim dhe uljen e nivelit të huave me probleme.
- Bankat duhet të synojnë dhe përpiqen të përmirësojnë praktikën dhe procedurat e huadhënies, drejtë një qasjeje më cilësore dhe praktike që do të thotë sa me të përshtatshme me zhvillimet në treg. Rregullimi financiar i aktivitetit kreditues

duhet të jetë sa më i përshtatshëm me zhvillimet në treg, si një përfshirje e madhe që përmbledh eksperiencat më të dobishme të fituara me dhimbje nga mësimet e krizave dhe dështimeve për të mitiguar riskun e humbjeve që vijnë nga kreditë me probleme.

- Bankat gjatë huadhënies duhet të ruajnë një nivel kreditimi që synon rritje të qëndrueshme e cilësore të stokut të portofolit të huave, pra ruajtjen e vazhdueshmërisë së financimit.
- Zgjidhja e huave me probleme është e nevojshme dhe e domosdoshme të vendoset shpejt dhe bankat duhet të kenë një qasje fleksibël në negocijim me klientët që nuk paguajnë huatë ndaj bankës, në mënyrë që të ruajnë nivele të moderuara të huave me probleme. Qasja e Bankave në drejtim të zgjidhjes së huave me probleme duhet të konsiderojë edhe përshkallëzime të sasisë së borxhit për humamrrësit e këqinj, në përputhje me situatën aktuale paguese të këtyre kredimaresve, dhe jo vetëm nëpërmjet faljes së penalteteve, interesave por edhe falje pjesore të principalit (kryegjësë), deri në ato nivele që bëjnë të mundur që huamarrësi të realizojë ripagimin pjesor të borxhit ndaj bankës. Kjo krijon një situatë të favorshme likuiditeti në bilancin e bankës për të kredituar klientë me potenciale të mira ripaguese. Kujdes duhet treguar në këtë proces negocijimi, që të mos abuzohet nga palët në proces, duke hartuar procedurë të qarta e specifike.
- Përzgjedhja e menaxherëve të lartë të sektorit të kredisë duke synuar profesionistë të zotë dhe me njohuri të larta shkencore. Kryerja e trainimeve të shpeshta të specialistëve të kredisë, është e rëndësishme, pasi i mban ata të mirë informuar mbi prirjet dhe zhvillimet në treg duke i aftësuar në rritjen e cilësisë së analizave që kryejnë për aplikimet për Kredi si dhe në monitorimin e huave deri në shlyerjen e tyre të plotë.

Bankat tregtare duhet të krijojnë dhe të mbajnë një portofol huash eficientë për të arritur shkallën e duhur të kthimit të tyre me risk mundësisht sa më të ulët për nivele të caktuara të rrezikut në një kthim maksimal të mundshëm të rrezikut. Çdo institucion financiar individual duhet të menaxhojë punën e tij për të mbijetuar e patur sukses, nëpërmjet një

modeli modern të Funksionimit dhe të përpiqet për të përmirësuar atë në mënyrë të vazhdueshme, përballë rrezikut të mos kthimit të huasë.

REFERENCAT

Burime të para:

Libra me një dhe më shumë autorë

- Greenbaum Stuart I. & Thakor V. Anjan (2007), “*Contemporary Financial Intermediation, Second Edition*”; Introduction chapter 2, pg 42, pg 43; chapter 5 Spot lending, pg 173-174, Part III Major “*On Balance Sheet*” Risks in Banking, Chapter 5, pg 185 Part III Major “*On Balance Sheet*” Risks in Banking, Chapter 5. pg 206. Në tekst referuar: Greenbaum Stuart I. & Thakor V. Anjan (2007)
- Greenspan Alan (2007) “*The Age of Turbulence/Epoka e trazirave*” kapitulli Globalizimi dhe rregullimi, fq 434, format e kapitalizmit Fq 316; përkthyer në shqip nga Prof Aristotel Pano në 2011. Në tekst referuar si: Greenspan (2007)
- Heffernan, Shelagh, (2005): “*Modern Banking*” Chapter.7.4.2 Managerial Problems, Pg 391-393. Financial Crises Chapter 8. chapter 7.2.1. on How to deal with failed banks: the Controversies, pg 353, Në tekst referuar: Heffernan, Sh, (2005).
- Mayo, Herbert B (2011) “*An Introduction to Financial Institutions, Investments & Managements*. Publisher South-Western College. Në tekst referuar: Mayo, Herbert B (2011)
- Matthews Kent. and Thompson, J.(2005): “*The Economics of Banking*” Chapter. 4, “Retail and wholesale banking”, p. 60. Në tekst referuar: Matthews Kent. and Thompson, J.(2005).
- Saunders Anthony and Cornet Marcia Millon (2006) “*Financial Institutions Management; A Risk management approach*, sixth edition by McGraw-Hill International edition. Në tekst referuar: Saunders Anthony and Cornet Marcia Millon (2006)

Artikuj shkencore:

- Abiad, A., Dell’Ariccia, G., & Bin L., (2011), “*Creditless Recoveries*” IMF Working Paper 11/58, Washington, March 2011, p.17. Në tekst referuar: Abiad (2011)
- Abiad, A., Leigh Daniel, & Mody Ashoka “*Financial Integration, Capital Mobility, and Income Convergence*” September 2008, Pg 7-8. Në tekst referuar: Abiad (2008)
- Altman Edward I, Brooks Brady, Resti Andrea, and Sironi Andrea (April 2002) “*The Link between Default and Recovery Rates: Implications for Credit Risk Models and Procyclicality*, pg5, www.SSRN.com.
- Arukumar Rekha (Professor), Kotreshwar Phd G. “*Risk management in commercial banks*” Pg.3 December 2005, Pg. 17, mare nga www.SSRN.com. në tekst referuar: Arukumar (2005).
- Andrew W.Lo “*Regulatory Reform in the Wake of the Financial Crisis of 2007-2008*” March 2009, www.SSRN.com. në tekst referuar: Andrew W. Lo, (2009)
- AUNON NERIN Daniel, Cossin Diddier, Hricko Tomas, Huang Zhijiang “*Exploring for the determinants of credit risk, in credit default swap transaction data: is fixed – income market’s information sufficient to evaluate credit Risk?*” pg 9, pg 27, Dec.2002. Në tekst referuar: Aunion Nerin (2002),
- Bakera Scott R, Bloomb, Davisc Nicholas, and Steven J, in paper “*Measuring economic policy uncertainty*’ January 2013
- Banka e Shqipërise, botim me titull Borxhi dhe Kredia- një çështje interesi. Pg.23. marre nga www.bankofalbania.org; pare në Nëntor 2014.
- Banka e Shqipërisë “*Udhëzuesi për ristrukturimin e kredisë për individë dhe biznes*” Tetor 2013. marre nga www.bankofalbania.org; pare në Dhjetor 2014;
- Banka e SHqipërise, Raporti vjetor 2011, *Faktorët përcaktues të ecurisë së kredisë për sektorin privat në vendet e EQJ*, fq 88. Në tekst referuar: BSh (2011)

- Basel Committee on Banking Supervision (2006) *”Sound Credit risk assessment and evaluation for loans”* June 2006. Pg 5. Në tekst referuar: Komiteti Basel (2006).
- Basel Committee on Banking Supervision *”Principles for the Management of Credit Risk”*, consultative paper issued for comment by 30 Novemeber 1999, pg 1 to 11, marre nga SSRN web, pare në Prill 2015. Në tekst referuar: Basel Committee (April 2015)
- Basel Committee on Banking Supervision Papers no1, Monetary and Economic Department, Marrying the macro and micro prudential dimensions of financial stability, March 2011, pg 35, and pg 49.
- Basel Committee on Banking Supervision, Joint Forum, Developments in credit risk management across sectors: current practices and recommendations. February 2015, Marre nga SSRN, pare në Maj 2015. Në tekst referuar: Basel Committee (Feb 2015)
- Basel Committee on Banking Supervision *”Should Banks be diversified? Evidence from individual bank loan portofolio*, Paper no 118, Sept 2002, pg 4
- Banka Boterore, Departamentit të Uljes së Varfërisë dhe Menaxhimit Ekonomik të rajonit të Evropës dhe Azisë Qëndrore në Bankën Botërore *”Europa Juglindore: Raporti i Zhvillimeve ekonomike”* 05 Qershor 2012
- Billett T. Matthew & Garfinkel A. Jon from Henry B. Tippie College of Business, University of Iowa, Mark J. Flannery from Warrington College of Business, University of Florida *”Are bank loan special? Evidence on the post Announcement Performers of bank borrowers”*2003
- Callager Kevin P. *”The New Vulture Cultures: Sovereign debt restructuring and trade and investment treaties”* paper no. 02/2011
- Cappiello Lorenzo 2, Kadareja Arjan 3, Sørensen Christoffer Kok 2 and Protopapa Marco, *”Do bank loans and Credit standards have An effect on output? A panel approach For the euro area”*, Working paper series No 1150 / January 2010. Pg 13. SSRN WEB

- Carletti, E., and Hartmann, F. (May 2002): “*What special about Banking*” European Central Bank”, working paper no 146, p. 8,
- Ciancanelli Penny, E-mail: and Reyes Gonzalez Jose Antonio E-mail: areyes@eh.quik.co.uk (2000) Department of Accounting and Finance Strathclyde University Glasgow, G4 0LN “Corporate Governance in Banking: A Conceptual Framework”, pg 11. Paper submitted for presentation at the European Financial Management Association Conference, Athens, June, 2000. SSRN WEB
- Ciuriak, D.: Implementing Better Banking Regulation And Standards -lessons from the past”, March 2001, (revised Feb 2010).
- Claessens, S., and Leaven, L.: “*What drives Bank Competition, some international evidence*” World bank Policy, working paper 3113, August 2003, p.8.
- Denizer, C.: “*The effects of Financial Liberalization and New bank Entry on Market Structure and Competition in Turkey*”, Macroeconomics and Growth Development Research Group, Sept. 1997. Pg.17.
- Ellul Andrew & Yerramilli Vijay “*Stronger Risk Controls, Lower Risk: Evidence from U.S. Bank Holding Companies*” Journal of Finance, Forthcoming; pg 1, SSRN WEB
- Ferguson P. Thomas, “*Observations on Securitization on Non-Performing loan in Russia*” September 2007, working paper, SSRN Web, pg.4.
- Heremans, D., and Paccès, A.M.,: “*Regulation of Banking and Financial Market*”, working paper series no 2011/04. Në tekst referuar si: Heremans dhe Paccès (2011)
- Impavido, G., Klingen, C., Sun, W.: “NPLs and the Macroeconomy” Chapter 2, 2012
- Ivashiva, V, Scharfstein, D.: “Bank Lending during the financial Crises of 2008”, p.8. në teskts referuar: Ivashiva dhe Scharfstein (2008)
- Louzis, D.P., Vouldis, A.T., Metaxas, V.L.: “*Macroeconomic and bank-specific determinants of non-performing loans in Greece: a comparative study of mortgage, business and consumer loan portfolios*”, Working Paper no.118, Bank of Greece, September 2010, Pg.10. Pg 16, Pg 23, Pg 24. Në tekst referuar: Louzis, Vouldis dhe Metaxas (2010),

- LUISS Nicola Borri, Adrien Verdelhan and MIT Sloan & NBER “Sovereign Risk Premia” pg2, Sept 2011
- McKinley, J.E. & Barrickman, J.R.: “*Strategic Credit Risk Management*”, Robert Morris Association, Philadelphia, 1994.
- McCormick Roger “*Professor in London School of Economics & Political Science “The management of legal risk by financial institutions”* second edition press Oxford University 2010, Pg. 2 review of March 2004
- Meka, E.: “*Corporate Bonds - A New Way for Financing Corporate in Albania*”, ECONOMICUS, No.7, UET/PRESS, Fall 2011, p.32.
- Meka, E.& Meka, S.: “*Albanian financial system in front of global & financial crisis - a new approach to ensure long-term sustainability*”, June 2012, p.5.
- One world nations online - Country Risk Analysis “*List of Sovereign Debt and credit rating of countries*” data from 1st August 2012, marre nga <http://www.nationsonline.org/oneworld/country-government-gross-debt.htm>
- Quirici Maria Cristina “*Aspetti Evolutivi nella Gestione del rischio di credito alla luce del deterioramento della qualita dei prestiti bankari*”, Studi e Note di Economia 3/96.
- Reinhart, Carmen M and Rogoff Kenneth (2010) “*From Financial crash to debt crises*”,
- Saunders Anthony and Stern Ingo Walter, School of Business, New York University, New York, NY10012, USA, ‘Financial architecture Systemic Risk and Universal Banking, pg.23
- Schnitzer, M.: “Bank Competition and enterprise restructuring in transition economies”, University of Munich and CEPR, Oct. 1998, Pg 1, Pg 2.
- Sinkey Jr, J.: “*Commercial Bank Financial Management – In the Financial Services Industry*”, botimi i peste, Prentice-Hall International Inc. New Jersey, fq.403, 1998.
- Skeel A. David from University of Pennsylvania Law School ; European Corporate Governance Institute (ECGI) and Frank Partnoy from University of San Diego

School of Law “ *The Promise and Perils of Credit Derivatives*” SSRN Posted Sept 2006, revised Feb 2010. Pg 1021, Pg. 1022.

- Staikouras, C., & Wood, G.: “*Competition and Stability in Euro Area - the Case of Greece and Spain*”, The City University of Business School, 2000.
- Stiven I. Davis “ *Banking in Turmoil*” Strategies for Sustainable Growth” 2009,

Website:

- Te dhëna mbi vlersimet e riskut te sovranit për vendet e ballkanit fqinjë me Shqipërinë (Janar 2015) , pare nga faqa online. Marrë nga www.countryeconomy.com
- Te dhëna mbi treguesit e PBB, nivelin e papunesise, dhe investimet publike për 2013 nga faqa zyrtare e Instat pare në (Shkurt 2015). Marrë nga www.instat.gov.al/al/figures.aspx
- Të dhëna të pare nga faqa online në “Open Data” (Shkurt 2015). Marrë nga www.open.data.al/.../Borxhi-Publik-i-Brendshem-dhe-i-Jashtem
- Të dhëna të ndryshme të marra vazhdimisht mbi ekonominë dhe sistemin bankar (Banka e Shqiperise). Marrë nga <http://www.bankofalbania.org/>
- Te dhena mbi treguesit e PBB per fryme te Italise dhe Greqise, (Dhjetor 2015). Marrë nga www.data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD

Burime dytesore:

- Agalliu Arbi , “*Kapitali Human Perballe sfidave te sistemit bankar ne Shqiperi*”, punim doktoral (2013), fq. 141, fq 143
- Zaho Lavdosh, Cani Shkelqim “*Teknikat bankare*”Tiranë ; Pakti 2008
- Branson W. (1990) “*Macroeconomic Theory and Policy*” third edition
- Xhafa, H. Ciceri B ”*Drejtimi Financiar*” Tiranë Albpaper 2006, botimi trete.
- Civici Ardian (2011) “*Iluzionet Monetare: Mashtrimet e medha*” Tiranë : Ombra GVG,
- Credins Bank “*Politikat kredituese 2014*,
- Madura J. 2010, South Westearn

- Stiglitz J. *“Economics of Public Sector”* 2000, Norton
- Van Gestel Tony & Baesens Bart *“Credit Risk Management “* chapter *“source of risk’* pg 23. botim i Oxford
- Vetter, Stefan Deutsche Bank *“Recent Trends in FDI activity in Europe ” 21 Gusht 2014,*
- Skeel A. David from University of Pennsylvania Law School ; European Corporate Governance Institute (ECGI) and Frank Partnoy from University of San Diego School of Law *“The Promise and Perils of Credit Derivatives”* SSRN Posted Sept 2006, revised Feb 2010. Pg 1021, Pg. 1022
- Salko D. Dhuci O. *“Paraja dhe institucionet financiare”* Tiranë , Neraida, 1999
- Muhlberger Marion, Deutsche Bank *“CEE: Fit for the next decade in the EU”* 24.04.2014,
- IMF Roaf,J. Atoyan R. Joshi, B. Krogulski, K.”*25 years of Transition Post – Comunist Europe and the IMF”* Regional economic Issues Special Report. October 2014, Pg 30-42,
- Kanagaretnam Kiridaran, DeGroote School of Business, McMaster University, 1280 Main Street West, Hamilton, Ontario, Canada L8S 4M4; Gopal V. Krishnan, Department of Accounting, College of Business and Economics, Lehigh University, Bethlehem, PA 18015; Gerald J. Lobo, C. T. Bauer College of Business. University of Houston *“An Empirical Analysis Of Auditor Independence In The Banking Industry”*, Pg 9 (2010),; pg 9.
- PALFI Cristina PhD Student, Faculty of Economics and Business Administration, Babes-Bolyai University of Cluj-Napoca, Romania *“Globalization - a challenge for internal control and audit in banking system”* Pg.3. SSRN WEB. Accounting and Management Information Systems Conference, 2007
- Economicus *“Sipërmarrja dhe Inovacioni”* Reviste shkencore e Fakultetit Ekonomik, Nr 9, Vjeshte 2012; dhe *“Financimi dhe Menaxhimi i Biznesit”* Nr 10 Vere 2013.
- De Grauwe, Paul *“Economiksi i Unionit Monetar”* (2003), Oxford Univercity Press

- Dushku Elona & Kota Vasilika “*Modeli financiar në Shqipëri: Qasje ndaj te dhënave te panelit*” pg. 11. Material diskutimi. (2013)
- Akepe Linus Enobi, International Institute of Certified Forensic Investigation Professionals Inc. (IICFIP) & 2Godwin Emmanuel OYEDOKUN The Chartered Institute of Taxation of Nigeria April 22, 2014. “*Exploring the Media’s Role in Fighting Fraud and Corruption*”, Pg.1. mare nga www.SSRN.com. Në tekst referuar: Akepe (2014).
- Nazaj S. & Meka, E.: “*The Trend Of Non-Performing Loans In Albania’s Banking Sector - Causes - Challenges & Recommendations*” November 2012.

Revista shkencore:

- Berger N. Allen, Board of Governors of the Federal Reserve System Washington, DC 20551, Wharton Financial Institutions Center, Philadelphia, PA 19104 U.S.A and Robert De Young, Office of the Comptroller of the Currency Washington, DC 20219. “*Problem Loans and Cost Efficiency in Commercial Banks*” pg 3. Forthcoming, *Journal of Banking and Finance*, Vol. 21, 1997; SSRN WEB
- Caballero, Ricardo J. and Krishnamurthy, A.(2008), ‘*Collective Risk Management in a Flight to Quality Episode*’, *Journal of Finance*, 63 (5), 2195-2230. Në tekst referuar: Caballero dhe Krishnamurthy (2008)
- Dobbin Frank, F. 2012. “Review of J.C. Sharman, The Money Laundry: Regulating Criminal Finance in the Global Economy”. *American Journal of Sociology* 118(3).Pg 3.
- “*Monitor*” (Maj 2013) Reviste e përjavëshme,
- Miller Mj (2003) “Credit reporting around the globe, In: Miller MJ ed “Credit reporting Systems and the International Economy, MIT Press, Cambridge.
- Vladimir Simovic, Vojkan Vaskovic, Marko Rankovic, Slobodan Malinic “*The impact of the functional characteristics of a credit bureau on the level of indebtedness per capita: Evidence from East European countries*”, *Baltic Journal of Economics* 11(2) (2011) 101-130

ANEKSE

Formati Pyetësor për proçedurat e kreditimit në banka

I nderuar Z/Znj,

Ju paraqitëm me këtë pyetësor në kuadrin e realizimit të tëzes doktorale në disiplinën finance –bankë. Ky sondazh i referohet faktoreve që kanë çuar në rritjen e huave me probleme në sistemin bankar në 4-5 vitet e fundit në Shqipëri, duke analizuar situatën e kredidhenies të bankave tregtare në 10 vitet e fundit. E rendesishme shumë që përgjigjet tuaja të jenë të sqarë për të ndihmuar kështu të arrijnë në konkluzionë sa më të drejta.

1. Emri i Bankës -----

2. Emer Mbiemer i të anketuarit

3. Pozicioni: ☐ menaxher i ulët ☐ menaxher i mesëm ☐ menaxher i lartë

4. Kur ka filluar të funksionojë Njësia e Menaxhimit të Riskut në bankën tuaj?

☐ viti 2000-2005

☐ viti 2006-2008

☐ viti 2009-2012

5. A ka autoritet aprovues njësia e Menaxhimit të Riskut në Bankën tuaj, nëse po nga cili vit?

☐ Jo

☐ Po

nëse Po nga cili vit? ☐ Viti 2000-2005

☐ viti 2006-2008

☐ viti 2009-2012

6. Si kontakton klienti kredikërkues me bankën, cilin person kontakton të parin?

☐ Dr. Deges/kredise

☐ Analist i kredise

☐ Specialist/menaxher shitje

7. A informoheni mbi mënyrën e njohjes së klientit me bankën, nëpërmjet promovimit, në media, promovimit nga stafi i bankës apo njohjet direktë personale që kanë me staf apo drejtues të bankës?

☐ Jo

☐ Po

8. Cili njësi e bankës plotëson dosjen me dokumentacionin e nevojshëm për analizën e aplikimit për kredi?
- ☐ Njësitë e shitjes ☐ Njësia e riskut ☐ Dega/analisti ☐ ndryshme sipas segmentëve
9. Ku fillon e mbaron përgjegjsia e personit të kontaktit, ku kalon dosja e plotësuar me dokumentacion?
- ☐ Deri në shlyerje? ☐ Pasi plotësohet dokumenti nevojshëm? ☐ Kur del me vonëse?
10. Cilët specialist apo njësi të bankës bëjnë analizat e dosjes së aplikantit për kredi,
- ☐ Përsioni kontakti ☐ Analistë të riskut ☐ Specialistë të shitjes ☐ Juristi
11. Sa nivele vendimarrëse keni për limitet kreditimi dhe mbi çfarë raportesh bazohet vendimarrja?
- ☐ Një nivel ☐ Dy nivele ☐ Tre nivele e më shumë
12. Si i vlerësoni procedurat e kreditimit në bankën tuaj?
- ☐ Të forta ☐ mesatare ☐ të dobëta
13. Pas vendimarrjes cila njësi proceson anën juridikë dhe kreditimin e klientit?
- ☐ Backoffice apo ☐ analisti i kredise
14. Cila njësi ndjek klientin pas marrjes së kredise,
- ☐ Shitja/analisti i kredise apo ☐ analisti i riskut
15. Kur klienti fillon të shfaq probleme të ripagimit të huave, kush e ndjek? _____
- ☐ Rekupërimi apo ☐ Analisti kredise/shitja

16. Cilat njësi merren me menaxhimin e klientit në vonëse

- ☐ Rekupërimi? ☐ Analisti riskut? ☐ Analisti kredise/shitja?

17. Në cilin moment behet kalimi i portofolit në vonëse në këtë njësi?

- ☐ Pas 30 ditësh? ☐ Pas 60 ditësh? Apo ☐ pas 90 ditësh??

18. Fazat e nëgocijimit me klientin dhe procedurat që ndiqën me klientët në vonëse?

- ☐ një faze? ☐ Dy faza? Apo ☐ me shumë??

19. Sa trainime kryhen në bankën tuaj në një vit për punonjësit e kredise ?

- ☐ një here në dy vjetë? ☐ Një here në vit? ☐ Dy e me shumë here në vit??

20. Sa është portofoli i kredise në bankën tuaj?

- ☐ Në dhjetor 2012, ☐ Dhjetor 2009,

21. Sa janë kreditë me probleme në bankën tuaj në vlere absolute Dhjetor '12, _____
mild leke

22. Sa janë kreditë me probleme në bankën tuaj në vlere absolute Dhjetor '09

_____ mild leke

23. Totali i asetëve në bankën tuaj sa janë në vlere Dhjetor '09, _____ mild leke.

24. Totali i asetëve në bankën tuaj sa janë në vlere Dhjetor '12, _____ mild leke

Aneks 1. Tabela përmbledhëse e përgjigjeve të marra nga zhvillimi i pyetsorëve në terren në të gjitha bankat tregtare në Shqipëri

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	Union Bank	m lartë	2011	rekomandues		Shërb kl	po	analisti	deri në shlyerje	analisti	disa komitete	mesatare
2	B Bashkuar e Shq	m lartë	2012	rekomandues		Shërb kl	po	analisti	deri në shlyerje	analisti	disa komitete	mesatare
3	Tirana Bank	m lartë	2005	po	2005	CRM/Sales sp	po	crm	plotës dokumentacioni	CRM/Sales sp	disa nivele dhe individual	mesatare
4	Societe Generale Alb	Mesëm	2006	po	2006	CRM	PO	CRM	deri në shlyerje	Risk specialist	disa nivele risk+sales	mesatare
5	Procredit	Mesëm	2002	po	2002	CRM	Po	Crm	deri në shlyerje	crm+risk+jursit	disa nivele+individuale	forta
6	BKT-B Kombëtare Tregt	Mesëm	2004	po	2004	CRM	Po	Crm	plotës dokumentacioni	crm+risk +jurist	disa nivele sipas shumave	forta
7	Credins Bank	Mesëm	2006	rekomandues		analist	po	analist	deri në shlyerje	crm+risk +jurist	dy nivelepër çdo lloj segmenti	mesatare
8	Intesa S Paolo	Ulët	1998	po		CRM	PO	CRM	deri në shlyerje	crm+risk +jurist	disa nivele risk+sales	mesatare
9	RZB AI	Mesëm	2005	po	2005	AM	jo	crm	plotës dokumentacioni	crm+risk +jurist	një kredi kalon në disa nivele sipas fazave,	forta
10	Alpha Bank	Mesëm	2008	rekomandues		analist	po	CRM	deri në slyerje	crm+risk +jurist	disa nivele	mesatare
11	NBG	Mesëm	2007	votë nga 2009	2009	Shërb kl	po	sherb klientële	plotës dokumentacioni	crm+risk +jurist	tre nivele sipas shumave	mesatare
12	FIBANK	Lartë	2007	po, 2007	2007	CRM	po, 2007	CRM	deri në shlyerje	crm+risk +jurist	disa nivele	mesatare
13	Credit Agricol (emporiki)	Lartë	2004	rekomandues		dr dege	po	analisti	plotës dokumentacioni	specialist shitje	dy nivele për çdo lloj segmenti	mesatare
14	Veneto bank											
15	Credit bank of AI											
16	ICB											

13

14

15 16

17 18

19

20

21

22

23

Union Bank	analisti	analisti	rekupërimi	90	të shumta	0,5	13.6	9.98	1.84	17.6%	n.a
B Bashkuar e Shq	jurist, risku	analisti	rekupërimi	90	të shumta	0,5	n.a	n.a	n.a	n.a	6.4
Tirana Bank	jurist + backoffice	analist	rekupërimi	60	sipas rastit	1	55.15	59.2	22.8	6%	94
Societe Generale Alb	jurist +backoffice	CRM	rekupërimi	60	sipas rastit	1	33.77	18.2	3.14	0	60
Procredit	jurist+backoffice	CRM	rekupërimi	30	sipas rastit	1	22.7	20.6	3.28	2,8%	41
BKT-B Kombëtare Tregt	jurist+crm	CRM	rekupërimi	60	sipas rastit	1	90.4	47.4	11.66		227
Credins Bank	backoffice	analist	rekupërim	90	sipas rastit	1,5	62.3	30.3	13		92
Intesa S Paolo	Legal + backoffice	CRM	rekupërim	90	sipas rastit	1	49.26	49.7	13.99	10,3%	138
RZB Al	backoffice+legal	AM	rekupërim	30	sipas rastit	2	135	93	32.14		323
Alpha Bank	backoffice	crm	rekupërim	90	sipas rastit	1	37.54	45.5	15.66	10%	73.4
NBG	Legal + backoffice	analist	analist	90	sipas rastit	1	26.15	37	9		42.3
FIBANK	Legal + backoffice	crm	analist	90	sipas rastit	0,5	5.9	1.6	0.5		9.8
Credit Agricool (emporiki)	backoffice	analisti	rekupërimi	30	të shumta	0,5	23.3	27.15	7.2	5.20	32

Vijim i tabelës paraprirëse

Tabela që tregon renditjen e pyetjeve të kryera në tabelën e përgjigjeve sipas renditjes

Bankat	1	koha e dosjes	9	fazat e nëgocijiit	17
Pozicioni anketuar	2	kush benë analize	10	sa trainime	18
Viti i oper Risk	3	nr nivel vendim	11	Port vl 12'	19
Aut. aprovues	4	lloji procedurave	12	Port vl 09'	20
Viti aprovues	5	proçesimi juridik	13	Npl dhj 12'	21
Kont klienti	6	monitorimi	14	Npl dhj 09'	22
A njihet kontakti	7	njësia e npl	15	tot as 09	23
Plots dosjes	8	pas sa dt ndiqet	16	Tot as 12	24